3.4 Komunikon të menduarin e vet matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit), duke përdorur: gjuhën e përditshme, fjalorin fillestar matematik, paraqitje të ndryshme.

3.5 Komunikon të menduarin e tij matematik, duke përdorur simbole matematike.

3.6 Krijon paraqitje të koncepteve matematike me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame.

4.1 Bën lidhje mes njohurive paraprake dhe të reja për ndërtimin e koncepteve të reja në lidhje me numrat deri në shtatëshifrorë, të formave 2d dhe objekteve 3D.

4.3 Bën lidhje ndërmjet koncepteve e procedurave matematikore.

5.1 Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra; kupton përdorimin e ndryshoreve për zgjidhjen e problemeve nga matematika dhe nga jeta e përditshme.

6.2 Identifikon rregullat themelore për njehsimet me numra.

7.1 Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune; forcon strukturat mendore të ndërtuara më parë, relevante për matematikën duke parashtruar, duke pranuar dhe duke iu përgjigjur pyetjeve.

8.1 Verifikon rezultatin e problemeve matematikore duke përdorur kalkulatorin për të provuar saktësinë.

Tema/t mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë Mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
Njësitë matëse Sipërfaqja	- Kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde. - Përdor metrin (m) dhe nënfishat e metrit, si dhe kilometrin si njësi matëse të gjatësisë dhe kryen veprime me këto njësi. - Përdor tonelatën (t), kilogramin (kg) dhe gramin (g) si njësi matëse të peshës dhe kryen veprime me këto njësi. - Përdor litrin (l) si njësi për matjen e lëngjeve dhe kryen veprime me këtë njësi. - Krahason objekte të ndryshme bazuar në matjet e bëra. - Përcakton njësitë për matjen e kohës (dita, ora, minuta). - Zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë, peshën dhe kohën. - Krahason vëllimin e trupave bazuar në vëzhgimet që bën. - Ngjyros sipërfaqet e brendshme të figurave të ndryshme. - Bën dallimin mes sipërfaqes së brendshme dhe të jashtme të figurës. - Gjen syprinën e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit.	118. Të kontrollojmë njohuritë 119. Test kontrollues 120. Matjet 121. Matja e gjatësisë 122. Centimetri dhe decimetri 123. Metri 124. Kilometri 125. Konvertimet e njësive për matjen e gjatësisë 126. Problema me fjalë 127. Matja e masës 128. Kilogrami dhe tonelata 129. Konvertimet e njësive për matjen e masës 130. Matja e vëllimit 131. Konvertimet e njësive për matjen e vëllimit 132. Matja e kohës 133. Konvertimi i njësive për matjen e kohës 134. Ushtrime: Matja e kohës	**43 orë**	Mësimdhënia dhe të nxënit me fëmijën në qendër dhe gjithëpërfshirja Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar	Vlerësimi formativ Vlerësimi shumativ Informata Kthyese Listë kontrolli Portofoli Semafori Dy yje, një dëshirë Vlerësimi i ndërsjellët	Gjuhë amtare Shoqëria dhe mjedisi Edukatë figurative Njeriu dhe natyra Çështjet ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Libri Matematika 3

Figurat gjeometrike	- Emërton figurat gjeometrike si: trekëndëshi, drejtkëndëshi, katrori, rrethi etj. - Përkufizon shumëkëndëshin dhe tregon llojet e tij. - Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e figurave gjeometrike. - Vizaton trekëndëshin, drejtkëndëshin, katrorin dhe rrethin (*duke përdorur trekëndëshin, vizoren apo kompasin*). - Dallon drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe segmentin dhe i përkufizon ato. - Dallon këndet dhe llojet e këndeve (*kënd i drejtë, i ngushtë i gjerë).* - Krahason segmentet e ndryshme. - Cakton pozitën e dy drejtëzave - drejtëza paralele, drejtëza normale dhe prerjen e drejtëzave. - Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike. - Jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme. - Njehson perimetrin e figurave gjeometrike (trekëndëshit, katërkëndëshit, katrorit). - Zbulon formula të thjeshta për gjetjen më të lehtë të perimetrit të figurave.	135. Paratë 136. Paratë 137. Veprime me para 138. Veprime me para 139. Përsëritim njohuritë 140. Ushtrim kontrollues 141. Testi kontrollues 142. Ngjyrosja e sipërfaqes të brendshme të figurave 143. Sipërfaqja e brendshme dhe sipërfaqja e jashtme e figurave 144. Përsëritim njohuritë 145. Drejtëza, gjysmëdrejtëza dhe segmenti 146. Këndet 147. Llojet e këndeve 148. Krahasimi i segmenteve 149. Drejtëzat paralele, prerëse dhe normale 150. Emërtimi i figurave gjeometrike 151. Shumëkëndëshat					
EKIPI PROFESIONAL:							

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Numrat deri në 1000		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3, 4, 7), Nxënës i suksesshëm III (4, 5), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kujtojmë numrat deri në 100			
Fjalët kyçe: figura, numër, sende, dhjetëshe, njëshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - numëron figurat e dhëna në ilustrimin e tekstit; - shkruan numrin e sendeve në ambientin që e rrethon; - identifikon numrin e gjësendeve në vizatimin e tij/saj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri dhe fletore pune "Matematika 3", fotografi, mjete shkollore, si: lapsa, fletore, vizore etj.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Artet; **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të nxjerrin të gjitha mjetet e punës që kanë në çanta dhe më pas në çifte të numërojnë secilin prej tyre. Njëri nxënës ndërton tabelën në fletë A4, kurse nxënësi tjetër i dikton numrin e gjësendeve p.sh.:			

sendi	numri
Lapsa me ngjyrë	**18**
Goma	**2**

Hapi i dytë: Nxënësit hapin librat dhe vëzhgojnë ilustrimin ku është paraqitur pamja e një kancelarieje. Mësuesi/ja nxit nxënësit të zhvillojnë një diskutim rreth asaj se çfarë shohin në figurën e tekstit. Nxënësit do të identifikojnë numrin e sendeve për çdo grup dhe do të plotësojnë vendet e zbrazëta në tekst. Ata do të përdorin kartat e semaforit nëse kanë nevojë për ndihmë

Hapi i tretë: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të paraqesin me anë të vizatimit një ambient (sipas dëshirës p.sh. bibliotekë, dhomën e vet etj.) dhe nën vizatim të shkruajnë numrin e sendeve që kanë vizatuar. Nxënësit vendosin punimet e tyre në "Telin tharës" dhe vlerësojnë punimet më të mira.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Numërimi i mjeteve shkollore në çift.
Vizatimi i numrit të ndryshëm ë sendeve në ambientin e dëshiruar.
Vlerësimi i shokut/shoqes në "Telin tharës".

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet një ambient me materiale ricikluese dhe identifikohet numri i sendeve të paraqitura.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat deri në 1000		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3, 4, 7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Qindëshet e plota deri në 1000			
Fjalët kyçe: pllaka, shufra, kube, dhjetëshe, njëshe, qindëshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - numëron me qindëshe te plota deri në 1000; - ngjyros aq qindëshe sa tregon numri i dhënë në ushtrim; - shkruan me fjalë qindëshet e plota.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri "Matematika 3", fotografi, pllaka, shufra, kube.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë amtare (shkrimi me fjalë i qindësheve të plota), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst).
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Edukimi për qytetari demokratike

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi i parë: Mësuesi/ja vendos në dysheme një fletë A1, në të cilën ka paraqitur një katror me 100 katrorë të vegjël. Afër vendos etiketa me numrat 1-100. Kërkon nga nxënësit që të vendosin etiketat në vendin e duhur.
Përsërit ecurinë disa herë, në mënyrë që të kenë mundësi më shumë nxënës të realizojnë ushtrimin.

Hapi i dytë: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të vërejnë figurën ku është e paraqitur një katror i madh me numrat 1-100. Bashkërisht me nxënësit, vijmë te përfundimi se:

100 Njëshe = 1 Qindëshe
100 NJ = 1 Q

Nxënësve u ndahen në grupe 5 detyrat në vijim dhe gjatë gjithë kohës mund të përdorin etiketat me ngjyrat e semaforit, nëse kanë nevojë për ndihmë. Pas punës së bërë mësuesi/ja kërkon nga një përfaqësues i grupit të prezantojë. Ata janë të lirë të zgjedhin formën për prezantim.

Hapi i tretë: Udhëzohen nxënësit të punojnë në çifte, ku njëri nxënës thotë një qindëshe të plotë, kurse tjetri duhet ta shkruajë me fjalë. Nxënësit ndërrojnë rolet disa herë, derisa t'i shkruajnë të gjitha qindëshet e plota

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Numërimin me qindëshe të plota deri në 1000.
Ngjyrosjen e qindësheve sa tregon numri i dhënë.
Shkrimin me fjalë të qindësheve të plota.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat deri në 1000		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; - identifikon qindëshet dhe dhjetëshet e mijëshes së parë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3, 4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2, 5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dhjetëshet e plota deri në 1000			
Fjalët kyçe: pllaka, shufra, kube, dhjetëshe, njëshe, qindëshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - numëron me dhjetëshe të plota deri në 100; - formon dhjetëshet e plota me materiale ricikluese; - shkruan dhjetëshet e plota deri në 1000.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri "Matematika 3", fotografi, pllaka, shufra, kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (shkrimi me fjalë i qindësheve të plota), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja ka siguruar për secilin grup të nxënësve paketime të vezëve, ku mund të vendosen 10 vezë. Kërkohet nga nxënësit që në secilën hapësirë të vendosin nga një kub dhe të tregojnë: Sa kube zë një paketim? Një dhjetëshe sa njëshe ka? Po nëse kemi 5 paketime, sa kube na duhen për t'i mbushur? **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe bashkërisht numërojnë katrorët në shirit dhe vijnë te përfundimi se: 10 Njëshe = 1 Dhjetëshe 10 Nj = 1 Dhjetëshe			

Më pas, në çifte, nxënësit punojnë detyrat e dhëna në tekst, ku pas secilës detyrë, zhvillojmë një diskutim rreth zgjidhjeve të bëra.
Pas përfundimit, nxënësit i ndërrojnë librat dhe vlerësojnë punën e njëri- tjetrit (vlerësim i ndërsjellë).

Hapi i tretë: Udhëzohen nxënësit që të renditin etiketat me dhjetëshe të plota në dysheme dhe më pas të zhvillojnë një lojë duke u hedhur në numra dhe duke i lexuar me zë.
Më pas, nga secili grup kërkohet të tregojë se sa dhjetëshe ka afër dhe sa qindëshe formojnë ato dhjetëshe.
Nxënësit i ndërrojnë etiketat dhe përsëritin lojën me numra të tjerë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Numërimi me dhjetëshe të plota deri në 100.
Formimi i dhjetësheve të plota me materiale ricikluese.
Shkrimi i dhjetësheve të plota deri në 1000.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: 2**	**Klasa: 3**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3,4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Të gjithë numrat deri në 1000			
Fjalët kyçe: Pllaka, shufra, kube, dhjetëshe, njëshe, qindëshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Shkruan dhe lexon vargun e numrave natyror deri në 1000; • Plotëson vendvlerën kur është dhënë numri i dhënë; • Shkruan si një numëror të rregullt numrin kur është dhënë vlera e shifrave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri"Matematika 3", foto, pllaka, shufra, kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (shkrimi me fjalë i qindësheve të plota), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi pë qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë numra të ndryshëm 3-shifrorë. P.sh 146, 354, 672, 810 Kërkon nga nxënësit të nxjerrin aq pllaka, shufra dhe kube sa tregon numri i dhënë. **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja u parashtron kërkesat në formë Gjëegjëzesi P.sh. Unë kam 3 Q, kam 5DH, kam 2NJ. Cili numër jam? →352 etj. **Hapi i tretë.** Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesën e ushtrimit 1, tregojnë sa njëshe janë gjithsej dhe cili numër formohet. • Vizatojnë dhe plotësojnë tabelën e vendvlerave në 3 rende kur janë dhëne Pllakë, Shufër, Kub. • Emërtojnë dhe shkruajnë numrat nga numëror të rregullt në të zbërthyer dhe anasjellas. Gjatë punës në tekst udhëzohen nxënësit që për çdo paqartësi të kërkojnë ndihmë me anë të kartës së kuqe ose në të kundërten nëse e kanë zgjidh detyrën me shpejtësi mësuesi/ja i jep detyrë shtesë (në mënyrë që të mos krijojmë monotoni)			

Hapi i katërt: Nxënësve u shpërndajmë karta me numra të dhënë me fjalë. Udhëzohen të lexojnë dhe të shkruajnë me shifra. Nxënësit punojnë në çifte duke i ndërruar rolet.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Shkrimi dhe leximi i vargut të numrave natyrorë deri në 1000; Plotësimi i vendvlerës kur është dhënë numri i dhënë; Shkrimi i numrin si një numëror të rregullt kur është dhënë vlera e shifrave.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3,4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Të gjithë numrat deri në 1000			
Fjalët kyçe: pllaka, shufra, kube, dhjetëshe, njëshe, qindëshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • shkruan dhe lexon vargun e numrave natyrorë deri në 1000; • plotëson vendvlerën kur është dhënë numri i dhënë; • shkruan si një numëror të rregullt, numrin kur është dhënë vlera e shifrave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri "Matematika 3", fotografi, pllaka, shufra, kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (shkrimi me fjalë i qindësheve të plota), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë numra të ndryshëm 3-shifrorë. P.sh 146, 354, 672, 810. Kërkon nga nxënësit të nxjerrin aq pllaka, shufra dhe kube sa tregon numri i dhënë. **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja u parashtron kërkesat në formë Gjëegjëzës p.sh. Unë kam 3 Q, kam 5 Dh, kam 2Nj. Cili numër jam? 352 etj. **Hapi i tretë.** Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesën e ushtrimit 1, tregojnë sa njëshe janë gjithsej dhe cili numër formohet. • Vizatojnë dhe plotësojnë tabelën e vendvlerave në 3 rende kur janë dhënë: pllakë, shufër, kub. • Emërtojnë dhe shkruajnë numrat nga numërorë të rregullt, në të zbërthyer dhe anasjellas. Gjatë punës në tekst nxënësit udhëzohen që për çdo paqartësi të kërkojnë ndihmë me anë të kartës së kuqe ose në të kundërtën nëse e kanë zgjidhur detyrën me shpejtësi, mësuesi/ja u jep detyrë shtesë (në mënyrë që të mos krijojmë monotoni) **Hapi i katërt:** Nxënësve u shpërndajmë karta me numra të dhënë me fjalë. Udhëzohen të lexojnë dhe të shkruajnë me shifra. Nxënësit punojnë në çifte duke ndërruar rolet.			

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Shkrimi dhe leximi i vargut të numrave natyrorë deri në 1000. Plotësimi i vendvlerës kur është dhënë numri i dhënë. Shkrimi i numrin si një numëror të rregullt kur është dhënë vlera e shifrave.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: 2**	**Klasa: 3**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3,4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vlera e shifrës			
Fjalët kyçe: Vlerë, shifër, qindëshe, dhjetëshe, njëshe.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Paraqet numrat në numëratore; • Shkruan me shifra numrat e paraqitur në numëratore; • Gjen vlerën e çdo shifre te numrat treshifrorë.			
• **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri"Matematika 3", paket me shufra e kube, numëratore per nxënësit.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (shkrimi me fjalë i vlerave të numrave). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi më qytetari demokratike			
Hapi i parë: Mësuesi/ja organizon këtë situatë 1: Mësuesja në një fletë ka shkruar një situatë problemore p.sh. Prindërit e Enit shpenzuan: 200 euro për raftin e librave, 50 euro për lektyra shkollore dhe 8 euro për fletore. Sa euroshpenzuan gjithsej? Shkruhet nga nxënësit barazimi në formë të zbërthyer dhe si numëror të rregullt 200 + 50 + 8 = 258. Kërkon nga nxënësit që ta paraqesin në numëratore me tela pingulë. Paraqiten dhe numra të tjerë në numëratore. **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë kërkesën e ushtrimit 1 dhe tregojnë numrat e paraqitur në tabelë. Tregojnë vlerën e shifrave të dhëna në numrat e ndryshëm. Shkruajnë numrat në formë të zbërthyer dhe anasjelltas. Nxënësit punojnë detyrat e dhëna në tekst dhe pas çdo detyre zhvillojmë një diskutim rreth zgjidhjes së bërë. **Hapi 3.** Udhëzohen nxënësit që në grup të paraqesin 2 numra në numëratore, të zbërthyer, të shkruar me fjalë, të krahasuar me njëri-tjetrin.			

VLERËSIMI I NXËNËSVE
Paraqitjen e numrat në numëratore; Shkrimin me shifra të numrave të paraqitur në numratore; Gjetjen e vlerës së çdo shifre te numrat treshifrorë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3, 4, 7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2, 5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Numërimi nga 1 deri në 1000			
Fjalët kyçe: rendi rritës, rendi zbritës, në rritje, në zbritje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** • shkruan dhe lexon vargun e numrave natyror deri në 1000; • plotëson numrat që mungojnë në një varg numrash të dhënë; • rendit numrat në rendin rritës dhe zbritës;			
• **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri "Matematika 3", fotografi, paketë me pllaka, shufra e kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (argumentimet gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Edukimi për qytetari demokratike.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Aktivitete me numra **Aktiviteti 1.** Mësuesi/ja nxjerr përpara klasës 4 nxënës që mbajnë 4 numra që janë të renditur në mënyrë të çrregullt. Kërkon që të renditen në mënyrë të njëpasnjëshme. P.sh: 106,107,108,109. **Aktiviteti 2.** 7-8 nxënës tërheqin numra të ndryshëm dhe u kërkohet që të renditen herë në rendin rritës dhe herë në rendin zbritës. **Aktiviteti 3.** Në dërrasën e zezë vendos dy numra me një fillim dhe një mbarim të caktuar. P.sh: 380...390. Kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë numrat që mungojnë në mes.			

Hapi i dytë: Nxënësit lexojnë kërkesën e ushtrimit 1 dhe vendosin në vendin e duhur fjalët: "në rritje" apo "në zbritje".
Udhëzohen nxënësit që të plotësojnë në formë individuale detyrat 2, 3 dhe 4 dhe pas çdo detyre zhvillojmë një diskutim rreth punës së bërë.
Nxënësit ndërrojnë librat (në dyshe) dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi i tretë. Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesën e ushtrimit 5 dhe më pas të punojnë në dyshe. Është e rëndësishme të përsërisin këtë veprimtari disa herë, sepse do të përforcojnë mirë rendin rritës dhe rendin zbritës.

Hapi i katërt: Nxënësve u shpërndajmë karta me numra të dhënë me fjalë. Udhëzohen të lexojnë dhe të shkruajnë me shifra. Nxënësit punojnë në çifte duke i ndërruar rolet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Shkrimi dhe leximi i vargut të numrave natyror deri në 1000.
Plotësimi i numrave që mungojnë në një varg numrash të dhënë.
Renditja numrave në rendin rritës dhe zbritës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3, 4, 7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2, 5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Numërimi nga 1 deri në 1000			
Fjalët kyçe: rendi rritës, rendi zbritës, në rritje, në zbritje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** • shkruan dhe lexon vargun e numrave natyror deri në 1000; • plotëson numrat që mungojnë në një varg numrash të dhënë; • gjen e numrat para, pas dhe ndërmjet numrave të dhënë.			
• **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri "Matematika 3", foto, paketë me pllaka, shufra e kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (argumentimet gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Aktivitete me numra Në dërrasën e zezë shkruan numra të ndryshëm 3-shifrorë. P.sh 146, 139, 272 etj. Udhëzohen nxënësit të nxjerrin aq pllaka, shufra dhe kube sa tregon numri i dhënë. Aktiviteti zhvillohet në çifte, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të punojnë me më shumë pllaka, shufra e kube. **Hapi i dytë:** Nxënësit lexojnë kërkesën e ushtrimit 1 ku udhëzohen të plotësojnë numrat që mungojnë. Udhëzohen nxënësit që të plotësojnë në formë individuale detyrën 2 dhe më pas zhvillojmë një diskutim rreth punës së bërë. Nxënësit ndërrojnë librat (në dyshe) dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.			

Hapi i tretë. Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesën e ushtrimit 5 dhe më pas të punojnë në dyshe. Është e rëndësishme të përsëritin këtë veprimtari disa herë, sepse do të përforcojnë mirë rendin rritës dhe rendin zbritës.

Hapi i katërt: Nxënësit ndërtojnë vetë një tabelë si në detyrën 2, duke zgjedhur numrat, me të cilët e fillojnë. Më pas, udhëzohen të kontrollojnë tabelat e njëri-tjetrit dhe të diskutojnë rreth gabimeve të mundshme apo edhe vështirësive.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjetjen e numrave para, pas dhe ndërmjet numrave të dhënë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

Shënim: Në njësitë tjera të kapitullit 1 mund të përdorni aktivitete të njejta me këto që i përdorem në Ditarët e dhënë. Kryesisht vënd të veçantë zë puna me numëratore dhe me paketen e kubeve, shufrave dhe pllakave.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3,4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vazhdojmë të numërojmë			
Fjalët kyçe: numërimi, numërimi me nga 2, numërimi me nga 3 etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** • shkruan dhe lexon vargun e numrave natyror deri në 1000; • numëron me nga 2, 3, 4 dhe 5 duke kërcyer në "Shiritin me numra"; • rendit numrat në rendin rritës për 2, 3, 4 dhe 5.			
• **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri "Matematika 3", fotografi, shiriti me numra.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (argumentimet gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Aktivitete me shiritin me numra Mësuesi/ja vendos në mes të klasës, në dysheme Shiritin me numra, ku janë të shkruar numrat nga 200 deri në 220. Kërkon një nxënës vullnetar, i cili do të kërcejë në shiritin me numra dhe do të lexojë numrat me zë. Më pas, nxënësi i dytë do të kërcejë në çdo të dytin numër dhe do të lexoj me zë. Nxënësi i tretë do të zhvilloj të njëjtën procedurë, duke kërcyer në çdo të tretin numër në shirit. 			

Shiriti mund të vizatohet në dysheme, me shkumësa me ngjyra dhe mund të ndërrohen numrat për të zhvilluar aktivitetin 2 ose 3 herë.

Hapi i dytë: Nxënësit lexojnë kërkesën e ushtrimit 1dhe gjejnë rregullën se si është rritur vargu i numrave (me nga 2)
Udhëzohen nxënësit që të plotësojnë në formë individuale detyrat 2, 3 dhe 4 dhe pas çdo detyre zhvillojmë një diskutim rreth punës së bërë.
Nxënësit ndërrojnë librat (në dyshe) dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi i tretë. Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesën e ushtrimit 4. Është e rëndësishme të gjejnë rregullën se si janë rritur numrat në vargje dhe të bashkëpunojnë gjatë punimit të detyrës.

Hapi i katërt: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe etiketa ku janë të shkruar numra treshifrorë dhe kërkon që secili grup të shkruaj vargje numerike sipas rregullës së dhënë: +2, +3, +4 apo +5. Një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Shkrimi dhe leximi i vargut të numrave natyror deri në 1000.
Plotësimi i vargjeve të numrave sipas rregullës së dhënë.
Shkrimi i një vargu të numrave sipas një rregulle.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: II**	**Klasa: III**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - lexon dhe shkruan numrat natyrorë deri në 1000 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3,4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribuues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vazhdojmë të numërojmë			
Fjalët kyçe: boshti numerik, vargu i numrave, rendi zbritës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** • rendit numrat në rendin zbritës; • përcakton në një grup numrash të dhënë numrin më të madh apo më të vogël; • vendos numrat e dhënë në boshtin numerik sipas rendit zbritës.			
• **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri "Matematika 3", fotografi, boshti numerik në *flipchart*, etiketa ngjitëse.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (argumentimet gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja vendos mbi tavolinë 6-7 numra 3-shifrorë dhe kërkon nga nxënësit që të vijnë t'i renditin këta numra herë në rendin rritës dhe herë zbritës. **Hapi i dytë:** Nxënësve u kërkohet që të vëzhgojnë boshtin numerik dhe të vendosin numrat sipas radhës nga më i vogli te më i madhi. P.sh. 200, 270, 240, 210, 260, 220, 250, 230.  Zhvillojmë një diskutim me nxënësit dhe nxiten të mendojnë se ku dallon rendi zbritës nga rendi rritës.			

Hapi i tretë: Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesat e detyrave 1, 2 dhe 3 dhe të plotësojnë në formë individuale. Nxiten nxënësit të bëjnë pyetje gjatë leximit të kërkesave dhe të kërkojnë sqarime nëse është diçka e paqartë. Pas çdo detyre zhvillojmë një diskutim rreth punës së bërë.
Nxënësit ndërrojnë librat (në dyshe) dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi i katërt: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe etiketa ku janë të shkruar numra treshifrorë dhe kërkon që secili grup të shkruaj vargje numerike sipas rregullës së dhënë: -2, -3, -4 apo -5. Një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Shkrimi dhe leximi i vargut të numrave natyror deri në 1000.
Plotësimi i vargjeve të numrave sipas rregullës së dhënë.
Shkrimi i një vargu të numrave sipas një rregulle.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: 2**	**Klasa: 3**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Identifikon qindëshet dhe dhjetëshet e mijëshes së pare; ▪ Tregon paraardhësin, pasardhësin e numrave deri në 1000 si dhe krahason ata numra.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (3,4,7), Nxënës i suksesshëm III (4,5), Kontribues produktiv IV (2,5), Individ i shëndoshë V (8), Qytetar i përgjegjshëm VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1,2; **3**.1,2,3,4,5,6; **5**.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Numërimi me nga 10 deri në 1000			
Fjalët kyçe: rendi rritës, rendi zbritës, rregulla, vargu numerik, në rritje, në zbritje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Identifikon numrat në tabelë sipas kërkesës së detyrës; • Plotëson vargun e numrave sipas rregullës së dhënë; • Gjen e numrat para, pas dhe ndërmjet numrave të dhënë.			
• **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri"Matematika 3",tabela në flipchart, etiketa me numra treshifrorë;			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (argumentimet gjatë diskutimeve), Edukatë figurative (ngjyrosja dhe vizatimi në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi që qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja vendos në dërrasën e zeze një tabele dhe së bashku me nxënësit bëhet plotësimi i tabelës.			

10 më pak se	Numri	10 më shumë se
	400	
	549	
	645	
	800	

Hapi i dytë:
Nxënësit lexojnë kërkesën e ushtrimit 1, ku udhëzohen të identifikojnë numrat e kërkuar sipas udhëzimeve të detyrës dhe të shkruajnë në libër.
Fokus të veçantë vëmë të nxitja e të menduarit tek fëmijët se cila shifër po ndryshon kur numri rritet apo zbritet për nga 1,10 apo 100.
Nxënësit punojnë në formë individuale edhe detyrat 2 dhe 3. Është e rëndësishme të lexojnë kërkesat e detyrave me kujdes dhe të kërkojnë ndihmë nëse kanë ndonjë paqartësi.
Kryesisht punohet me tabelën e paraqitur në tekst (numrat 201 deri në 300), të cilën do të ishte mirë mësuesi/ja t'a vizatoj në dërrasë të zezë apo në fletë A/1.
Detyrat 4 dhe 5 nxënësit i punojnë në grupe dhe më pas prezantojnë punën e bërë.

Hapi i katërt: Udhëzohen nxënësit që të punojnë në dyshe. Njëri nxënës ia shkruan në fletore shokut/shoqes një numër treshifrorë dhe i vendos një rregull si të shkruaj vargun numerik nga ky numër.
Më pas nxënësit ndërrojnë rolet dhe përsëritet procedura.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjetjen e numrave para, pas dhe ndërmjet numrave të dhënë;
Identifikimin e rregullës se si është shkruar vargu numerik;
Bashkëpunimin në çifte dhe në grupe gjatë aktiviteteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

Shënim: Aktivitete të ngjajshme mund të përdoren edhe tek Njësitë: 1.12 Numërimi me nga 10 deri në 1000 dhe 1.13 Numërimi me nga 100 deri në 1000 .

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** 2	**Klasa:** 3
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (4,7), Nxënës i suksesshëm III (2,4) Kontribues produktiv IV (5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1; **3**.1,3,4,5; **6**.2; **7.**1; **8**.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mbledhja, mbledhorët dhe shuma			
Fjalët kyçe: mbledhje, mbledhorë, shumë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Emërton mbledhorët dhe shumën në barazime; • Gjen mbledhorë të ndryshëm për shumat e dhëna; • Paraqet shumat e numrave në mënyra të ndryshme: në rresht, shtyllë, skemë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri “Matematika 3”.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (shkrimi me fjalë i qindësheve të plota), Edukatë figurative (ngjyrosja dhe vizatimi në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Edukimi për paqe			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja paraqet një barazim me mbledhje në dërrasën e zezë. Kërkon nga nxënësit që të emërtojnë numrat dhe vijnë në përfundim se: Numrat që mblidhen quhen mbledhorë ndërsa përfundimi i mbledhjes quhet shumë. **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të gjejnë mbledhorët dhe shumën në detyrën 1. Më pas, nxënësit punojnë në formë individuale detyrat e tjera të dhëna në tekst, si dhe pas çdo detyre zhvillojmë një diskutim rreth zgjidhjes së bërë. Nxënësit kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit në çifte. **Hapi i tretë:** Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve etiketa me numra dyshifrorë dhe i udhëzon të gjejnë mbledhorë të ndryshëm për shumat e dhëna. Nxënësit punojnë në çifte dhe pas punës së bërë njëri prej dyshes prezanton punën.			

Hapi i katërt: Nxënësit punojnë së bashku duke u bazuar në kërkesën e dhënë në rubrikën "Sot mësova". Mësuesi/ja zhvillon një garë në mes nxënësve duke përsëritur veprimtarinë disa herë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Emërtimin e mbledhorëve dhe shumës në barazime.
Gjetjen e mbledhorëve të ndryshëm për shumat e dhëna.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** 2	**Klasa:** 3
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (4,7), Nxënës i suksesshëm III (2,4) Kontribues produktiv IV (5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1; **3**.1,3,4,5; **6**.2; **7**.1; **8**.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1 më shumë, 10 më shumë, 100 më shumë			
Fjalët kyçe: 1 më shumë, 10 më shumë, 100 më shumë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Kryen veprimet me mend duke mbledhur me 1 më shumë, 10 më shumë dhe 100 më shumë; • Plotëson detyrat e dhëna duke diskutuar zgjidhjen e bërë; • Krijon problema të thjeshta me mbledhje duke shtuar 1, 10 dhe 100.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri “Matematika 3”, etiketa me numra.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (përshkrimi me fjalë i punës së bërë), Edukatë figurative (ngjyrosja dhe vizatimi në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për paqe			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të mundohen të kryejnë veprimet me mend për gjetjen e shumës ku mbledhorit të parë i shtojmë 1,10 apo 100. Nxënësit kryejnë këto veprimtari në formën e një gare. Shpjegon pse është më lehtë të mbledhim me 1, 10 ose 100. **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe fillimisht të plotësojmë vargjet e numrave në ylber sipas rregullave të dhëna. Këtë aktivitet e zhvillon mësuesi/ja bashkërisht me nxënësit. Më pas, ai/ajo ndan detyrat 2,3,4 dhe 5, në secilin grup nga një detyrë. Kërkon nga nxënësit të punojnë së bashku detyrën në fletë A/3 dhe më pas një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë. Gjatë prezantimeve, nxënësit punojnë të gjitha detyrat dhe janë të lirë të pyesin shokun/shoqen për zgjidhjen e paraqitur në prezantim.			

Hapi 3. Udhëzohen nxënësit që në grupe të krijojnë probleme të thjeshta me mbledhje ku kërkohet t'i shtohet mbledhorit të dhënë 1, 10 ose 100.
Grupet i parashtrojnë problemat e krijuara te grupet tjera dhe kërkojnë zgjidhjen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Kryerjen e veprimeve me mend duke mbledhur me 1 më shumë, 10 më shumë dhe 100 më shumë.
Plotësimin e detyrave të dhëna duke diskutuar zgjidhjen e bërë.
Krijimin e problemave të thjeshta me mbledhje i duke shtuar mbledhorit të parë 1, 10 dhe 100.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: 2**	**Klasa: 3**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (4,7), Nxënës i suksesshëm III (2,4) Kontribues produktiv IV (5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : **1.**1,5; **2.**1; **3.**1,3,4,5; **6.**2; **7.**1; **8.**2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mbledhja me disa mbledhorë			
Fjalët kyçe: mbledhorë, shumë, barazim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Kryen mbledhjen me disa mbledhorë duke vrojtuar shembujt e dhënë. • Plotëson detyrat e dhëna duke diskutuar zgjidhjen e bërë. • Përvetëson përmbajtjen e problemës duke nxjerrë të dhënat e saj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri "Matematika 3", etiketa me numra.			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë amtare (përshkrimi me fjalë i punës së bërë), Edukatë figurative (ngjyrosja dhe vizatimi në tekst).
Lidhja me temat ndërkurrikulare
Edukimi për paqe

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Hapi i parë:
Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fisha me situata problemore me mbledhje dhe kërkon që nxënësit t'i mbledhin në rresht dhe në shtyllë. Për shembull, Drita ka 36 lule të kuqe, 27 lule të bardha dhe 4 lule të verdha. Sa lule ka gjithsej?
Disa prej nxënësve prezantojnë punën e bërë dhe bashkërisht diskutohet zgjidhja e problemës.

Hapi i dytë: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe fillimisht të vrojtojnë numrat e dhënë te lulet. Bashkërisht me nxënësit mësuesi/ja gjen zgjidhjen e detyrës 1 dhe diskutojnë mënyrat e ndryshme për të arritur deri te shuma.
Më pas, nxënësit plotësojnë individualisht detyrat 2 dhe 3, si dhe përdorin kartat e semaforit nëse kanë nevojë për ndihmë apo kur e kanë përfunduar detyrën.

Hapi 3. Udhëzohen nxënësit që në grupe të parashtrojnë problemën 4 dhe të bëjnë zgjidhjen në fletë A/3. Njëri nga grupet prezanton punën e bërë, ndërsa grupet tjera diskutojnë zgjidhjen.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Kryerjen e mbledhjes me disa mbledhorë duke vrojtuar shembujt e dhënë.
Plotësimin e detyrave të dhëna duke diskutuar zgjidhjen e bërë.
Përvetësimin e përmbajtjes e problemës duke nxjerrë të dhënat e saj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

Shënim: Njësitë 2.4 deri 2.18 janë lënë në kreativitetin e mësimdhënësit/es, duke marrë parasysh që secila paralele ka specifikat e veta dhe mësimdhënësit e paraleles dinë më së miri të gjejnë metodologjinë adekuate. Vend të veçantë zënë situatat problemore, të cilat bëjnë lidhjen e përmbajtjes me situatat jetësorë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** 2	**Klasa:** 3
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3); Mendimtar kreativ II (4,7); Nxënës i suksesshëm III (2,4); Kontribues produktiv IV (5); Individ i shëndoshë V (5); Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1; **3**.1,3,4,5; **6**.2; 7.1; 8.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 3.1 Zbritja, veprim i kundërt i mbledhjes			
Fjalët kyçe: zbritje, mbledhje, veprim i kundërt.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Argumenton me shembuj që zbritja është veprim i kundërt i mbledhjes; • Shkruan zbritje për mbledhjet e dhëna; • Kontrollon përfundimet me anë të mbledhjeve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri "Matematika 3", foto, pllaka, shufra, kube.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (plotësimi i tekstit), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë Mësuesi/ja paraqet figurën e detyrës 1 në tabelë (të vizatuar në fletë A/1), dhe zhvillon me nxënës një diskutim me anë të pyetjeve të dhëna në tekst. Së bashku nxjerrin përfundimin se: Zbritja 8 – 5 = 3 rrjedh nga mbledhja 5 + 3 = 8 D.m.th. numrin e dardhave të gjelbra e gjejmë me mbledhje. <u>ZBRITJA ËSHTË VEPRIM I KUNDËRT I MBLEDHJES</u> **Hapi i dytë** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë në formë individuale detyrat 2 dhe 3, si dhe për çdo kërkesë të përdorin kartat e semaforit. Pas secilës detyrë, zhvillojmë një diskutim për punën e bërë.			

Hapi 3
Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe ku njëri prej nxënësve të dyshes i jep shokut/shoqes disa barazime me zbritje (ashtu si në det.3) dhe kërkon nga ai/ajo të kontrollojë përfundimet me anë të mbledhjes.
Më pas, nxënësit i ndërrojnë rolet në dyshe dhe përsërisin procedurën.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Argumentimi që zbritja është veprim i kundërt i mbledhjes.
Shkrimi i zbritjeve për mbledhjet e dhëna.
Kontrollimi i përfundimeve me anë të mbledhjeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: 2**	**Klasa: 3**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (4,7), Nxënës i suksesshëm III (2,4) Kontribues produktiv IV (5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1; **3**.1,3,4,5; **6**.2; 7.1; 8.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi			
Fjalët kyçe: Zbritja, i zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Emërton të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin në barazime; • Gjen të zbritshmin dhe zbritësin për ndryshimet e dhëna; • Shkruan barazime me zbritje në mënyra të ndryshme: në rresht, shtyllë, skemë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri"Matematika 3", etiketa me numra dhe barazime me zbritje.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (plotësimi i tekstit), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja paraqet një barazim me zbritje në dërrasën e zezë. Kërkon nga nxënësit që të emërtojnë numrat dhe vijnë në përfundim se: Numrat që zbriten quhen **i zbritshmi** dhe **zbritësi** ndërsa përfundimi i zbritjes quhet **ndryshimi.** **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të ngjyrosin me ngjyrat e dhëna të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin, në detyrën 2. Më pas nxënësit punojnë në formë individuale detyrat tjera të dhëna në tekst dhe pas çdo detyre zhvillojmë një diskutim rreth zgjidhjes së bërë. Nxënësit kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit në çifte(vlerësim i ndërsjellë)			

Hapi i tretë: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve etiketa me kërkesa si p.sh.

I zbritshmi është 50. Ndryshimi është 20. Zbritësi është ____. Si e gjete?	Zbritësi është 15. Ndryshimi është 55. Zbritësi është ____. Si e gjete?

Nxënësit punojnë në çifte dhe pas punës së bërë njëri prej dyshes prezanton punën.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Emërtimin e të zbritëshmin, zbritësin dhe ndryshimin në barazime;
Gjetjen e të zbritëshmin dhe zbritësin për ndryshimet e dhëna;
Shkrimin e barazimeve me zbritje në mënyra të ndryshme: në rresht, shtyllë, skemë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet rubrika: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës: 2**	**Klasa: 3**
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës : Komunikues efektiv I (3), Mendimtar kreativ II (4,7), Nxënës i suksesshëm III (2,4) Kontribues produktiv IV (5), Individ i shëndoshë V (5), Qytetar i përgjegjshëm VI (2,3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,5; **2.**1; **3**.1,3,4,5; **6**.2; 7.1; 8.2.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 1 më pak, 10 më pak, 100 më pak			
Fjalët kyçe: Zbritje, 1 më pak, 10 më pak, 100 më pak			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: • Kryen veprimet me mend duke zbritur me 1 më pak, 10 më pak dhe 100 më pak; • Plotëson detyrat e dhëna duke diskutuar zgjidhjen e bërë; • Krijon problema të thjeshta me zbritje duke hequr 1, 10 dhe 100.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri"Matematika 3", etiketa me numra.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë amtare (plotësimi i tekstit), Edukatë figurative (ngjyrosja në tekst). **Lidhja me temat ndërkurrikulare** Edukimi për qytetari demokratike			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Hapi i parë: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të mundohen të kryejnë veprimet me mend për gjetjen e shumës ku të zbritëshmit i heqim 1,10 apo 100. Nxënësit kryejnë këto veprimtari në formën e një gare. Shpjegon pse është më lehtë të zbresim me 1, 10 ose 100. **Hapi i dytë:** Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hapin librat dhe fillimisht të plotësojmë vargjet e numrave sipas rregullave të dhëna. Këtë aktivitet e zhvillon mësuesi/ja bashkarisht me nxënësit. Më pas ndan detyrat 2,3 dhe 4, në secilin grup nga një detyrë. Kërkon nga nxënësit të punojnë së bashku detyrën në fletë A/3 dhe më pas një pjesëtar i grupit prezanton punën e bërë. Gjatë preazantimeve nxënësit punojnë të gjitha detyrat dhe janë të lirë të pyesin shokun/shoqen për zgjidhjen e paraqitur në prezantim.			

Hapi 3. Udhëzohen nxënësit që në grupe të krijojnë probleme të thjeshta me zbritje ku kërkohet t'i heqen të zbritshmit të dhënë 1, 10 ose 100. Grupet i parashtrojnë problemat e krijuara tek grupet tjera dhe kërkojnë zgjidhjen.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Kryerjen e veprimeve me mend duke zbritur me 1 më pak, 10 më pak dhe 100 më pak; Plotësimin e detyrave të dhëna duke diskutuar zgjidhjen e bërë; Krijimin e problemave të thjeshta me zbritje duke hequr 1, 10 dhe 100.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Punohet rubrika: Tani është radha jote!

Shënim: *Njësitë 31, 3.2 dhe 3.3 janë vetëm një shembull si mund të realizohet Kapitulli3, respektivisht Zbritja e numrave.*
Përgatitjet më të mira të ditarëve mund të jenë nga vet mësuesi/ja e paraleles!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave natyrorë deri në 1000 dhe. ▪ Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Më shumë për zbritjen			
Fjalët kyçe: Zbritje, zbritje njëra pas tjetrës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Gjen barazime duke kryer nga dy zbritje njëra pas tjetrës.. - Zbret numra dyshifrorë në mënyrat e mësipërme. - Jep zgjidhje të ndyshme për problema. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libi, lapas, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e pare: Mësuesi/ja paraqet disa shembuj para klasës: - 9 djem dalin përpara klasës. - Më pas kërkon edhe 4 vajza. - Më pas kërkon edhe 2 vajza. - Sa nxënës janë ngritur para klasës? 9 + 4 + 2 = 15 nxënës. - Më pas kërkon të ulen vjzat. - Sa djem mbetën në këmbë? 15 – 4 – 2 = 11 – 2 = 9. - Këtu vërejmë se në këtë barazim kryhen nga dy zbritje njëra pas tjetrës. - Po nëse ulën djemët, sa vajza do të mbeten në këmbë? 15 - 9 = 6. **Faza e dyte:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në dyshe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe, pastaj edhe në grup me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në dyshe. - Zbulojnë se çfarë gjejnë në çdo zbritje? Ku në bazë të ndryshimit që gjejnë, dinë edhe ngjyrën e tullumbaceve.			

- Zgjedhin problema ku kryhen nga dy zbritje njëra pas tjetrës.
100 – 23 – 35 = 77 – 35 = 42 euro.
Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe të gjithë shembujt 1, 2, 3 dhe 4, mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në dyshe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për të zbritur numra njëri pas tjetrit nga një numër i dhënë, nxënësit në grup do të zgjedhin problema:
Nisu nga një numër dyshifror. Zbriti këtij numri dy numra njëri pas tjetrit dhe shkruaj barazimet. Përsërite këtë disa herë.

84 – 5 – 3 = 79 – 3 = 76
23 – 8 – 5 = 15 – 5 = 10

Nxënësit pas përfundimit me gjithë klasën, analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për të zbritur numrit dy numra njëri pas tjetrit, për të ardhur deri te barazimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Zbaton varshmërinë e ndryshimit nga i zbritshmi, zbritësi dhe pandryshueshmërinë e ndryshimit. ▪ Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Zbritja e numrave dyshifrorë			
Fjalët kyçe: Zbritje, zbritje njëra pas tjetrës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Zbresin në shtyllë numrat dyshifrorë duke zbritur në fillim njëshet pastaj dhjetëshet. - Zbaton zbritjen në problema.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libi, lapas, fletor, petëza të ndryshme.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe sitata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja paraqet shembullin me zbritje, ku nxënësit do të kryejnë zbritjen në disa mënyra: - 87 – 25 = (80 – 20) + (7-5) = 60 + 2 = 62 87 - 25 80 + 7 - (20 + 5) 60 + 2 = 62 87 – 25 = 87 – 20 – 5 = 67 – 5 = 62 87 - 25 62 **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në dyshe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe, pastaj edhe në grup me gjithë klasën. - Zgjedhin një nga mënyrat që dëshirojnë për të kryer zbritjen. - Për të parë nëse e kanë kryer saktë zbritjen, bëjnë provën me anë të mbledhjes. Mbledhin ndryshesën me zbritësin. Shuma duhet të jetë i zbritshmi. - Zbresin njëshet, pastaj zbresin dhjetëshet. Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe të gjithë shembujt 2, 3 dhe 4, mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në dyshe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.			

Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për zbritjen e numrave dyshiforë në mënyra të ndryshm, nxënësit në grup do të zgjedhin problema:

Zgjidh dy numra dyshifrorë. Zbriti në shtyllë dhe gjej ndryshimin. Përsërite këtë disa herë.

88	42
-57	- 20
31	22

Nxënësit pas përfundimt me gjithë klasën, analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për zbritjen e numrave dyshiforë në mënyra të ndryshme, për të ardhur deri te barazimi.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë; ▪ argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shumëzimi dhe mbledhja			
Fjalë kyçe: shumëzim, mbledhje, faktorët, prodhimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kryen shumëzimin duke ndarë në shtyllë njërin nga faktorët. - Përcakton faktorët në bazë të përdasimit. - Jep zgjidhje të ndryshme për problemin me anë të shumëzimit dhe mbledhjes. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, lapsa, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: gjuhë shqip, shkathtësi për jetë, edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Jepet figura me 3 kuti me 5 lapsa. Çdo kuti ka nga 5 lapsa, ku mësuesja i paraqet me vizatim të punuara në hamer. - Sa lapsa kanë 3 kutitë së bashku? - Paraqiteni me anë të mbledhjes. - 5 + 5 + 5 = 15. - Paraqite me anë të shumëzimit. - 5 x 3 = 15. Nxënësi paraqesin dy format me anë të mbledhjes dhe me anë të shumëzimit. Pastaj marrim disa mendime nga nxënësit. **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, lexojnë në dyshe tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe, më pas edhe në grup me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në dyshe. - Paraqesin me anë të mbledhjes dhe shumëzimit.			

- Sa shalqinj ka rreshti?
- Sa shalqinj janë gjithsej?
- Paraqesin me anë të mbledhjes dhe shumëzimit.
- 4 + 4 + 4 = 12 4 x 3 = 12

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe të gjithë shembujt 2 dhe 3, mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në dyshe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për shumëzimin me mbledhje, nxënësit në grup do të gjejnë barazimet dhe do të tregojnë se ku ka mbërritur Blina duke kërcyer në boshtin numerik me nga 2.

- Sa kërcime bëri Blina? 3.
- Me nga sa hapa kërceu Blina në boshtin numerik? Me nga 2.
- Atëherë 2 x 3 = 6.
- Sa kërcime bëri Blina? 8.
- Me nga sa hapa kërceu Blina në boshtin numerik? Me nga 3.
- Atëherë 3 x 8 = 24.
- Sa kërcime bëri Blina? 5.
- Me nga sa hapa kërceu Blina në boshtin numerik? Me nga 5.
- Atëherë 5 x 5 = 25.

Pas përfundimit, nxënësit analizojnë me gjithë klasën detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për shumëzimin me mbledhje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë; ▪ zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në probleme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Faktorët dhe prodhimi			
Fjalët kyçe: Shumëzim, mbledhje, faktorët, prodhimi			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Emërton kufizat e prodhimit. - Kryen veprime e shumëzimit, duke zbatuar vetitë e shumëzimit. - Zgjidhin problema me ndihmën e veprimit të shumëzimit. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, lapsat, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: gjuhë shqip; shkathtësi për jetë; edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Nxënësit shkruajnë se si emërtohen numrat në një shumëzim.  Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, kujtojmë që numrat që shumëzohen quhen faktorë, përfundimi i shumëzimit quhet prodhim. **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, më pas edhe me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në grupe. Ngjyrosin me të verdhë katrorët dhe me të gjelbër prodhimin.			

- Cilët janë faktorët, 2 x 3 = 6?
- Pra, numrat 2 dhe 3 janë faktorë.
- Me cilën ngjyrë duhet t'i ngjyrosim faktorët?
- Me ngjyrën e verdhë.
- Cili është prodhimi tek detyra 8 = 4 x 2?
- Numri 8 është prodhimi.
- Me cilën ngjyrë duhet ta ngjyrosim?
- Prodhimet i ngjyrosim me ngjyrë të gjelbër.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe të gjithë shembujt 1, 2, 3 dhe 4, mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për shumëzimin me mbledhje, nxënësit në dyshe do të gjejnë faktorët:

5 x 4 = 20	12 = 3 x 4
3 x 3 = 9	30 = 6 x 5
8 x 2 = 16	24 = 4 x 6

dhe do të tregojnë për gjetjen e faktorëve.

Pas përfundimit, nxënësit analizojnë me gjithë klasën detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për shumëzimin e saktë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë; ▪ Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: **1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Faktorët dhe prodhimi			
Fjalët kyçe: shumëzim, mbledhje, faktorët, prodhimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kryen veprime e shumëzimit, duke zbatuar vetitë e shumëzimit dhe mbledhjes deri më 5. - Zbaton rregullin për mbledhjen e përsëritur.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, lapsat, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet **ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Kërkohet nga nxënësit të mendojnë se çfarë dinë për shumëzimin. Nxënësit diskutojnë njohuritë me shokun/shoqen e bankës. Mësuesi/ja plotëson tabelën duke shkruar mendimet e nxënësve. - Mbledhja e përsëritur 2+2+2+2+2+2=12 - 2 x 6 = 12 - Faktorët, prodhimi. - Zbatohet në problema. - Kryen veprimi në rresht dhe në shtyllë. **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, më pas edhe me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në grupe.			

Gjejnë prodhimet dhe nxjerrin përfundimet. Vrojtojnë shumëzimin me një faktor dhe gjejnë prodhimin.
- 2 x 0 = 0 2 x 6 = 12 2+2+2+2+2+2=12
- 3 x 0 = 0 3 x 6 = 18 3+3+3+3+3+3=18
- 4 x 0 = 0 4 x 6 = 24 4+4+4+4+4+4=24

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe të gjithë shembujt me tabelën me: 2, 3, 4. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për shumëzimin me mbledhje. Nxënësit në mënyrë individuale do të gjejnë prodhimin me një faktor 5.

5 x 0 = 0 5 x 6 = 30 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 = 30
5 x 1 = 5 5 x 7 = 30 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5+ 5 = 35
5 x 2 = 10 5 x 8 = 40 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 = 40
5 x 3 = 15 5 x 9 = 45 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 = 45
5 x 4 = 20 5 x 10 = 50 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 + 5 = 50
5 X 5 = 25

Pas përfundimit, nxënësit më gjithë klasën analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për shumëzimin me një faktor deri në 5.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Analizon varshmërinë e prodhimit nga faktorët; ▪ Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në probleme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: **1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndërrojmë vendin e faktorëve			
Fjalët kyçe: shumëzim, mbledhje, faktorët, ndërrim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Analizon vetinë e ndërrimit, prodhimi nuk ndryshon kur ndërrojnë vendin faktorët. - Zbaton rregullin për mbledhjen e përsëritur. - Zgjidh problema nga jeta e përditshme.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, lapsat, fletorja, shkopinjtë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja paraqet para nxënësve dy shembuj që tregojnë mënyrën si Era dhe Drini kanë gjetur se sa vezë ka në kuti. Era: 5 + 5 = 10; 5 x 2 = 10 Drini: 2 + 2 + 2 + 2 + 2 = 10; 2 x 5 = 10 - Sa është prodhimi që gjetën secili prej tyre? - Çfarë ndryshimi ka në shumëzimet e tyre? Fëmijët kuptuan se prodhimi nuk ndryshon, edhe nëse u ndërrojnë vendet faktorëve. **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, më pas edhe me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat 2 dhe 3 në grupe. Gjejnë prodhimin duke u ndërruar vendet faktorëve.			

Dhe kuptojnë që vetia e ndërrimeve: prodhimi nuk ndryshon kur ndërrojmë vendin faktorëve.

- 7 x 3 = 3 x 7 = 21
- 4 + 4 + 4 = 12
- 4 x 3 = 12
- 3 x 4 = 12

Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave. Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për ndërrimin e faktorëve, ata do të zgjidhin problemën në dyshe: Në katin e parë të shkollës ka 6 klasa, me nga 3 dritare secila. Sa dritare kanë të gjitha klasat?

3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 = 18

3 x 6 = 18

6 x 3 = 18

Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre më gjithë klasën dhe i komentojnë në dyshe, pastaj në grupe, dhe pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për ndërrimin e faktorëve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Analizon varshmërinë e prodhimit nga faktorët; ▪ Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në probleme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: **1.4**; **2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Grupojmë faktorët			
Fjalët kyçe: shumëzim, mbledhje, faktorët, grupojmë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kryen veprimin e grumbullimit të faktorëve, duke i shoqëruar tre ose më shumë faktorë pa ndryshuar prodhimin. - Zbaton vetinë e grumbullimit të faktorëve për të gjetur më lehtë prodhimin.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** libri, lapsat, fletorja, shkopinjtë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:

Mësuesi/ja paraqet para nxënësve dy shembuj që tregojnë mënyrën si Era dhe Drini e kanë kryer shumëzimin e tre numrave.

Drini	Era
3 x 2 x 4 = (3 x 2) x 4	3 x 2 x 4 = 3 x (2 x 4)
= 6 x 4	= 3 x 8
= 24	= 24

- Cilët numra i ka grupuar Drini?
- Po Era, cilët numra i ka grupuar?
- Sa doli prodhimi i Drinit?
- Po, prodhimi i Erës sa doli?

Fëmijët kuptuan se kur grupojmë në mënyra të ndryshme faktorët, prodhimi nuk ndryshon.

Faza e dytë:

Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, pastaj edhe me gjithë klasën.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat 2 dhe 3 në grupe.

- Grupon faktorët në dy mënyra (me anë të kllapave), ku do të gjejnë prodhimin dhe do të bëjnë krahasimin, a do të ndryshojë prodhimi?
- Gjejnë prodhimin sa më lehtë, duke ndërruar vendet e faktorëve dhe duke i grupuar ata.

Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave. Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për grupimin e faktorëve, ku kjo veti përdoret për të kryer më lehtë shumëzimin, në mënyrë individuale do të zgjidhin detyrën.

$3 \times 4 \times 3 \times 1 = (3 \times 3) \times (4 \times 1)$

$= 9 \times 4$

$= 36$

Pas përfundimit, nxënësit më gjithë klasën analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në dyshe, pastaj në grupe dhe pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për grupuar faktorët për të gjetur me lehtë prodhimin.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Njehson herësin ndërmjet numrave dyshifrorë dhe treshifrorë me numra njëshifrorë. ▪ Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dyfishojmë numrat			
Fjalët kyçe: 2 herë më shumë, 2-fishi, zmadhoje 2 herë, shumëzoje me 2.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Njëson 2-fishin e numrave. - Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave me numra 2 –shifrorë.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, lapast, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe sitata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Kërkohet nga nxënësit të mendojnë se çfarë dinë për dyfishin e numrave. Nxënësit diskutojnë njohuritë me shokun/shoqen e bankës. Mësuesi/ja plotëson tabelën duke shkruar mendimet e nxënësve.  **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, pastaj edhe me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në grupe.			

Gjejnë dyfishin e numrave me anë të mbledhjes dhe shumëzimit.



- Ndajnë numrin 14 në dhjetëshe (20) dhe njëshe (8).
- Shumëzojnë me 2 edhe dhjetëshet edhe njëshet.

- Mbledhin prodhimet e gjetura.
- Pra, 2-fishi i numrit 14 është 28.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe të gjithë shembujt në tabelën 1 dhe 2. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për 2-fishin e numrave, në dyshe ata/ato do të zgjidhin problemat nga jeta e përditshme duke demostruar shkathtësitë dhe shprehitë e tyre.

- Në grupin e atletikës së shkollës kishte 16 vajza. Djem kishte sa 2-fishi i vajzave. Sa fëmijë kishte në grupin e atletikës?



- Ndajmë numrin 16 në dhjetëshe (20) dhe njëshe (6).
- Shumëzojmë me 2 edhe dhjetëshet, edhe njëshet.

- Mbledhim prodhimet e gjetura.
- Pra, 2-fishi i numrit 16 është 32.

- Shkruaj një numër dyshifror, pastaj gjej 2-fishin e tij si në ushtrimin 1. Përsërite këtë disa herë.





Nxënësit pas përfundimit me gjithë klasën, analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për gjetjen e 2-fishit të numrit të dhënë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë. ▪ Zgjidh problema të thjeshta, bazuar në modelet e paraqitura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1); III (1); IV (4).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shumëzojmë me një faktor 8 ose 9			
Fjalët kyçe: Shumëzim, mbledhje, fatorët, prodhimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kryen veprimet e shumëzimit, duke zbatuar vetitë e shumëzimit dhe mbledhjes me 8 dhe 9. - Zbaton rregullën për mbledhjen e përsëritur. - Zgjidh problema të thjeshta në situata konkrete me veprime të shumëzimit.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, lapast, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Kërkohet nga nxënësit të mendojnë se çfarë dinë për shumëzimin. Nxënësit diskutojnë njohuritë me shokun/shoqen e bankës. Mësuesi/ja plotëson tabelën duke shkruar mendimet e nxënësve. - Mbledhja e përsëritur 8+8+8+8+8+8+8+8=64 - 8 x 8 = 64 - Faktorët, prodhimi. - Zbatohet në problema. - Kryen veprimet në rresht dhe në shtyllë. **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, pastaj edhe me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në grupe. Gjejnë prodhimet dhe nxjerrin përfundimet. Vrojtojnë shumëzimin me një faktor dhe gjejnë prodhimin. - Çfarë na kujton shumëzimi me 0? (Prodhimi del 0). - Po shumëzimi me 1? (Prodhimi është sa vetë numri).			

- 0 x 8 = 8 x 0 = 0	8 x 6 = 48	
- 1 x 8 = 8 x 1 = 8	8 x 7 = 56	- Cilët faktor i kemi të panjohur? 8 x8, 8 x 9, 9 x 8, 9 x 9
- 2 x 8 = 8 x 2 = 16	8 x 8 = 64	8+8+8+8+8+8+8+8=64
- 3 x 8 = 8 x 3 = 24	8 x 9 = 72	8+8+8+8+8+8+8+8+8=72
- 4 x 8 = 8 x 4 = 32	8 x 10 = 80	8+8+8+8+8+8+8+8+8+8=80
- 5 x 8 = 8 x 5 = 40		

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe të gjithë shembujt në tabelën 1 dhe 2. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për shumëzimin me mbledhje 8 dhe 9, nxënësit në dyshe do të zgjidhin problemat nga jeta e përditshme.

- Në një fidanishte, fidanët e mollëve ishin mbjellë në rreshta. Çdo rresht kishte 9 fidanë. Sa fidanë ishin në?
- 8 rreshta? 9 rreshta? 7 rreshta?
- 9 x 8 = 72 9 x 9 = 81 9 x 7 = 63

Nxënësit pas përfundimit me gjithë klasën, analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për shumëzimin me një faktor 8 dhe 9.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Analizon varshmërinë e prodhimit nga faktorët. ▪ Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1); III (1); IV (4).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shumëzojmë dhjetëshe të plota			
Fjalët kyçe: Tabela e shumëzimit.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kryen veprimet e shumëzimit, duke zbatuar vetitë e shumëzimit dhe mbledhjes me 10. - Zbaton rregullën për mbledhjen e përseëritur. - Zgjidh problema të thjeshta në situata konkrete me veprime të shumëzimit.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, lapsat, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe sitata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Nxënësit rikujtojnë shumëzimet me faktorët 8 dhe 9. P.sh.: - Si mendoni kur njëri faktor është 8, faktorët e tjerë, cilët do të jenë? (nga 1 deri 9). - Kontrollohen nxënësit në shumëzim. - 8 x 6 9 x 6 - 8 x 7 9 x 7 - 8 x 8 9 x 8 - 8 x 9 9 x 9 - Faktorët janë 8 dhe 9. Sa është prodhimi? - Faktorët janë 9 dhe 7. Sa është prodhimi? - Prodhimi është 81. Sa janë faktorët? - Prodhimi është 54. Sa janë faktorët? **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, vëzhgojnë më vëmendje tabelat. - Çfarë kufizimesh mungojnë? (Prodhimi). - Nxënësi plotësojnë të pavarur prodhimet e kufizave. - Bëhet përsëritje me gojë nga të gjithë nxënësit të tregojnë faktet e shumëzimit deri në10.			

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për shumëzimin me mbledhje deri në 10, nxënësit në dyshe do të zgjidhin problemat nga jeta e përditshme.

- Zgjidh një dhjetëshe të plotë dhe një numër njëshifror. Shumëzoji ata si në ushtrimin 3. Përsërite këtë disa herë.
- 10 x 1 = 10 20 x 4 = 80 50 x 2 = 100

Nxënësit pas përfundimit me gjithë klasën, analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për shumëzimin me një faktor deri në 10.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyror		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Kryen shumëzimin e numrave njëshifrorë me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë. ▪ Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 1000.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1); III (1); IV (4).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 3.7; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shumëzimi i një numri dyshifror me një numër njëshifror			
Fjalët kyçe: Zbërthim, shumëzim, fatorët, prodhimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Gjen prodhimin e një numri dyshifror me një numër njëshifror. - Argumenton vetitë e shumëzimit dhe mbledhjes me numër dyshifror me një numër njëshifror.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri, lapsat, fletorja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe sitata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Nxënësit lexojnë problemën dhe diskutojnë për për veprimin që do të kryejnë. Vrojtojnë si është kryer veprimi i një numri dyshifror me një numër njëshifror. - 32 x 3 = (30 +2) x 3 - = (30 x 3) + (2 x 3) - = 90 + 6 - = 96 **Faza e dytë:** Hapin librin të gjithë nxënësit, në grupe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në grupe, pastaj edhe me gjithë klasën. Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në grupe. Zbërthejnë faktorin e parë dhe gjejnë prodhimin, po ashtu kryejnë shumëzimin në shtyllë. Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe të gjithë shembujt në tabelën 2 dhe 3. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave. Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.			

Faza e tretë: Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për zbërthimin e faktorit të parë dhe gjejnë prodhimin, po ashtu kryejnë shumëzimin në shtyllë. - Në palestrën e shkollës kishte 3 kosha me topa. Çdo kosh kishte 13 topa. Gjej sa topa kishin tre koshat. - 13 x 3 = 39, pra tre koshat kishin 39 topa. Nxënësit, pas përfundimit me gjithë klasën, analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen nxënësit për zbërthimin e faktorit të parë dhe gjejnë prodhimin, po ashtu kryejnë shumëzimin në shtyllë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ paraqet si numra thyesorë paraqitjet grafike të thyesave; ▪ dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie; ▪ cakton pjesën e një tërësie.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; **2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kuptimi i thyesës			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, numëruesi, emëruesi, ndaje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon numëruesin dhe emëruesin në numrat thyesorë. - paraqet me thyesa, pjesë të figurave të paraqitura në tërësi. - analizon pjesën e një tërësie.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Kërkohet nga nxënësit që të ndahen në grupe dhe me plastelinë të formojnë një picë. Ndajmë picën në 4 pjesë të barabarta. Grupi 1: largon nga pica 3 pjesë të barabarta. Grupit 1 i mbeti vetëm një pjesë e picës, të cilën e paraqesim si thyesë ¼ . Grupi 2: largon nga pica 2 pjesë të barabarta. Grupit 2 i mbetën dy pjesë të picës, të cilat i paraqesim si thyesë 2/4 . Grupi 3: largon nga pica 1 pjesë. Grupit 3 i mbetën tri pjesë të picës, të cilat i paraqesim si thyesë ¾ . Paraqesim thyesën ¾ para nxënësve dhe e sqarojmë në detaje bashkërisht. - Numëruesi ← 3 → 3 pjesët e picës që kanë mbetur - Vija e thyesës ------ - Emëruesi ← 4 ← 4 pjesët e tërë e picës - Ç'është numëruesi? - Ç'është emëruesi? - Ç'është vija e thyesës? Nxënësit tregojnë nga sa pjesë të picës ka ngrënë secili grup.			

Faza e dytë:
Të gjithë nxënësit hapin librat. Ata lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe dhe më pas në grup me gjithë klasën.
Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në dyshe.
- Ata duhet t'i paraqesin thyesat sipas figurës.
- Të ngjyrosin figurat aq sa tregojnë thyesat.
- Të ndërtojnë thyesa sipas dëshirës.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe. Mësues/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.

- Ç'është numëruesi?
- Ç'është emëruesi?
- Ç'është vija e thyesës?

Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për thyesat, ndahen në grupe dhe u caktohet një kohë prej 7 minutash për të shkruar në fletoret e tyre se çfarë kanë mësuar nga thyesat.

- Kanë emërues
- Kanë numërues

Thyesat

- Gjysma
- Thyesa të barabarta
- Thyesa tregon një ose disa pjesë të barabarta të një tërësie.

Pasi të kenë përfunduar, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Pastaj, një pjesë e tyre i prezantojnë detyrat para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për përcaktimin e thyesave sipas figurave të hijezuara, ngjyrosjen e figurave sipas thyesës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shkruajnë nga një thyesë, ku numëruesi të jetë më i vogël se emëruesi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie; ▪ cakton pjesën e një tërësie; ▪ krahason thyesat me emërues/numërues të njëjtë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: E tëra, gjysma, çereku			
Fjalët kyçe: thyesë, numëruesi, emëruesi, e plotë, gjysmë, çerek.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon numëruesin dhe emëruesin në numrat thyesorë. - krijon thyesa të plota, gjysmë dhe çerek të një tërësie. - zgjidh problema me gjetjen e një pjese.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe sitata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Kërkohet nga nxënësit të ndahen në grupe dhe me plastelinë të formojnë katror. Ndajmë katrorin në 4 pjesë të barabarta. Grupi 1: ngjyros nga katrori 2 pjesë të barabarta. Grupit 1 i mbetën vetëm dy pjesë të katrorit pa ngjyrosur, të cilat i paraqesim si thyesë 2/4, apo gjysma e figurës. Grupi 2: ngjyros nga katrori 1 pjesë të katrorit. Grupit 3 i mbetën tri pjesë të katrorit pa ngjyrosur, të cilën e paraqesim si thyesë ¼, apo çereku i figurës. Grupi 3: ngjyros nga katrori të tërë pjesë e figurës. Grupit 3 nuk i mbeti asnjë pjesë pa ngjyrosur. Këtë paraqesim si thyesë 4/4, apo një e tërë. Paraqesim thyesat para nxënësve dhe i sqarojmë në detaje bashkërisht. Te thyesat dallojnë emëruesin, numëruesin në numra thyesorë. **Faza e dytë:** Të gjithë nxënësit hapin librat. Ata lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe dhe më pas në grup me gjithë klasën.			

Ata vazhdojnë të punojnë detyrat në dyshe. - Nxënësit qarkojnë detyrat që tregojnë pjesët e ngjyrosura. - Nxënësit lexojnë situatën e dhënë dhe plotësojnë fjalët gjysma ose çereku për çdo situatë të krijuar. Pra, nga këto situata, ata zgjidhin problemat me gjetjen e pjesës. Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës. **Faza e tretë:** Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për thyesat, ndahen në grupe dhe u caktohet një kohë prej 7 minutash. Në mënyrë individuale ata ngjyrosin dhe shkruajnë thyesat: gjysmë, të tërën dhe çerekun. Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Pastaj, disa prej tyre prezantojnë punën para klasës.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësohen nxënësit për përcaktimin e thyesave sipas figurave të hijezuara, ngjyrosjen e figurave sipas thyesës, gjeten e thyesave: e plotë, gjysmë dhe çerekun.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ngjyrosin dhe shkruajnë nga një thyesë: të tërën, gjysmën dhe çerekun.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie; ▪ cakton pjesën e një tërësie.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Thyesa të barabarta			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, numëruesi, emëruesi, barabarta.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore. **Nxënësi/ja:** - dallon numëruesin dhe emëruesin në numrat thyesorë. - paraqet me thyesa pjesë të figurave të paraqitura në tërësi. - analizon pjesën e një tërësie. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsa, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesja/ja ka përgatitur paraprakisht disa fleta për nxënësit, ku ka paraqitur thyesat: Klasa ndahet në grupe dhe secili grup do të gjejë thyesën e dhënë nga mësues/ja: Grupi: 1 Përcakton duke ngjyrosur rrethin ½. Grupi: 2 Përcakton duke ngjyrosur rrethin 2/4. Grupi: 3 Përcakton duke ngjyrosur rrethin 4/8. Grupi: 4 Përcakton duke ngjyrosur rrethin 8/16. ½ = 2/4 = 4/8 = 8/16. Nxënësit i analizojnë dhe i paraqesin në figura këto thyesa. Mësuesi/ja pyet: - Si janë thyesat ndërmjet tyre? Pasi marrim disa mendime nga nxënësit.			

Faza e dytë:
Të gjithë nxënësit hapin librat. Lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt në dyshe dhe pastaj edhe në grup me gjithë klasën.
Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat në dyshe.
- Ata i paraqesin thyesat sipas figurës. Çfarë mund të themi për këto figura?
- Ngjyrosin figurat aq sa tregojnë thyesat, pastaj plotësojnë barazimin e thyesave.
- Paraqesin thyesat në boshtin numerik.

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe pyet vazhdimisht rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohurit për thyesat, ndahen në grupe dhe u caktohet një kohë prej 5-6 minutash, për të gjetur në fletoret e tyre thyesa të tjera të barabarta.
1/3 = 2/6 = 4/12
2/3 = 6/9 = 12/18
3/7 = 6/14 = 9/21
Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Më pas, disa prej tyre prezantojnë detyrat para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për përcaktimin e thyesave sipas figurave të hijezuara, ngjyrosjen e figurave sipas thyesës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shkruajnë nga një thyesë të barabartë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krahason thyesat me emërues/numërues të njëjtë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahasimi i thyesave			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, numëruesi, emëruesi, krahasim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon numëruesin dhe emëruesin në numrat thyesorë. - krahason thyesat me emërues të njëjtë; - analizon krahasimin e thyesave.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesja/ja ka përgatitur paraprakisht me një hamer, thyesat që kanë ngjyrosur: Blina, Drini dhe Era. Mësues/ja bën një bashkëbisedim me nxënësit: - Cili ka ngjyrosur më shumë? - Cili ka ngjyrosur më pak? - Renditim të tria thyesat nga më e vogla, te më e madhja. - Si janë emëruesit e thyesave që krahasove? Pra, nga kjo që mësuam sot, është që kur krahasojmë thyesat me emërues të njëjtë, thyesa më e madhe është ajo që ka numëruesin më të madh. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librat dhe në mënyrë individuale analizojnë shembujt, duke i komentuar pastaj në dyshe dhe në grup me gjithë klasën. Nxënësit ngjyrosin, çdo figurë, aq sa dëshirojnë. Shkruajnë thyesat dhe krahasojnë. - Në sa pjesë është ndarë figura? - Sa pjesë ke ngjyrosur? - Shkruaj thyesat. - Krahaso këto thyesa, cili ka ngjyrosur më shumë?			

Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat 3 në dyshe. Lexo thyesat në boshtin numerik.

- Si janë thyesat: 1/6, 2/6, 3/6... në krahasim më 6/6 ose 1?
- Si janë numëruesit e thyesave të mësipërme me emëruesin?

Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe. Mësues/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave nxënësit.

Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për thyesat, në kohën prej 5-6 minutash ndahen në grupe, ku do të gjejnë në fletoret e tyre thyesa të tjera dhe do të bëjnë krahasime.

Grupi 1. 4/8, 3/8, 1/8

Grupi 2. 3/7, 1/7, 6/7

Grupi 3. 2/9, 4/9, 9/9

Grupi 4. 4/6, 6/6, 3/6

Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Disa prej tyre prezantojnë punën para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për krahasimin e thyesave sipas figurave të hijezuara, ngjyrosjen e figurave sipas thyesës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja shkruan dy thyesa me emërues të njëjtë dhe i krahason ato.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krahason thyesat me emërues/numërues të njëjtë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahasimi i thyesave			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, numëruesi, emëruesi, krahasim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - krahason thyesat me emërues të njëjtë; - analizon krahasimin e thyesave.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesja/ja ka përgatitur paraprakisht me një hamer thyesat: ½ dhe 1/3. Mësues/ja bën një bashkëbisedim me nxënësit: - Cila nga thyesat tregon pjesën më të madhe? - Në sa pjesë është ndarë figura e parë? - Po, pjesë e dytë në sa pjesë është ndarë? - Si janë emëruesit e këtyre dy thyesave? - Po numëruesit e tyre si janë? Mësuesi/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit në klasë, po ashtu diskutojnë për krahasimin e thyesave. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librat dhe në mënyrë individuale analizojnë shembujt, duke i komentuar pastaj në dyshe dhe në grup me gjithë klasën. Nxënësit shkruajnë për pjesët e ngjyrosura dhe pastaj i krahasojnë ato. Pra, nga kjo duhet të dimë se kur krahasojmë thyesat me emërues të njëjtë, thyesa më e madhe është ajo që ka emëruesin më të vogël.			

Nxënësit vazhdojnë të punojnë detyrat 2 dhe në mënyrë individuale analizojnë shembujt, duke i komentuar pastaj në dyshe dhe në grup me gjithë klasën.
Ngjyrosin numër të njëjtë pjesësh në çdo figurë. Shkruajnë thyesat pastaj krahasojnë ato.
Nxënësit vazhdojnë të punojnë në dyshe. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe pyet vazhdimisht rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi kanë përvetësuar njohuritë për thyesat, në kohën prej 5-6 minutash nxënësit ndahen në grupe ku do të analizojnë thyesat në boshtin numerik.
Grupet: 1/3 – 1/4, 2/4 – 2/3, 3/3 – ¾
Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Më pas, një pjesë e tyre prezantojnë detyrat para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për krahasimin e thyesave sipas figurave të hijezuara, ngjyrosjen e figurave sipas thyesës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja shkruan dy thyesa me emërues të njëjtë dhe i krahason ato.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**:II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ mbledh dhe zbret thyesat me emërues të njëjtë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mbledhja e thyesave			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, numëruesi, emëruesi, mbledhje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - bën mbledhjen e thyesave me emërues të njëjtë; - zbaton mbledhjen e thyesave në problema; - analizon mbledhjen e thyesave me emërues të njëjtë.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja, së bashku më nxënësit kujtojnë çfarë dinë për thyesat: Thyesa të barabarta — Krahasimi i thyesave Thyesat Emëruesi — Numëruesi Pjesë e një numri Pra, marrim disa ide dhe mendime nga nxënësit. **Faza e dytë:** Të gjithë nxënësit hapin librat dhe në dyshe lexojnë dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar pastaj në grup me gjithë klasën. Era dhe Mironi të cilët po ngjyrosin një drejtkëndësh të ndarë në 8 pjesë të barabarta. - Gjejmë pjesën që ngjyrosi Era. - Po ashtu edhe pjesën që ngjyrosi Mironi. - Po të dy së bashku? - 3/8 + 4/8 = 7/8			

Faza e dytë:
Të gjithë nxënësit hapin librat dhe në dyshe lexojnë dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar pastaj në grup me gjithë klasën.
Era dhe Mironi të cilët po ngjyrosin një drejtkëndësh të ndarë në 8 pjesë të barabarta.

- Gjejmë pjesën që ngjyrosi Era.
- Po ashtu edhe pjesën që ngjyrosi Mironi.
- Po të dy së bashku?
- 3/8 + 4/8 = 7/8

Mësojmë që shuma e dy thyesave me emërues të njëjtë, është thyesa që ka të njëjtin emërues dhe numëruesi është i barabartë me shumën e numëruesve.

Nxënësit analizojnë figurën e ngjyrosur me tri nuanca, pastaj kryejnë veprimin e mbledhjes. Ata vazhdojnë të punojnë në dyshe. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe pyet vazhdimisht rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për mbledhjen e thyesave, në kohën prej 5-6 minutash ndahen në grupe, ku vizatojnë figura dhe i ndajnë në pjesë të barabarta. Ngjyrosin dhe mbledhin thyesat.
Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Disa prej tyre i prezantojnë para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për mbledhjen e thyesave me emërues të njëjtë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja shkruan dy thyesa me emërues të njëjtë dhe kryen mbledhjen.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ mbledh dhe zbret thyesat me emërues të njëjtë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Zbritja e thyesave			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, numëruesi, emëruesi, zbritja.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen ndryshesën e thyesave me emërues të njëjtë; - zbaton zbritjen e thyesave në problema; - analizon zbritjen e thyesave me emërues të njëjtë.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Nxënësit lexojnë situatën me: Erën dhe Mironin. Ata ngjyrosin së bashku drejtkëndëshin e ndarë në 8 pjesë të barabarta. Era ngjyrosi 3 pjesë, ndërsa Mironi ngjyrosi 4 pjesë. Në grupe, nxënësit diskutojnë për veprimin dhe mënyrën se si do të krijojnë zbritjen e thyesave. - I gjithë drejtkëndëshi është për thyesën, ku duhet ta paraqesin nxënësit 8/8. E tërë figura. - Sa pjesë të drejtkëndëshit ngjyrosën nxënësit së bashku? Nxënësit numërojnë pjesët e ngjyrosura, pra janë 7/8. Pjesa e ngjyrosur. - Sa pjesë të drejtkëndëshit mbetën pa u ngjyrosur? Nxënësit shënojnë 1/8. Pjesa e pangjyrosur. - Atëherë: 8/8 – 7/8 = 1/8 - Si i kanë emëruesit, thyesat në këtë barazim? - Si i zbresim thyesat që kanë emërues të njëjtë? Pra, marrim disa ide dhe mendim. Po ashtu, nxënësve u kujtojmë që: për të zbritur thyesat me emërues të njëjtë, zbresim vetëm numëruesin e tyre.			

Faza e dytë:
Në dyshe, nxënësit, lexojnë dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar pastaj në grup me klasën.
Ata duhet të gjejnë pjesët të pangjyrosura.
Analizojnë zbritjen e thyesave dhe ngjyrosin në figurë aq pjesë sa do të zbriten, pastaj gjen pjesën e pangjyrosur.
Pra, nga kjo mësojmë që ndryshesa e dy thyesave me emërues të njëjtë, është një thyesë me të njëjtin emërues dhe numërues të barabartë me ndryshesën e numëruesve.
$4/4 - 3/4 = 1/4$.

Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për zbritjen e thyesave, në kohën prej 5-6 minutash ndahen në grupe, dhe vizatojnë 2 figura sipas dëshirës. Pastaj i ndajnë në pjesë të barabarta dhe i zbresin thyesat. Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Disa prej tyre prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për zbritjen e thyesave me emërues të njëjtë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shkruan tri thyesa me emërues të njëjtë dhe kryen zbritjen.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie. ▪ cakton pjesën e një tërësie.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjejmë pjesën nga tërësia			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, tërësi, barabartë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen pjesë të një tërësie. - ngjyros më shumë se një pjesë të një tërësie. - analizon ndarjen e një tërësie në grupe të barabarta.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë Nxënësit lexojnë situatën me Gjyshin e Bardhit. i cili bleu 6 mollë. 1/3 e tyre janë të kuqe. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të përgjigjen në disa pyetje: - Ç'pjesë tregon thyesa 1/3? - Ndani mollët në pjesë të barabarta. - 1/3 e 6 mollëve = 2 mollë. - Sa mollë janë të kuqe? Pra, këtë e gjejmë kështu: - ½ e 6 mollëve; 6:3=2 dhe 2x1=2			

Pra, marrim disa ide dhe mendime nga nxënësit.

Faza e dytë

Nxënësit, lexojnë në grupe dhe analizojnë tërësinë e dhënë. Fillimisht ndajnë tërësinë në grupe të barabarta, duke rrethuar, sikurse shembullin në fillim. Ata do të ngjyrosin ½ e 8 mollëve; ¼ e 8 mollëve dhe 1/3 e 9 mollëve.

Analizojnë pjesën nga tërësia e dhënë dhe ngjyrosin mollët sipas kërkesës së dhënë.
Pastaj fillohet me ushtrimin e radhës, ku do të gjejnë më shumë se një pjesë nga tërësia e dhënë. Ata do të ngjyrosin me blu 2/3 e 6 makinave, me portokalli 2/4 e 12 guaskave, me rozë 3/5 e 15 rruazave.

Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për gjetjen e pjesës nga tërësia, nxënësit ndahen në dyshe dhe gjejnë pjesë nga tërësia e dhënë:
2/5 e 10;
1/6 e 24;
¾ e 12.
Në një kohë prej 5-6 minutash, nxënësit ndahen në dyshe ku do të gjejnë pjesë të një tërësie. Pas përfundimit, nxënësit më gjithë klasën analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për zbatimin e gjetjes së pjesës së një tërësie.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja gjen pjesë të një tërësie 2/5 e 20 dhe 2/4 e 12.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ paraqet si numra thyesorë paraqitjet grafike të thyesave. ▪ cakton pjesën e një tërësie.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përsëritim njohuritë			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, çereku, gjysma.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - paraqet thyesat me anë të ngjyrosjes. - përcakton thyesën: 1 të tërën, gjysmën, çerekun. - zbaton veprimet me thyesa në problema.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, fletore.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë Mësuesi/ja paraprakisht ka vizatuar në hamer 3 figura për thyesat, ku e paraqet para nxënësve dhe bashkërisht me nxënësit shkruajnë thyesat për pjesët e ngjyrosura, ku janë: 10/15; 6/8; dhe 2/6. Nxënësit lexojnë situatën, ku bëjnë numërimin e figurave gjithsej dhe figurave të ngjyrosura, pastaj shkruajnë thyesat. Pra, marrim disa ide dhe mendim nga nxënësit.			

Faza e dytë

Nxënësit, hapin librin në grupe, ku do të lexojnë dhe analizojnë detyrat e dhëna nga mësuesi/ja, ku do të ndahen nxënësit në 3 grupe.

- Nxënësit e grupit 1 do të punojnë ushtrimin nr. 2. Ata do të ngjyrosin aq pjesë sa përcaktojnë thyesa, ku do të shkruajnë thyesën për pjesët e pangjyrosura.
- Nxënësit e grupit 2 do të punojnë ushtrimin nr. 3. Ata do të përcaktojnë me anë të ngjyrosjes gjysmën e figurës së dhënë, çerekun e figurës së dhënë dhe 1 të tërë, pra do të zbatojnë në figurat e dhëna.
- Nxënësit e grupit 3 do të punojnë ushtrimin nr. 4. Ata do të paraqesin thyesat që tregojnë gjysmën, çerekun dhe një të tërën.

Ata zbatojnë veprimet me thyesa në problema. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.

Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për zbatimin e veprimeve me thyesa, ata ndahen në dyshe dhe do të ngjyrosin të njëjtën pjesë në figurat e njëjta, pastaj do të shkruajnë thyesat.

Ushtrimi 5

Në figurën tjetër, ½ do të jetë 2/4, kështu vazhdohet edhe me ushtrimet tjera. Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për zbatimin e e veprimeve me thyesa në problema.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja paraqet më thyesë: 4/12 dhe 8/12.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie. ▪ cakton pjesën e një tërësie.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Problema			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, tërësi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen pjesë të një tërësie. - analizon ndarjen e një tërësie në grupe të barabarta. - përcakton thyesën: 1 të tërë, gjysmë, çerekun. - zgjidh veprimet me thyesa në problema.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, fletore, fleta të bardha A4.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë Mësuesi/ja paraprakisht ka planifikuar një aktivitet: Secilit nxënës i vendoset një fletë e bardhë në shpinë dhe kërkojmë nga nxënësit që të lëvizin nëpër klasë, si dhe të shkruajnë në shpinën e secilit shok/shoqe ndonjë detyrë, pyetje çfarë ju intereson për thyesat. Në fund, secili nxënës merr fletën nga shpina dhe i lexon para shokëve, si dhe jep përgjigje për pyetjen, kështu vazhdohet me të gjithë nxënësit. **Faza e dytë** Nxënësit hapin librin ku do të punojnë në grupe me problemat. Mësuesi/ja vendos një grafikë në tabelë, si edhe nxënësit, në fletat që do të kenë përpara, do të shkruajnë të dhënat dhe në anën tjetër zgjidhjen.			

Të dhënat	Zgjidhja
3/8 e tyre po luanin me top. 2/8 e tyre po lëkundeshin në lëkundëse. 1/8 e tyre po luanin me litar. Nxënësit e tjerë kishin hipur në trenin shëtitës. Ç'pjesë e nxënësve kishin hipur në tren?	Sa nxënës po luanin? 3/8 + 2/8 + 1/8 = 6/8 Sa nxënës ishin gjithsej (8/8 është e plotë) 8/8 – 6/8 = 2/8 Sa nxënës kishin hipur në tren? Në tren ishin 2/8 e nxënësve që hipën për të shëtitur.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për problemat e tjera. Punohet ushtrimi 1. 2. 3. 4.

Ata zgjidhin problema me gjetjen e një pjesës së një numri. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.
Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për zbatimin e veprimeve me thyesa, në mënyrë individuale, pastaj në dyshe dhe në grupe, ata punojnë ushtrimin nr. 5.
Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për zgjidhjen e problemave me gjetjen e pjesës së një numri.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja paraqet më thyesë problemën e mëposhtme.
Shitësja e luleve kishte vendosur në një vazo 28 trëndafila. 4/7e tyre i bleu Era.
Sa trëndafila mbetën në vazo?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Numrat thyesë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ dallon thyesat që tregojnë të njëjtën pjesë të një tërësie. ▪ cakton pjesën e një tërësie.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Problema			
Fjalët kyçe: thyesë, pjesë, tërësi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen pjesë të një tërësie. - analizon ndarjen e një tërësie në grupe të barabarta. - përcakton thyesën: 1 të tërën, gjysmën, çerekun. - zgjidh veprimet me thyesa në problema.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, fletore, notesa.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë Mësuesi/ja paraprakisht ka planifikuar një aktivitet: Secili nxënës i kërkohet që në një notesë të shënojë ndonjë figurë ose ndonjë thyesë. Pastaj, t'ia vendosin në shpinë shokut apo shoqes në të djathtë. Shoku apo shoqja që e ka notesën në shpinë, pra të gjithë nxënësit duhet të shëtisin nëpër klasë dhe të bëjnë pyetje lidhur me karakteristikën e thyesës që kanë të vendosur në shpinën e tyre, në mënyrë që të zbulojnë vlerën e asaj thyese apo karakteristikën.			

Faza e dytë

Nxënësit hapin librin ku do të punojnë me problemat në grupe. Mësuesja vendos një grafikë në tabelë, ndërsa nxënësit në fletat që kanë përpara, do të shkruajnë të dhënat dhe në anën tjetër zgjidhjen.

Të dhënat	Zgjidhja
2/10 e librave të Mironit ishin më përralla. 1/10 e librave të Mironit ishin më vjersha. 3/10 e librave të Mironit ishin më tregime. 2/10 e librave të Mironit ishin më përralla. Pjesa tjetër ishin me kuriozitete shkencore. - Ç'pjesë e librave ishin me përralla dhe tregime? - Ç'pjesë e librave ishin me përralla dhe vjersha? - Ç'pjesë e librave ishin me përralla, vjersha dhe tregime? - Ç'pjesë e librave ishin me kuriozitete shkencore?	Ç'pjesë e librave ishin me përralla dhe tregime? 2/10 + 3/ 10 = 5/ 10 ishin me përralla dhe tregime. Ç'pjesë e librave ishin me përralla dhe vjersha? 2/10 + 1/10 = 3/ 10 ishin me përralla dhe vjersha. Ç'pjesë e librave ishin me përralla, vjersha dhe tregime? 2/10 + 1/10 + 3/10 = 6/ 10 ishin me përralla, vjersha dhe tregime. Ç'pjesë e librave ishin me kuriozitete shkencore? 10/10 – 6/10 = 4/10, atëherë libri me kuriozitete shkencore ishte 4/10.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për problemat e tjera. Punohet ushtrimi: 7. 8. 9. 10.

Ata zgjedhin problema me gjetjen e një pjesës së një numri. Mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre në grupe dhe vazhdimisht pyet rreth detyrave.

Pasi të përfundojnë detyrat, mësuesi/ja kalon në një diskutim të përgjithshëm. Disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për zbatimin e veprimeve me thyesa, në mënyrë individuale, pastaj në dyshe dhe në grupe, ata punojnë ushtrimin nr. 11.

Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe, pastaj disa nxënës prezantojnë punën e tyre para gjithë klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për zgjidhjen e problemave me gjetjen e pjesës së një numri.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja paraqet më thyesë problemën e mëposhtme.

Shitësja e luleve kishte vendosur në një vazo 21 trëndafila. 3/7e tyre i bleu Era.

Sa trëndafila mbetën në vazo?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh, duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme; ▪ identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë; ▪ krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Bashkësitë – kuptimi dhe elementet			
Fjalët kyçe: bashkësi, elemente, prerje e bashkësive etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - emërton elementet e bashkësisë; - identifikon elementet e përbashkëta të një bashkësie; - krahason elementet e një bashkësie në varësi nga numri. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore, objekte nga mjedisi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja paraqet para nxënësve disa fruta, si: limon, rrush, mollë dhe kivi. Nxënësit pyeten: - Çfarë janë këto? - A kanë ndonjë veti të njëjtë? - A mund t'i quajmë bashkësi? - Si do ta emëroni bashkësinë e këtyre elementeve? Marrim disa mendime dhe ide nga nxënësit.			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librat dhe në mënyrë individuale lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe, e më pas edhe në grup me gjithë klasën.

- Cili mund të jetë element i bashkësisë?
- Elementet që formojnë bashkësi, a kanë veti të njëjta?

Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, u tregojmë që elementet e bashkësisë nuk mund të jenë vetëm nocione të njëllojta, por edhe të shumëllojta.
Në dyshe, nxënësit vazhdojnë të identifikojnë elementet e një bashkësie, duke i emërtuar ato në bazë të figurave.
Pastaj, në grup diskutojnë dhe komentojnë zgjidhjen e detyrave.
Nxënësit pra vazhdojnë punën tej dhe numërojnë elementet e bashkësive, që emërtuan më lart, duke shënuar poshtë numrin e elementeve brenda bashkësisë.
Nxënësit diskutojnë dhe komentojnë të gjithë shembujt, duke i plotësuar dhe argumentuar. Mësuesi/ja kontrollon nxënësit vazhdimisht.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për bashkësitë, në fletoret e tyre fillojnë të ndërtojnë bashkësinë e numrave dhe zanoreve me anë të diagramit të Venit. Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre dhe i komentojnë në grupe. Më pas, disa prej tyre prezantojnë detyrat para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për kuptimin e bashkësive me anë të diagramit .

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Emërtohen dy bashkësi me 4 dhe 7 elemente.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ paraqet bashkësinë me kllapa gjarpërore dhe përmes diagramit të Venit; ▪ identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë; ▪ jep shembuj për bashkësitë nga jeta e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Paraqitja e bashkësive me kllapa gjarpërore dhe përmes diagramit të Venit			
Fjalët kyçe: grup, elemente, bashkësi, elemente të përbashkëta.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - ndërton bashkësi me kllapa gjarpërore dhe përmes diagramit të Venit. - identifikon elementet e përbashkëta nga ato të ndryshmet. - krijon bashkësi me shembuj nga jeta e përditshme. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore, objekte nga mjedisi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja vizaton një rreth në tabelë dhe në mes shkruan "Bashkësitë". Më pas kërkon nga nxënësit të plotësojnë çfarë dinë për bashkësitë?  			

Faza e dytë:

Nxënësit hapin librat dhe në mënyrë individuale lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt. Më pas i komentojnë në dyshe dhe në grup me gjithë klasën.

- Më çfarë i shënojmë bashkësitë?
- Për çfarë na nevojiten kllapat gjarpërore te bashkësitë?

Nxënësit punojnë në dyshe shembullin, duke komentuar dhe analizuar bashkësinë e kafshëve ujore dhe bashkësinë e insekteve. Ata mund të paraqesin edhe shembuj të tjerë nga jeta e përditshme.

Nxënësit vazhdojnë të lexojnë ushtrimet e tjera, duke ndërtuar bashkësinë e figurave të kaltra sipas diagramit të Venit dhe kllapave gjarpërore. Pastaj, fillohet një diskutim në dyshe duke analizuar dhe komentuar.

- Si quhet vija që rrethon elementet e bashkësisë?
- Nëse elementet përsëriten disa herë, a duhet t'i shkruajmë?
- A i takojnë të gjitha elementet bashkësisë?
- Si e shkruajmë elementin kur i takon dhe kur nuk i takon bashkësisë?

Nxënësit diskutojnë dhe komentojnë të gjithë shembujt duke i plotësuar dhe argumentuar.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për bashkësitë, në fletoret e tyre, fillojnë të ndërtojnë bashkësinë e perimeve nga objektet e paraqitura me anë të diagramit të Venit. Më pas, i analizojnë dhe i komentojnë në grupe. Një pjesë e tyre i prezantojnë detyrat para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e bashkësive me anë të diagramit të Venit dhe kllapave gjarpërore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ndërtojnë 3 bashkësi duke përdorur kllapat gjarpërore dhe diagramin e Venit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve. ▪	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahasimi i bashkësive			
Fjalët kyçe: grup, elemente, bashkësi, elemente të përbashkëta, më pak, më shumë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - krahason bashkësitë në përmbajtjen e tyre; - dallon bashkësitë me elemente më pak apo më shumë. - formon bashkësi me elemente nga jeta e përditshme. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fletore, objekte nga mjedisi, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe sitata jetësore: Gjuhë shqip, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja udhëzon nxënësit që të ndahen në dy grupe. Në anën e majtë, të shkojnë të gjitha vajzat, ndërsa nga ana e djathtë, të gjithë djemtë. Atëherë mësuesi/ja fillon me pyetje: - Sa bashkësi kemi formuar? - I emërtojmë bashkësitë. Bashkësia e vajzave me V dhe bashkësia e djemve me D. - Sa nxënës janë në anën e majtë (vajzave)? - Sa nxënës janë në anën e djathtë (djemve)? - Cila bashkësi ka më shumë elemente? - Cila bashkësi ka më pak elemente? Nxënësit bëjnë krahasimin e shembullit dhe pasi ta kuptojnë kthehen në vendet e tyre.			

Faza e dytë:

Nxënësit hapin librat dhe në mënyrë individuale lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar më pas në dyshe dhe në grup me klasën.

- Më çfarë i shënojmë bashkësitë?
- Për çfarë na nevojiten kllapat gjarpërore te bashkësitë?

Në dyshe, nxënësit punojnë shembullin duke komentuar dhe analizuar bashkësinë e kafshëve ujore dhe bashkësinë e insekteve. Nxënësit mund të paraqesin edhe shembujt të tjerë nga jeta e përditshme.

Nxënësit vazhdojnë të lexojnë ushtrimet e tjera, duke ndërtuar bashkësinë e figurave të kaltra sipas diagramit të Venit dhe kllapave gjarpërore. Pastaj fillojmë një diskutim në dyshe, duke analizuar dhe komentuar.

- Si quhet vija që rrethon elementet e bashkësisë?
- Nëse elementet përsëriten disa herë, a duhet t'i shkruajmë?
- A i takojnë të gjitha elementet bashkësisë?
- Si e shkruajmë elementin kur i takon dhe kur nuk i takon bashkësisë?

Nxënësit diskutojnë dhe komentojnë të gjithë shembujt, duke i plotësuar dhe argumentuar.

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për bashkësitë, punojnë në dyshe. Ata bëjnë krahasimin e bashkësive me numër të elementeve. Pasi ta kuptojnë shembullin e parë, ata fillojnë të numërojnë yjet të cilat gjenden brenda diagramit të Venit dhe tregojnë se a janë të barabarta bashkësia S me bashkësinë U. Nxënësit krahasojnë detyrat e tyre me shokët/shoqet e grupit. Në fund, disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:

Nxënësit punojnë figura më plastelinë sipas dëshirës në mënyrë të pavarur, i vendosin në fletore dhe formojnë bashkësi. Pasi të formojnë bashkësitë, i krahasojnë ato me njëri-tjetrin. Prezantojnë bashkësitë e tyre duke treguar për numrin e elementeve. Kështu vazhdohet derisa të prezantojnë të gjitha grupet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e bashkësive me anë të diagramit të Venit dhe krahasimin e tyre duke numëruar elementet e bashkësisë se ku ka më shumë apo më pak.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Formon dy bashkësi dhe bën krahasimin e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: I	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krijon nënbashkësi nga bashkësitë e dhëna.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Kuptimi i nënbashkësisë			
Fjalët kyçe: grup, elemente, nënbashkësi, elemente të përbashkëta.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - dallon nënbashkësinë e një bashkësie të dhënë; - formon bashkësi sipas cilësive të veçanta të elementeve; - krahason nënbashkësi me numër të njëjtë të elementesh. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyra, lapsa, fleta A4, objekte nga mjedisi, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat dhe të lexojnë shembullin e parë. U kërkohet të lexojnë me vëmendje dhe të nënvizojnë fjalë të reja. U jepet 5-6 minuta kohë, pastaj mësues/ja pyet nxënësit: - Çfarë të fjalësh të reja mësuat nga leximi i shembullit të parë? - Brenda bashkësisë së frutave, a mund të formojmë edhe bashkësi më të vogla, sipas cilësisë së frutave? - Atëherë, a mund të krijojmë bashkësi më të vogla në bazë të ngjyrave? Pasi nxënësit kuptojnë që secili element i bashkësisë A është edhe element i bashkësisë B, atëherë themi që A është nënbashkësi e bashkësisë B. Dhe shënohet A **Faza e dytë:** Pasi nxënësit kuptojnë që secili element i bashkësisë A është edhe element i bashkësisë B, atëherë themi që A është nënbashkësi e bashkësisë B. Dhe shënohet A			

Vazhdohet me shembujt e tjerë, ku nxënësit në mënyrë individuale lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke i komentuar në dyshe dhe më pas në grup me gjithë klasën.

- Cilët janë numrat tek?
- Cilët janë numrat çift?
- Numërojmë elementet brenda bashkësive?
- Krahasojmë nënbashkësi me numër të njëjtë të elementesh

Në dyshe, nxënësit punojnë shembullin duke komentuar dhe analizuar nënbashkësinë e numrave tek dhe numrave çift.

Ata krahasojnë detyrat e tyre me shokët/shoqet e grupit. Në fund, disa nga nxënësit prezantojnë punën e tyre para klasës.

Faza e tretë:

Nxënësit punojnë në grupe në fleta A4, bashkësinë A, një bashkësi me fruta dhe bashkësinë B, një bashkësi me perime.

Prezantojnë bashkësitë e tyre duke treguar për numrin e elementeve. Kështu vazhdohet derisa të prezantojnë të gjitha grupet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e bashkësive dhe nënbashkësive.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Formon një bashkësi dhe brenda saj krijon edhe bashkësi më të vogla.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ klasifikon objektet sipas veçorive të tyre; ▪ gjen unionin e dy bashkësive të dhëna.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Unioni i bashkësive			
Fjalët kyçe: grup, elemente, union, elemente të përbashkëta.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen elementet e përbashkëta nga të dyja bashkësitë; - klasifikon elementet e përbashkëta sipas veçorive; - gjen unionin e dy bashkësive dhe e paraqet me anë të simboleve. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsa, objekte nga mjedisi, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat dhe të lexojnë shembullin e parë. U kërkohet të lexojnë me vëmendje dhe të analizojnë shportën e Benit dhe shportën e Vesës. Pasi nxënësit kanë analizuar të dyja shportat, atëherë i bashkojmë këto dy shporta me një bashkësi të re. U jepet 5-6 minuta kohë, pastaj mësues/ja pyet nxënësit: - Çfarë të rejash mësuat nga analiza që bëtë për dy bashkësitë? - Cilat elemente i bëmë bashkë? - A janë përfshirë të gjitha elementet? Pra, mësuam që bashkimi i elementeve të bashkësisë A dhe bashkësisë B, përbëjnë unionin e bashkësisë A dhe B. Unionin e bashkësi shënohet **A B.**			

Faza e dytë:
Pasi nxënësit kuptojnë shembullin e sipërm, vazhdojnë me shembujt në vazhdim dhe punojnë në grupe detyrat e dhëna nga mësues/ja.
Grupi i parë: vazhdon duke bashkuar bashkësinë A dhe bashkësinë B. Gjejmë bashkësinë **A B**, me kllapa gjarpërore dhe me anë të diagramit të Venit.

Grupi i dytë: vazhdon me shembullin tjetër ku gjejnë unionin e bashkësive A dhe bashkësisë B, elementet e bashkësisë së cilës element i bashkësisë A është edhe element i bashkësisë B, me numrat e dhënë.

Grupi i tretë: vazhdon me shembullin tjetër ku gjen unionin e bashkësive A dhe bashkësisë B, elementet e bashkësisë secili element i bashkësisë A është edhe element i bashkësisë B, me figurat e dhëna.

Në secilin grup përzgjidhet një përfaqësues, i cili prezanton punën para klasës. Ata demonstrojnë shembujt në tabelë, duke i komentuar me klasën.

Faza e tretë:
Nxënësit punojnë shembullin në mënyrë individuale, me anë të diagramit të Venit dhe më kllapa gjarpërore, ku paraqesin unionin e bashkësive të dhëna.
Prezantojnë bashkësitë e tyre duke treguar për numrin e elementeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e bashkësive.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Formon një bashkësi me diagramin e Venit dhe kllapa gjarpërore, ku paraqiten unionin e bashkësive
A = {3, 6, 10, 5}
B = {a, z, 3 }
A B = { ___ , ___ , ___ ,___ ,___ ,___ ,___ }.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive (prerjen); ▪ jep shembuj për bashkësitë nga jeta e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Prerja e bashkësive			
Fjalët kyçe: grup, elemente, prerje, elemente të përbashkëta.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen elementet e përbashkëta nga të dyja bashkësitë; - gjen prerjen e dy bashkësive dhe e paraqet me anë të simboleve; - vizaton diagramin e Venit për elementet e duhura. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsa, objekte nga mjedisi, plastelinë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja udhëzon nxënësit që të hapin librat dhe të lexojnë shembullin e parë. U kërkohet të lexojnë me vëmendje dhe të analizojnë shportën me fruta të Besit dhe shportën me fruta të Vesës. Pasi nxënësit kanë analizuar të dyja shportat u jepet 5-6 minuta kohë. Pastaj, mësues/ja pyet nxënësit: - A ka ndonjë frutë që u pëlqen edhe Besit edhe Vesës? - Nxënësit identifikojnë frutat e preferuara nga të dy. - Sa nga frutat u pëlqejnë të dyve? - Nxënësit vizatojnë diagramin e Venit dhe vendosin frutat që u pëlqejnë të dyve. Pra, nga ky shembull mësuam se, elementet e përbashkëta të dy bashkësive A dhe B, përbëjnë prerjen e bashkësive dhe e shënojmë **A B**.			

Faza e dytë:
Pasi nxënësit kuptojnë shembullin e sipërm, vazhdojnë me shembujt në vazhdim dhe në grupe do të punojnë detyrat e dhëna nga mësues/ja.
Grupi i parë: vazhdon të gjejë prerjen e bashkësisë A dhe bashkësisë B, **A B**, me anë të kllapave gjarpërore dhe diagramit të Venit.

Grupi i dytë: vazhdon me shembullin tjetër, ku gjejnë prerjen e bashkësisë A dhe bashkësisë B, me figurat e dhëna.

Grupi i tretë: vazhdon me shembullin tjetër, ku gjen prerjen e bashkësisë A dhe bashkësisë B, të paraqitura me diagramin e Venit dhe kllapa gjarpërore.

Faza e tretë:
Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në fleta A4, prerjen e bashkësisë A dhe bashkësisë B me elemente nga klasa. Pastaj, me anë të kllapave gjarpërore dhe diagramit të Venit, e paraqesin në fletë.
Prezantojnë bashkësitë e përbashkëta, të cilat i kanë vizatuar në letër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e bashkësive.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Formon një bashkësi me diagramin e Venit dhe kllapa gjarpërore, ku paraqet prerjen e bashkësive
A = {5, 1, 13, a}
B = {a, k, 3, 5, 13 }
A B = { ___, ___, ___ }.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ jep shembuj për bashkësitë nga jeta e përditshme; ▪ paraqet shembuj praktik nga jeta lidhur me relacionet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Problema			
Fjalët kyçe: grup, elemente, elemente të përbashkëta, unin, kllapa gjarpërore, diagrami i Venit.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen shembuj nga jeta e përditshme; - formon bashkësi në bazë të shenjave identifikuese; - argumenton elementet e e bashkësive të paraqitura në diagramin e Venit. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsa, objekte nga mjedisi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësues/ja udhëzon nxënësit që të dalin nga banka dhe të lëvizin në klasë në mënyrë të lirë. Në momentin që mësuesi/ja thotë mësuesja "ndal", nxënësit ndalen dhe u parashtrohen pyetje, për të cilat duhet të përgjigjen. - Çfarë ju pëlqen më shumë te problemat? - Cilat veprime përdoren për të zgjidhur problemat? Pra, pasi marrim disa përgjigje nxënësit ulën në vendet e tyre. **Faza e dytë:** U kërkohet nxënësve të hapin librat. Udhëzohen që të punojnë në dyshe, ku do të lexojnë detyrën individualisht. Pastaj, njëri nxënës lexon udhëzimin, tjetri jep përgjigjen dhe i rrumbullakësojnë përgjigjet e sakta, duke i diskutuar bashkërisht. Kështu vazhdohet edhe me ushtrimet e tjera. Pra, në këtë formë do të veprohet me të gjitha ushtrimet, ku do të shkëmbehen mendime nga të gjithë nxënësit.			

Faza e tretë: Nxënësit punojnë në grup ushtrimin e 4-t. Paraqesin diagramin e Venit dhe kllapat gjarpërorë. Në bazë të figurave, gjejnë unionin dhe prerjen e bashkësisë A dhe bashkësisë B. Pasi të kenë përfunduar punën, çdo përfaqësues grupi do të tregoëj formimin e problemave. Diskutohen bashkërisht, duke argumentuar e duke dhënë mendime.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Vlerësimi bëhet në bazë të aftësive që kanë për zgjidhjen e problemave dhe mënyrën e gjykimit të fakteve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Formoni dy bashkësi dhe shkruani elementet e përbashkëta.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Bashkësitë dhe relacionet		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krijon relacione ndërmjet dy bashkësive të dhëna; ▪ paraqet shembuj praktik nga jeta lidhur me relacionet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 6.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Relacionet ndërmjet dy bashkësive			
Fjalët kyçe: grup, elemente, relacion.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - krijon relacione mes figurave duke zbatuar rregulla; - paraqet elemente me veti të përbashkëta nga jeta reale; - formon bashkësi duke u bazuar në vetitë e tyre. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, objekte nga mjedisi.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Faza e parë:

Mësues/ja shkruan në tabelë numra që mblidhen, zbriten ose shumëzohen me njëri-tjetrin. Po ashtu, shkruan edhe rezultatet e tyre, por në mënyrë të përzier. Pastaj, kërkon nga nxënësit që nga mbledhja e tyre të gjejë shumën, ndryshimin dhe prodhimin.

3 + 5 = = 10 7 ·3 = = 46

= 21 50 – 4 = 5 ·2 = = 8

- Me cilin numër mund të lidhet mbledhori 3 + 5 = ? kështu vazhdohet me pyetje- përgjigje, derisa të shoqërohen të gjithë numrat.

Faza e dytë:

U kërkohet nxënësve të hapin librat dhe udhëzohen për të punuar në dyshe. Më pas do të bëjnë lidhjen/ relacionin mes elementeve të bashkësisë A dhe elementeve të bashkësisë B.

Në këtë mënyrë bëhet edhe relacioni me kafshët dhe të vegjlit e tyre. Pra, kjo lidhje quhet relacion.

Nxënësit mund të japin edhe shembuj nga jeta e përditshme duke i diskutuar bashkërisht.

Faza e tretë:

Nxënësit ndahen në tre grupe dhe punojnë ushtrimin e radhës. Secili grup ka shembullin për të paraqitur relacionin mes të dy bashkësive

Grupi i parë: krijon relacionet duke pjesëtuar.

Grupi i dytë: krijon relacionet duke mbledhur.

Grupi i tretë: krijon relacionet duke zbritur.

Secili grup i paraqet në diagramin e Venit dhe i prezanton para grupeve të tjera, duke argumentuar dhe duke dhënë mendime.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi bëhet për aftësitë që kanë në zgjidhjen e problemave dhe mënyrën e gjykimit të fakteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Formoni dy bashkësi dhe gjeni relacionin mes tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde; ▪ përdor tonelatën (t), kilogramin (kg),dhe gramin (g) si njësi matëse të peshës dhe kryen veprime me këto njësi; ▪ zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë, peshën dhe kohën;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Konvertimet e njësive për matjen e masës			
Fjalët kyçe: matje e masës, tonelata, kilogrami, grami.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - kryen matjen e masës me anë të tonelatës, gramit dhe kilogramit; - konverton njësitë e masës të rënda me ato të lehta apo anasjellas; - zgjidh problema me fjalë në lidhje me peshën.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** shumëfishat e kilogramit dhe nënfishat e kilogramit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:
Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë dini për njësitë e masës.



Nxënësit shprehnin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, hapin librin dhe u jepet kohë për të lexuar. Marrim mendimet e nxënësve dhe diskutojmë me ta. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë **një bashkëbisedim me** klasën.

Faza e dytë:
Nxënësit lexojnë në grupe materialin teorik. Pastaj fillojmë me konvertimet e njësive për matjen e masës. Ata punojnë në grupe, mësuesi/ja vëzhgon vazhdimisht punën në grupe.

- Nxënësit vazhdojnë me konvertimin e njësive për masën, duke i shndërruar në nënfisha dhe shumëfisha të kilogramit.
- Nxënësit bëjnë renditjen e gjatësisë, duke filluar nga më i vogëli te më i madhi.
- Zgjidhin problema me fjalë lidhur me peshën.
- Nxënësit tregojnë se një 1 kg është 1000 herë më i madh se 1 g.
- Nxënësit tregojnë që 1 g është 1000 herë më i vogël se 1 kg.

Në grupe, nxënësit punojnë ushtrimin 1, 2, 3 në libër. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe analizojmë të gjitha detyrat. Diskutojnë në grup e mandej edhe pranë gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Në dyshe, nxënësit bëjnë konvertimin e detyrave:

Grami	1000	2000	3000	4000	5000
Kilogrami	1	2	3	4	5

1 kg = 1000g
2 kg = 1 kg + 1 kg
2 kg = 1000 g + 1000 g
2 kg – 2000 g
Më pas kërkohet nga nxënësit të paraqesin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për njohuritë që japin për matjen me saktësi: me tonelatë, kilogram, gram.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ përdor litrin (l) si njësi për matjen e lëngjeve dhe kryen veprime me këtë njësi; ▪ krahason objekte të ndryshme bazuar në matjet e bëra; ▪ krahason vëllimin e trupave bazuar në vëzhgimet që bën.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2); III (2); V (8); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Matja e vëllimit të lëngjeve			
Fjalët kyçe: matje e lëngjeve, litri, mililitri.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - përdorin litrin si njësi të matjes së kapacitetit dhe vëllimit të lëngjeve; - përcakton kapacitetin dhe vëllimin e lëngut; - krahason vëllimin e trupave.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** gota, shishe, ujë.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Pyesim nxënësit se për matjen e gjatësisë së objekteve shkollore kemi përdorur njësitë matëse: centimetrin, milimetrin, decimetrin, metrin, po për njësitë për matjen e masës kemi përdorur: tonelatën, kilogramin, gramin për matjen e kapaciteteve dhe vëllimit të lëngjeve çfarë përdorim? - Marrim mendime nga nxënësit dhe i shënojmë **në tabelë**. - Mësuesi/ja tregon se njësitë standarde për matjen e vëllimit janë: - Mililitri (ml); - Litri (l); Mësuesja demonstron ushtrimin para nxënësve, ku merr një shishe të mbushur me ujë dhe një gotë të zbrazët, pastaj zbrazim shishen me uj**ë në gotë.**			

- **Çfarë do të ndodhë**?
- Pse po derdhet uji nga gota?

Pra, shishja zë më shumë ujë sesa gota.

- Cila është me e madhe: shishja apo gota?

Nxënësit shprehnin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën.
Pasi marrim disa mendime nga nxënësit.
Nxënësit hapin librin dhe u jepet kohë për të lexuar në dyshe.

Faza e dytë:
Kërkohet nga nxënësit të lexojnë në grupe materialin.

- Si quhet sasia e lëngut që e mbanë një enë?
- Si quhet sasia që tregon sa është mbushur gota?

Nxënësit sjellin shembuj të ndryshëm nga jeta e përditshme që kanë të bëjnë me vëllimin.

- Si e shënojmë litrin?
- Po mililitrin?

1 litër = 1000 mililitra
1 l = 1000 ml.

- Për të matur kapacitetet më të vogla, çfar**ë** përdorim?
- Po për të matur kapacitetet më të mëdha?
- Keni ndonjë shishe të ujit, ku mund t**ë** tregojm**ë** sa mililitra të uj**ë** zë ajo?

Nxënësit kanë disa objekte ku duhet të tregojnë se çfarë kapaciteti 1-6, ku do të fillojnë nga kapaciteti më i vogël tek më i madhi.
Në grupe plotësojnë fjalitë duke përdorur njësitë l apo ml.
Sasia e kapacitetit të shishes së vogël të ujit matet me mililitër (ml).
Sasia e kapacitetit të shishes së ilaçit matet me mililitër (ml).
Sasia e kapacitetit të bidonit të ujit matet me litër (l).
Kështu vazhdojnë edhe me shembujt e tjerë. Nxënësit zgjidhin detyrat duke punuar në grupe, mësuesi/ja vëzhgon vazhdimisht punën e tyre. Ata punojnë në grupe ushtrimin 1, 2, 3, 4 në libër. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, e mandej me gjithë klasën. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Në dyshe, nxënësit plotësojnë fjalitë duke përdorur njësitë l apo ml. Do të vizatojnë në fletoret e tyre 3 shishe, ku do të përcaktojnë se deri ku është e mbushur shishja me ujë, sa mililitra ujë ka shishja.
Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin, duke plotësuar ushtrimin dhe bëjnë krahasimin e detyrave. Më pas kërkohet nga ata të bisedojnë në grupe dhe disa nga nxënësit të paraqesin para klasës punimet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për punën në grupe, përcaktimin e sasisë së kapacitetit të ujit. Vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë aktiviteteve. Vlerësohen për shprehje për qëndrimin e tyre në situatat dhe diskutimet gjatë orës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde; ▪ përdor litrin (l) si njësi për matjen e lëngjeve dhe kryen veprime me këtë njësi; ▪ zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë, peshën dhe kohën.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Konvertimet e njësive për matjen e masës			
Fjalët kyçe: Matje e vëllimit, litri, mililitri.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - kryen matjen e masës së vëllimit me anë të litrit dhe mililitrit; - konverton njësitë e masës të rënda me ato të lehta apo anasjellas; - zgjidh problema me fjalë në lidhje me vëllimin.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** shishe, uji, lapsa, fletoret, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë dini për njësitë e matjes së vëllimit.  			

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, hapin librat dhe u jepet kohë për të lexuar. Marrim mendimet e nxënësve dhe diskutojmë me ta. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjn**ë një bashkëbisedim me tërë klasën.**

Faza e dytë:
Nga nxënësit të lexojnë në grupe materialin teorike. Pastaj fillojmë me konvertimet e njësive për matjen e vëllimit. Ata punojnë në grupe, mësuesi/ja vëzhgon vazhdimisht punën në grupe.

- Nxënësit vazhdojnë me konvertimin e njësive për vëllim, duke i shndërruar në nënfisha të litrit.
- Nxënësit rrethojnë kapacitetin më të madh te secili çift.
- Nxënësit duhet të mbushin secilën shishe që të ketë një litër, secila shishe përmban ujë të ndryshëm. Nxënësit duhet të llogaritin dhe të gjejnë se edhe sa ujë nevojitet për të bërë një litër ujë.
- Nxënësit duhet të konvertojnë vëllimet e produkteve në mililitra dhe në litra.

Në grupe, nxënësit punojnë ushtrimin 1, 2, 3, 4 në libër. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe i analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, mandej me gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Në dyshe, nxënësit bëjnë zgjidhjen e detyrave me problema me fjalë.

- Sa ujë piu Beni gjithsej? 2l 250 ml
- A janë më shumë a më pak se 3 litra? Më pak.
- Sa litra më shumë? Duhet të pijë edhe 750 ml.

Më pas kërkohet nga nxënësit të paraqesin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për njohuritë që japin për matjen me saktësi: për konvertimin e matjes së vëllimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde; ▪ përcakton njësitë për matjen e kohës (dita, ora, minuta); ▪ zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë, peshën dhe kohën;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Matja e kohës			
Fjalët kyçe: ora e murit, ora mësimore orë, minuta, sekonda.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nx**ënësi**/ja:** - njeh njësitë matëse të kohës; - shkruan saktë orën, duke përcaktuar kohën e ditës; - zgjidh problema të thjeshta me njësitë e kohës.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ora e murit, libri, lapsat.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë dini për njësitë e orës.  			

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, hapin librat dhe u jepet kohë për të lexuar. Marrim mendimet e nxënësve dhe diskutojmë me ta. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjn**ë një bashkëbisedim me tërë klasën.**

Faza e dytë:
Kërkohet nga nxënësit të lexojnë në grupe materialin teorik. Pastaj fillojmë të punojnë në dyshe, si lexohet ora, mësuesi/ja vëzhgon vazhdimisht punën në dyshe.

- Sa akrepa ka ora?
- Përcakto rolin e secilit akrep?
- Me anë të vijave, nxënësit tregojnë orën me kohën që u përgjigjet. Ata mbajnë shënime vazhdimisht.

Në grupe, nxënësit punojnë ushtrimin 1, 2, 3 në libër. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, e mandej me gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Në mënyrë individuale, nxënësit bëjnë zgjidhjen e detyrave duke lidhur orën me kohën që i përgjigjet.

- Shtatë e dyzet e pesë. Nxënësit duhet të gjejnë orën që i përket. Akrepi i vogël duhet te jetë në mes të numrit 7 dhe 8, ndërsa akrepi i madh te numri 9. Pra, ora është 7:45 apo 7h 45 min.

Kështu vazhdohet edhe me shembujt e tjerë. Më pas, kërkohet nga nxënësit ta paraqesin para klasës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për njohuritë që japin për matjen me saktë të orës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Njësitë matëse		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ kryen matje të ndryshme duke përdorur njësitë standarde; ▪ përcakton njësitë për matjen e kohës (dita, ora, minuta); ▪ zgjidh problema me fjalë në lidhje me gjatësinë, peshën dhe kohën.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Konvertimi i njësive për matjen e kohës			
Fjalët kyçe: ora e murit, ora mësimore orë, minuta, sekonda.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - përcakton kohën me anë të orës; - llogarit intervalet kohore, duke bërë konvertimin e njësive të kohës; - zgjidh problema të thjeshta me njësitë e kohës.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ora e murit, libri, lapsat.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë dini për njësitë **e orës**.  			

Nxënësit do të konvertojnë duke përcaktuar njësitë matëse të kohës

- 2 h x 60 = 120 min.
- 3600 s : 60 = 60 min
- 360 min : 60 = 6 h
- 48 orë : 24 = 2 ditë.
- **3 ditë x 24** = 72 h.
- 3 min x 60 = 180 s

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, hapin librin dhe u jepet kohë për t'i shkruar. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë **një bashkëbisedim me tërë klasën.**

Faza e dytë:

Nga nxënësit kërkojmë të lexojnë në grupe, pastaj fillojmë të punojnë në dyshe si lexohet ora. Mësuesi/ja vëzhgon vazhdimisht punën në dyshe.

- Nxënësit llogaritin intervalin kohor , duke konvertuar njësitë e kohës.
- Sa sekonda duhen shtuar në kutin bosh, që të kemi 1 minutë?
- Sa minuta duhen shtuar në kutinë bosh, që të kemi 1 orë?
- Sa orë duhen shtuar në kutinë bosh, që të kemi 1 ditë?

Nxënësit llogaritin intervalet kohore, duke konvertuar njësit e kohës.

Në grupe, nxënësit punojnë ushtrimin 2, 3, 4 në libër. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe analizojmë të gjitha detyrat. Ata diskutojnë në grup, e mandej edhe pranë gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:

Nxënësit ndahen në 6 grupe, ku mësuesi/ja do të shpërndajë për secilin grup nga problemë të thjeshtë me njësitë e kohës.

Grupi 1. Detyrën 5. – 120 minuta
Grupi 2. Detyrën 6. – Blini
Grupi 3. Detyrën 7. – 18 minuta
Grupi 4. Detyrën 8. – 45 minuta
Grupi 5. Detyrën 9. – 4 h 10 min
Grupi 6. Detyrën 9. – 7 : 15

Në fund do të diskutohet për 6 grupet, ku do të japin përgjigje dhe do të tregojnë mënyrën se si kanë ardhur deri te përgjigjja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për dhënien e mendimeve, për qëndrimin aktiv në mësim dhe saktësinë në informacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ mbledh dhe zbret paratë (euro deri në 1000).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Paratë			
Fjalët kyçe: para, monedha, kartëmonedha.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - njeh disa monedha dhe kartëmonedha të përditshme në vendin tonë; - këmben monedhat me kartëmonedha dhe anasjellas; - zgjidh problema të thjeshta me paratë.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** para të printuara, libri, lapsa.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë din**ë për paratë**.  Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, hapin librin dhe u jepet kohë për t'i shkruar. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjn**ë një bashkëbisedim me tërë klasën.**			

Faza e dytë:
Nga nxënësit kërkojmë të lexojnë në grupe, pastaj fillojmë të punojnë në grupe dhe të njihen me paratë. Pasi njihen me paratë (euro), do të qarkojnë të njëjtën vlerë.

- Vëzhgo monedhat dhe kartëmonedhat.
- Çfarë vetie e përbashkët i karakterizon këto?
- A mund të këmbehen midis tyre pa e ndryshuar vlerën?
- 5 euro.
- 10 euro
- 50 euro

Nxënësit do të kenë shumën e parave, pastaj do të gjejnë njërin nga mbledhorët. Sa para u nevojiten për të formuar shumën e duhur.

- 20 euro = 1 (10 euro) + 2 (5 euro)
- Si bëhet llogaritja e parave?

Nxënësit bëjnë llogaritjen e parave duke punuar në grupe. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe i analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, e mandej me gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Nxënësit ndahen në dyshe, ku mësuesi/ja do të paraqesë një situatë problemore:
23 + 12 = 35 EURO
50 – 35 = 15 euro
Nxënësit rrumbullakojnë paratë që mendojnë se i ka kthyer arkëtari.
Në fund, do të diskutohet me grupet, ku do të japin përgjigje dhe do të tregojnë formën se si kanë ardhur deri tek përgjigja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për dhënien e mendimeve, për qëndrimin aktiv në mësim dhe saktësinë në informacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ mbledh dhe zbret paratë (euro deri në 1000).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Paratë			
Fjalët kyçe: para, monedha, kartëmonedha.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - njeh disa monedhat dhe kartëmonedha të përditshme në vendin tonë; - këmben monedhat me kartëmonedha dhe anasjellas.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** para të printuara, libri, lapsa.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë dini për vlerën dhe simbolin e parave?  Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, hapin librin dhe u jepet kohë për t'i shkruar.			

Faza e dytë:
Nga nxënësit kërkojmë të lexojnë në grupe, pastaj fillojmë të punojnë në grupe dhe të njihen me paratë. Pasi njihen me paratë (centët), nxënësit do të qarkojnë të njëjtën vlerë:

- Vëzhgo monedhat dhe kartëmonedhat.
- Çfarë vetie e përbashkët i karakterizon këto?
- A mund të këmbehem midis tyre, pa e ndryshuar vlerën?
- 1 euro.
- 2 euro
- 5 euro

Nxënësit do të kenë shumën e parave, pastaj do të gjejnë njërin nga mbledhorët. Sa para u nevojiten për të formuar shumën e duhur.

- 1 euro = 1 (50 cent) + 5 (10 cent)
- Si bëhet llogaritja e parave?

Nxënësit bëjnë llogaritjen e parave duke punuar në grupe. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, e mandej edhe pranë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Nxënësit ndahen në dyshe, ku mësuesi/ja do të paraqesë një situatë problemore:
4 € = 400 c
300 c = 3 €
2 € 74 c = 200 c + 74 c = 274 c
536 c = 500 c + 36 c = 5 € 36 c
Nxënësit vrojtojnë këmbimet dhe shpjegojnë se si janë kryer.
Në fund do të diskutohet me grupet, ku do të japin përgjigje dhe do të tregojnë formën se si kanë ardhur deri tek përgjigjja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për dhënien e mendimeve, për qëndrimin aktiv në mësim dhe saktësinë në informacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ mbledh dhe zbret paratë (euro deri në 1000).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Veprime me para			
Fjalët kyçe: Para, monedha, kartëmonedha, këmbim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - kryen mbledhjen me vlera të ndryshme parash; - zgjidh problema të thjeshta me paratë.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** para të printuara, libri, lapsat.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja paraqet dy raste te nxënësit lidhur me shpenzimet që i kanë bërë fëmijët: Klasa ndahet në dy grupe: Grupi 1 - do të tregojë se si i ka shpenzuar Blina paratë: 3 € 85 c Grupi 2 - do të tregojë se si i ka shpenzuar Drini paratë: 8 € 12 c Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën.			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librat dhe fillojnë punën. Ata punojnë në grup ku, kryejnë mbledhjen në fillim centët, nëse janë 100 c ose më shumë, këmbe 100 c me 1 euro. Ushtrimin 2 dhe 3.
Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pasi marrim disa mendime nga nxënësit, u drejtohet pyetja:

- Si bëhet llogaritja e parave?

Nxënësit bëjnë llogaritjen e parave duke punuar në grupe. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe i analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, e mandej edhe pranë gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:
Nxënësit ndahen në dyshe, ku mësuesi/ja do të paraqesë një situatë problemore:
4 euro 25 c – 3 euro 51 c = 74 c
Në fund do të diskutohet me grupet, ku do të japin përgjigje dhe do të tregojnë formën se si kanë ardhur deri tek përgjigja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për dhënien e mendimeve, për qëndrimin aktiv në mësim dhe saktësinë në informacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Numrat natyrorë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ mbledh dhe zbret paratë (euro deri në 1000).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Veprime me para			
Fjalët kyçe: para, monedha, kartëmonedha, këmbim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - kryen zbritjen me vlera të ndryshme parash; - zgjidh problema të thjeshta me paratë.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** para të printuara, libri, lapsa.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja paraqet dy raste te nxënësit lidhur me shpenzimet që kanë bërë fëmijët: Klasa ndahet në dy grupe dhe gjejnë sa para u mbeten Drinit dhe Blinës: Grupi 1 - do të tregojë se si i ka shpenzuar Drini paratë: 7 € 43 c Grupi 2 - do të tregojë se si i ka shpenzuar Blina paratë: 6 € 94 c Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pastaj marrim disa mendime nga nxënësit.			

Faza e dytë:

Nxënësit hapin librin dhe fillojnë punën. Ata punojnë në grup ku, zbresin **në fillim centët, nëse janë 100 c ose më shumë, këmbe 100 c me 1 euro. Ushtrimin 2 dhe 3.**

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe bëjnë një bashkëbisedim me tërë klasën. Pastaj marrim disa mendime nga nxënësit.

- Si bëhet llogaritja e parave?

Nxënësit bëjnë llogaritjen e parave duke punuar në grupe. Marrim mendime të ndryshme nga nxënësit dhe i analizojmë të gjitha detyrat. Nxënësit diskutojnë në grup, e mandej edhe pranë gjithë klasës. Korrigjohen gabimet.

Faza e tretë:

Nxënësit ndahen në dyshe, ku mësuesi/ja do të paraqesë një situatë problemore:

3 euro 25 c – 2 euro 60 c = 65 c

Në fund do të diskutohet me grupet, ku do të japin përgjigje dhe do të tregojnë formën se si kanë ardhur deri te përgjigja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për dhënien e mendimeve, për qëndrimin aktiv në mësim dhe saktësinë në informacion.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punon: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Sipërfaqja		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Ngjyros sipërfaqet e brendshme të figurave të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.2; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 4.3; 6.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjyrosja e sipërfaqes së brendshme të figurave			
Fjalët kyçe: figura të ndryshme, ngjyrosje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Ngjyros sipërfaqen e brendshme të figurave të ndryshme. - Identifikon emrat e figurave të ngjyrosura. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, fleta të bardha.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja del së bashku me nxënësit në oborrin e shkollës. Kërkohet nga nxënësit që të gjejnë diçka në oborr, që nuk ngjason me karakterin e tyre, pra është krejt e kundërta. Pasi nxënësit të kenë **zgjedhur diçka që nuk është fare si** ata, fillojmë prezantimin. Unë nuk jam lule, sepse ato janë bimë. Unë nuk jam libër, sepse marrë frymë etj. Kështu vazhdohet me prezantimin e të gjithë nxënësve, **të cilët duhet të arsyetojnë pse gjëja që kanë zgjedhur është e kundërt me ta.** **Faza e dytë:** Të gjithë nxënësit hapin librin; në dyshe lexojnë tekstin dhe analizojnë shembujt, duke ngjyrosur sipërfaqen e brendshme të figurave. Mësues/ja pyet nxënësit: - Çfarë figure krijuat? Pastaj, fillojnë me plotësimin e shembujve, shkruajnë emrin e figurës. **Faza e tretë:** Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë e tyre rreth figurave dhe ngjyrosjes së tyre, udhëzohen të punojnë ndonjë figurë që iu pëlqen dha e ngjyrosin sipas dëshirës. Pas përfundimit, nxënësit analizojnë detyrat e tyre në klasë dhe tregojnë për vetitë e figurave që kanë ngjyrosur.			
VLERËSIMI I NXËNËSVE			
Vlerësohen nxënësit për ngjyrosjen e figurave. Diskutim me klasën për të gjetur se me çfarë iu ngjasojnë figurat.			
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR			
Vizaton ose ndërton figura të ndryshme dhe prezanton figurën duke treguar karakteristikat e saj.			

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Sipërfaqja		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Ngjyros sipërfaqet e brendshme të figurave të ndryshme. ▪ Bën dallimin në mes të sipërfaqes së brendshme dhe të jashtme të figurës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.2; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 4.3; 6.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sipërfaqja e brendshme dhe sipërfaqja e jashtme e figurave			
Fjalët kyçe: figura të ndryshme, ngjyrosje, brenda, jashtë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Ngjyros sipërfaqen e brendshme apo të jashtme. - Dallon sipërfaqen e brendshme dhe të jashtme, me shembuj nga jeta e përditshme. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** ngjyrat, lapsat, top.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Kërkohet që nxënësit të bëhen rreth dhe marrim një top, pastaj nxënësit fillojnë t'ia hedhin topin shoku-shokut. Nxënësi, i cili kap topin, duhet të thotë emrin e tij dhe njëkohësisht t'i përgjigjet pyetjes së shokut, pyetje që mund të lidhet me jetën e tyre personale, me gjëra që ata pëlqejnë apo edhe me mësimin. Nxënësi, i cili kap topin, tregon emrin e tij dhe i përgjigjet pyetjes, duke dhënë edhe arsyetim për përgjigjen e dhënë dhe pastaj ia gjuan topin një shoku/shoqe tjetër, i cili duhet ta përsëritë aktivitetin. Mund të zgjidhni cilindo shok/shoqe për t'ia hedhur topin. Nxënësit, të cilit i bie topi nga dora, ka për detyrë që të futet brenda në rreth dhe t'i përgjigjet pyetjeve, të cilat duhet t'ia bëjë çdo nxënës, lidhur më temën që është duke u trajtuar. Kështu bëhet aktiviteti deri sa të përfshihen të gjithë nxënësit. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librin për të lexuar tekstin në dyshe dhe analizojnë shembujt, duke ngjyrosur sipërfaqen e jashtme të figurës. Mësuesi/ja pyet nxënësit: - Në figurën, në të cilën është vizatuar ylli, cila pjesë është ngjyrosur? - Si mund ta quajmë pjesën e jashtme të figurës?			

Nga kjo kuptojmë që sipërfaqja duhet të ngjyroset.

- Po ylli, a është brenda apo jashtë sipërfaqes?

Nxënësit, pasi arrijnë të kuptojnë dallimin e brendshëm dhe të jashtëm, fillojnë ushtrimin me radhë duke bashkëpunuar në çifte.

Nxënësve iu jepen udhëzimet që të bëjnë dallimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Nxënësi bashkëbisedojnë më njeri-tjetrin, mësues/ja vëzhgon nxënësit duke punuar.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë për të bërë dallimin e jashtëm dhe të brendshëm, në mënyrë individuale, ata vizatojnë fletoret e tyre dy figura sipas dëshirës, ku duhet të bëjnë dallimin me ngjyrosjen e sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme.

Pas përfundimit, nxënësit së bashku analizojnë detyrat e tyre dhe tregojnë për dallimin e figurave që ndodhen jashtë dhe brenda sipërfaqes.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për ngjyrosjen dhe dallimin e figurave që gjenden jashtë dhe brenda sipërfaqes.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Vizaton figura të ndryshme dhe prezanton figurën duke treguar karakteristikat e saj, bën dallimin duke treguar figura kur është jashtë dhe brenda sipërfaqes.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa**: III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Dallon drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe segmentin, dhe i përkufizon ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4); III (3, 4, 5, 6); V (8); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtëza, gjysmëdrejtëza dhe segmenti			
Fjalët kyçe: drejtëz, gjysmëdrejtëz, segment, vijë e drejtë, e lakuar.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - identifikon drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe segmentin në figurat gjeometrike; - krahason vijat e drejta me ato të lakuara në figurat gjeometrike; - demonstron shembuj me drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe segmentin. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa me ngjyra, litar, metër, pe.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:

Mësuesi/ja vendo në tabelë disa figura të thjeshta, si më poshtë:



Fytyrë e gëzuar re rruga

Për disa minuta, nxënësit do të identifikojnë disa nga llojet e vijave. Mendimet e tyre i paraqesim në tabelë.



Faza e dytë:
Nxënësit hapin librat dhe punojnë në grupe. Ata/ato diskutojmë për të gjitha rastet dhe do të mësojnë që dy pika mund të bashkojnë një vijë, andaj në gjeometri vijat mund të jenë të drejta dhe të lakuara.
Kërohet nga nxënësit që të bëjnë matjen e vijave, ku duhet të bëjnë dallimin e gjatësisë së vijës së drejtë dhe vijës së lakuar. Matja mund **të bëhet me anë të perit, metrit apo vizor**es, ku do të plotësojnë sa centimetër është gjatësia e segmentit dhe pastaj do të diskutohet dhe do të krahasohet dhe secili rast te vija e drejtë dhe e lakuar. Pastaj, nxënësit do të punojnë detyrat në mënyrë individuale në librin e tyre dhe do të kontrollojnë njëri-tjetrin.
Më pas, klasa ndahet në tri grupe, ku me anë **të litarit do të** demonstrojnë gjetjen e rrugës nga pika A te pika B. Të tria grupet do **të nisen nga pika A** për të arritur te pika B. Dallimi do të jetë rruga e drejtë dhe dy rrugë të lakuara ku nxënësit do të bëjnë dallimin:



Cila është rruga më e shkurtër?
Cila është rruga më e gjatë?
Faza e tretë:
Pra, cilat cilësi i përkasin drejtëzës, gjysmëdrejtëzës dhe segmentit. Ashtu të ndarë **në grupe**, nxënësit do të punojnë pastaj do të prezantojnë para klasës.
Drejtëza – vijë e pakufizuar në të dyja anët, pa fillim, pa mbarim, horizontale, vertikale dhe shënohet me shkronja të vogla (a, b).
Segmenti – vijë e drejtë, ka fillim, ka mbarim, vertikale, horizontale, shënohet me AB.
Gjysmëdrejtëza – vijë e drejtë, me fillim, pa mbarim, vertikale, horizontale.
Nxënësit kthen në vendin e tyre dhe identifikojnë shembujt më drejtëz, gjysmëdrejtëz dhe segment.

Më pas kërkohet nga nxënësit të vizatojnë në fletoret e tyre: drejtëzën, gjysmëdrejtëzën dhe segmentin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim vlerësohen nxënësit për diskutimin në grup, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive dhe për ndërtimin e saktë të drejtëzës, gjysmëdrejtëzës dhe segmentit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit punojnë shembuj të ndryshëm me vija të drejta, të lakuara.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ dallon këndet dhe llojet e këndeve (kënd i drejtë, i ngushtë i gjerë).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I(3); II (1, 8); III (1, 2, 4, 6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Këndet			
Fjalët kyçe: kënd, krahë, kulmi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon këndin si një figurë gjeometrike; - identifikon krahët, kulmin dhe këndet e figurave gjeometrike; - analizon elementet e figurës gjeometrike. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, trekëndësh, fletore pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja fillon me një diskutim rreth njësisë së kaluar. - **Çfarë është drejtëza?** - A ka fillim dhe mbarim drejtëza? - **Çfarë është gjysmëdrejtëza?** - A ka fillim dhe mbarim gjysmëdrejtëza? - Çfarë është segmenti? - A ka fillim dhe mbarim segmenti? **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librat dhe lexojnë tekstin. Në **bashkëpunim me** shokun/shoqen e bankës, nënvizojnë paqartësitë dhe diskutojnë **në dyshe**. Për **çdo paqartësi** mbajnë shënime. Pas disa minutash, **mësuesi/ja pyet nxënësit:** - Çfarë **mësuat të re në këtë njësi mësimore?**			

- Si ndërtohet këndi?
- Mësuesi/ja vizaton në tabelë dy gjysmëdrejtëza, **të cilat** formojnë një kënd.



Pra, nga kjo kuptojmë që dallojmë kënde të ndryshme edhe nga jeta e përditshme. N**ë bazë të shembujve** nxënësit dallojnë dhe diskutojnë për gjetjen e këndeve brenda në dhomën e pritjes dhe në rrugë. Pastaj emërtojnë këndet. Nxënësit diskutojnë me shokun/shoqen e bankës për llojin e këndit dhe vendin se ku i gjejnë këndet.

Faza e tretë:
N**ë mënyrë të pavarur**, nxënësit vizatojnë me vizore në fletoret e tyre objekte që u pëlqejnë dhe pastaj identifikojnë këndet. Ata/ato kanë për detyrë të tregojnë si formohen krahët, kulmi dhe këndet.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim vlerësohen nxënësit për diskutimin në grup, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive dhe për ndërtimin e saktë të këndeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Vizato ndonjë objekt dhe pastaj gjej kulmin, këndin dhe krahët.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krahason segmentet e ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 7); III (1, 2, 4); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e këndeve			
Fjalët kyçe: kënd, kënd i drejtë, kënd i ngushtë, kënd i gjerë, kënd i shtrirë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - krahason llojet e këndeve: të ngushta, të drejta, të gjera dhe të shtrira; - vizaton llojet e këndeve: kënd i drejtë, këndë i ngushtë dhe kënd i shtrirë; - analizon llojet e këndeve të ngushta, të drejta, të gjera dhe të shtrira. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, trekëndësh, ora e murit, fletore pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja fillon me një diskutim me nxënësit, duke i pyetur se çfarë din**ë** për këndet.  Nxënësit japin mendime të ndryshme dhe i shënojnë ato. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librat dhe lexojnë tekstin. Në bashkëpunim me shokun/shoqen e bankës, nënvizojnë paqartësitë dhe diskutojnë në dyshe. Për çdo paqartësi, mbajnë shënime.			

Pas disa minutash **mësuesi/ja pyet nxënësit:**

- **Çfarë mësuat të re në këtë njësi mësimore?**
- Si ndërtohet këndi?
- Mësuesi/ja vizaton në tabelë dy gjysmëdrejtëza, **të cilat** formojnë një kënd.



Pra, nga kjo kuptojmë
që dallojmë kënde të ndryshme.

Kur kemi kënde të ngushta.
Si mund të quajmë këtë kënd?

Kënd më i vogël se kënd i drejtë quhet kënd i ngushtë

Kur kemi kënde të drejta.
Si mund të quajmë këtë kënd?

Kënd i drejtë

Kur kemi kënde të shtrira.
Si mund të quajmë këtë kënd?

Kur kemi kënde të gjera.
Si mund të quajmë këtë kënd?

Kënd i cili është sa dy kënde të drejta quhet kënd i shtrirë.



Kënd më i madh se kënd i drejtë, quhet kënd i gjerë.



Pra, këndet mund t'i përcaktojmë
sipas masës që kanë:



Faza e tretë:
Pra, që nxënësit të mund të marrin shembuj të ndryshëm edhe brenda klasës, ne kemi menduar që të interpretojmë edhe përmes akrepave të orës.

Nëse njërin nga akrepat e orës e çojmë te numri 1 dhe akrepin tjetër te numrin 3.
Si quhet këndi i formuar? Nxënësit mund të përgjigjen, që në këtë rast, kemi këndin e ngushtë.

Nëse njërin nga akrepat e orës e çojmë te numri 12 dhe akrepin tjetër te numrin 3.
Si quhet këndi që formohet? Nxënësit mund të përgjigjen, që në këtë rast, kemi këndin e drejtë.

Nëse njërin nga akrepat e orës e çojmë te numrin 12 dhe akrepin tjetër te numri 6.
Si mund ta quajmë këtë kënd? Nxënësit mund të përgjigjen që, në këtë rast, kemi këndin e shtrirë.

Kështu mund të vazhdohet edhe me shembuj të tjerë.

Me vizore, nxënësit vizatojnë në fletoren e tyre të gjitha llojet e këndeve dhe më pas i emërtojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim nxënësit vlerësohen për diskutimin në grup, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive dhe për ndërtimin e saktë të këndeve dhe emërtimin e këndeve të ngushta, të drejta, të gjera dhe të shtrira.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Vizato trekëndëshin dhe shkruaj karakteristikat e këndit, kulmit dhe krahët.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ krahason segmentet e ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7, 8); III (1, 2, 5, 6); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krahasimi i segmenteve			
Fjalët kyçe: drejtëza, vija, segmenti, më i gjatë, më i shkurtër.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - krahason llojet e segmenteve; - demonstron me anë të lojës dhe formo segmente; - analizon renditjen e segmenteve nga më i madhi te më i vogli. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, trekëndësh, fletore pune, fije peri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja fillon me një lojë, ku merr topin me penj. Nxënësit formojnë një rreth dhe pastaj, njëri tyre mban fijen e perit dhe e pason te shoku apo shoqja. Kështu vazhdohet derisa të përfshihen të gjithë nxënësit në këtë aktivitet. Pastaj, shohim se ne po krijojmë vija zigzage, ku janë krijuar shumë segmente. **Më pas,** kur të përfundojnë, **mësues/ja pyet nxënësit:** - **Çfarë kemi krijuar**? - A ka fillim dhe mbarim segmenti? - Sa skaje ka segmenti? - Me çfarë emërohet segmenti? - Llojet e segmenteve, a mund **të jenë** të pjerrët, horizontalë, vertikalë? Diskutojmë më nxënësit, marrim pyetje nga ata. Me anë të lojës, fillimisht përftuan me penj një drejtëz, pastaj përftuan segmentin që kishte dy skaje, të cilat i emëruan me shkronja AB.			

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit bëjnë matjen e segmenteve me anë të vizores dhe pastaj plotësojnë librin. Nxënësit krahasojnë segmentet e matura me anë të vizores dhe i renditin ato nga më e vogla te më e madhja. Më pas, diskutojnë në grupe.

Faza e tretë:
Nxënësit ndahen në tri grupe, ku do të bëjnë matjen e rrugëve A, B, C. Secili grup prezanton para klasës dhe do të bëjnë krahasimin se cila rrugë ishte më e gjatë dhe cila rrugë më e shkurtër.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim, nxënësit vlerësohen për diskutimin në grup, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive dhe për matjen e saktë dhe krahasimin e segmenteve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja vizaton 6 segmente sipas dëshirës, pastaj i rendit ato nga më i vogëli te më i madhi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** • cakton pozitën e dy drejtëzave - drejtëza paralele, drejtëza normale dhe prerjen e drejtëzave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 8); III (4, 5, 6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtëza paralele, drejtëza normale dhe drejtëzat prerëse.			
Fjalët kyçe: drejtëza, vija, segmenti, drejtëz paralele, normale dhe prerëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - dallon drejtëzat paralele, normale dhe prerëse; - ndërton drejtëzat paralele, normale dhe prerëse; - identifikon në një mjedis drejtëzat paralele, normale dhe prerëse. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** drejtëza, drejtëza paralele, drejtëza normale, drejtëza prerëse.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja paraqet tri figura në tabelë: Nxënësit ndahen në tri grupe dhe secili grup merr nga një figurë. Më pas, do të komentojnë dhe analizojnë figurat e dhëna në tabelë. Pas 3-4 minutave analizë nga nxënësit, fillojmë me disa pyetje: - **Çfarë mendoni kur shihni këto vizatime?** - A mendoni se kanë fund drejtëzat? - Këto drejtëza, a mund të formojnë kënde? Nxënësit japin mendimet dhe idetë e tyre rreth këtyre pyetjeve, ku diskutojmë bashkërisht me gjithë klasën			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librat dhe lexojnë tekstin me shokun/shoqen e bankës, rreth 4-5 minuta. Pastaj, fillojmë me disa pyetje:

- **Çfarë mësuat për drejtëzat nga leximi i tekstit?**
- **Çfarë lloj** drejtëzash kemi?
- Identifikoni llojet e drejtëzave?
- Ku priten këto drejtëza?
- **Çfarë formojmë në pikën e prerjes?**

Nxënësit përqendrohen te shembulli për të identifikuar drejtëzat paralele, priten dhe drejtëzat normale.
Mësuesi/ja tregon që drejtëzat paralele shënohen a|| b dhe nuk priten asnjëherë.
Drejtëzat normale shënohen dhe priten kur formojnë kënde të drejta.

Faza e tretë:
Nxënësit vizatojnë në fletoret e tyre drejtëzat paralele, normale dhe prerëse, ku caktojnë pozitën e tyre. Nga secili grup, del nga një nxënës para klasës dhe prezanton punimet në fletore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim, nxënësit vlerësohen për diskutimin në grup, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive dhe për caktimin e pozitës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ndërtohen me vizore drejtëza prerëse, paralele dhe normale.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** • emërton figurat gjeometrike, si: trekëndëshi, drejtkëndëshi, katrori, rrethi etj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1, 8); III (2, 3); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Emërtimi i figurave gjeometrike			
Fjalët kyçe: trekëndësh, drejtkëndësh, katror, rreth.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - emërton figurat gjeometrike, si: trekëndëshi, drejtkëndëshi, katrori, rrethi. - shpjegon karakteristikat e figurave gjeometrike (trekëndëshi, drejtkëndëshi, katrori, rrethi). **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa, pliko, pazëll.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja përgatit disa figura gjeometrike në formë pazëlli dhe shpërndan në grupe plikot, brenda të cilave gjenden figurat gjeometrike. Nxënësit marrin plikot dhe fillojnë të formojnë figura me pazëll. Çdo grup ka forma gjeometrike të ndryshme (trekëndësh, katërkëndësh, rreth). Pas formimit **të figurave** gjeometrike, nxënësit emërtojnë figurat që kanë ndërtuar dhe i prezantojnë para klasës. Pra, çdo grup ka formuar figurat gjeometrike, trekëndëshin, katërkëndëshin dhe rrethin. Mësues/ja pyet nxënësit: - Cilat figura janë krijuar me pazëll? - A mund të themi se këto figura kanë brinjë? - **Çfarë elemente**sh kanë shumëkëndëshat? - A mund të jetë rrethi shumëkëndësh? **Faza e dytë:** Hapet libri dhe në dyshe, nxënësit lexojnë udhëzimet e dhëna në libër, **për 6-8 minuta**. **Më pas**, diskutojnë në grupe siç ishin më parë, ku mësues/ja kishe përgatitur prap**ë** pliko, brenda të cilave ka vendosur figura gjeometrike. Në çdo pliko janë futur nga 5 figura gjeometrike, me forma të ndryshme. Plikot ndahen në grupe, ku njëri pliko do të ketë 5 trekëndësha, njëri do të ketë 5 katërkëndësha dhe në plikon tjetër do të ketë 5 rrath**ë** me madhësi të ndryshme.			

Në **grupe**, nxënësit do të ekspozojnë në bankat e tyre format gjeometrike, ku do të gjejnë të përbashkëtat e këtyre figurave gjeometrike dhe do t'i emërtojnë ato.
Nxënësit do të shkruajnë disa nga karakteristikat **që dinë për figurat që** kanë krijuar.

3 brinjë
Figurë gjeometrike
Vija të thyera
3 krahë 3 kulme
3 kënde

Trekëndëshi

4 brinjë
Figurë gjeometrike
4 kulme
4 krahë janë normalë me njëri-tjetrin.
Brinjët përballë njëra-tjetrës janë paralele.
Drejtkëndëshat me brinjë të barabarta janë katrorë.

katërkëndëshi

Vija të lakuara, **të mbyllura**.

Rrethi

Largësi të njëjtë nga qendra.

Faza e tretë:
Në **mënyrë individuale**, nxënësit paraqesin **në fletoret e tyre** figurat gjeometrike dhe emërtojnë elementet e secilës figurë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim, nxënësit vlerësohen për punën individuale në lidhje me identifikimin e figurave gjeometrike. Po ashtu, nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë aktivitete, për dhënien të ideve, për pjesëmarrjen aktive dhe për emërtimin e saktë dhe krahasimin e figurave gjeometrike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja vizaton trekëndëshin, katrorin, katërkëndëshin dhe rrethin. Po ashtu, përshkruan karakteristikat e secilës figurë gjeometrike.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** • përkufizon shumëkëndëshin dhe tregon llojet e tij; • përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e figurave gjeometrike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1, 4); III (1, 3).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shumëkëndëshat			
Fjalët kyçe: Shumëkëndësh, brinjë, kulm, kënde.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - shpjegon veçoritë kryesore të shumëkëndëshave; - përcakton elementet kryesore të shumëkëndëshave. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, fleta të bardha, lapsa, fletore pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja u shpërndan fleta të bardha nxënësve, ku secili duhet të shkruajë tri karakteristika për ndonjë figurë gjeometrike. Pasi të kenë përfunduar nxënësit, **mësues/ja grumbullon fleta**t. Nxënësit përzgjedhin nga një fletë dhe në bazë të karakteristikave që ka shkuar shoku apo shoqja dhe në bazë të elementeve të shkruara në letër, gjejnë për cilën figurë gjeometrike bëhet fjalë. **Faza e dytë:** Hapet libri dhe nxënësit do të lexojnë tekstin me shokun/shoqen e bankës, 4-5 minuta. Pastaj, fillojmë me disa pyetje: - Si quhen shumëkëndëshat që i kanë të gjitha brinjët dhe këndet e barabarta? Nisur nga numri i brinjëve, këndeve dhe kulmeve, e kemi **më të lehtë të përcaktojmë** emërtimin e shumëkëndëshave. **Në çdo shumëkëndësh**, numri i brinjëve është i barabartë me numrin e këndeve.			

Faza e tretë: Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë rreth shumëkëndëshave dhe llojet e tyre, në mënyrë individuale, plotësojnë tabelën **e dhënë në libër.** Pastaj nxënësit shkëmbejnë me shokun/shoqen shembujt në tabelë.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Në përfundim, nxënësit vlerësohen për diskutimin në grup, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Punon nga kartoni figurat gjeometrike shumëkëndëshe: trekëndëshin, pesëkëndëshin apo gjashtëkëndëshin.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** • jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (4, 8); III (4, 5, 6); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Klasifikimi i trekëndëshave			
Fjalët kyçe: trekëndësh, trekëndësh barabrinjës, trekëndësh kënddrejtë, trekëndësh brinjëndryshëm, trekëndësh barakrahës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - tregon shembuj të llojeve të trekëndëshave kënddrejtë, barabrinjës, barakrahës dhe brinjëndryshëm; - përshkruajnë karakteristikat trekëndëshave kënddrejtë, barabrinjës, barakrahës dhe brinjëndryshëm; - vlerëson tiparet e trekëndëshave kënddrejtë, barabrinjës, barakrahës dhe brinjëndryshëm; - ngjyros figurat gjeometrike sipas llojit të kërkuar. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizore, fleta A4, lapsa, fletore pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe secili grup vendos lapsat **në mes të bankës.** Më pas, do të shkruajnë çfarë din**ë për trekëndëshin**, rreth 7-10 minuta.  Secili nxënës shkruan mendimet e tij rreth diagramit. Mësues/ja lëviz nga njëri grup te tjetri dhe zgjedh nga një laps te secili grup, ku nxënësi/ja do të lexojë **çfarë ka shkruar për trekëndëshin.** Më pas, nxënësit diskutojnë dhe japin mendime për grupin.			

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit do të lexojnë tekstin **më shokun/**shoqen e bankës rreth 4-5 minuta. Pasi kanë përvetësuar njohuritë rreth trekëndëshave, fillojmë me përshkrimin e tyre. Nxënësit ndahen në grupe dhe plotësojnë tabelën e përgatitur nga mësuesi/ja.

Trekëndëshi				
Trekëndëshi barabrinjës			Të gjitha brinjët i ka të barabarta, prandaj quhet barabrinjës. T**ë** gjitha këndet e trekëndëshit janë të barabarta.	
Trekëndëshi kënddrejtë				
Trekëndësh brinjëndryshëm				
Trekëndëshi barakrahës				

Pasi t'i kenë plotësuar tabelat, përfaqësuesit e secilit grup paraqesin punën e tyre, e cila plotësohet edhe në tabelë nga mësues/ja dhe diskutohet së bashku.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohurit**ë** rreth trekëndëshave, plotësojnë ushtrimin duke ngjyrosur sipas udhëzimit të dhën**ë në libër, ku do të bëhet klasifikimi i trekëndëshave** kënddrejtë, barabrinjës, barakrahës dhe brinjëndryshëm.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim, nxënësit vlerësohen për diskutimin në grup, punën individuale, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja punon disa objekte të shtëpisë nga plastelina dhe tregon cilës figurë gjeometrike i ngjason.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrike		**Rezultati i të nxënit të temës:** • jep shembuj praktikë lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4, 8); III (1, 2, 3 5); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Klasifikimi i katërkëndëshave			
Fjalët kyçe: Katërkëndësh, katër kënde, katër kulme, trapez, paralelogram, romb, drejtkëndësh, katror.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - tregon shembuj të llojeve të figurave gjeometrike: katror, drejtkëndësh, romb, paralelogram, trapez. - përshkruan karakteristikat e katrorit, drejtkëndëshit, rombit, paralelogramit, trapezit. - vlerëson tiparet e katrorit, drejtkëndëshit, rombit, paralelogramit, trapezit. - ngjyros figurat gjeometrike sipas llojit të kërkuar. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, fleta A4, lapsa, fletore pune.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe secili grup vendos lapsat **në mes të bankës. Nxënësit**, të ndarë **në grupe**, do të shkruajnë çfarë din**ë për trekëndëshin në kohën prej** 7-10 minuta.  Secili nxënës shkruan mendimet e tij rreth diagramit. Mësues/ja lëviz nga njëri grup te tjetri dhe zgjedh nga një laps te secili grup, ku nxënësi/ja do të lexojë çfarë ka shkruar për katërkëndëshat. Më pas, nxënësit diskutojnë dhe japin mendime për grupin.			

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit do të lexojnë tekstin **më shokun/**shoqen e bankës, 4-5 minuta. Pasi kanë përvetësuar njohuritë rreth katërkëndëshave, fillojmë me vizatimin e tyre. Nxënësit ndahen në grupe dhe plotësojnë tabelën e përgatitur nga mësues/ja.

Katërkëndëshi				
Trapezi		Të gjitha këto figura janë katërkëndësha, sepse kanë katër kënde dhe katër kulme. Katërkëndëshi, i cili ka vetëm një çift të brinjëve paralele, quhet **trapez**.		
Paralelogrami	Katërkëndëshi i cili i ka brinjët dy nga dy paralele, quhet **paralelogram**.			
Rombi			Paralelogrami, i cili i ka të gjitha brinjët e barabarta, quhet **romb**.	
Drejtkëndëshi				Katërkëndëshi, i cili ka katër kënde të drejta, quhet **drejtkëndësh**.

Pasi të jenë plotësuar tabelat, përfaqësuesit e secilit grup paraqesin punën e tyre, e cila plotësohet edhe në tabelë nga mësues/ja dhe diskutohet së bashku.

Faza e tretë:
Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë rreth katërkëndëshave, plotësojnë ushtrimin duke ngjyrosur sipas udhëzimit të dhënë **në libër, ku do të** bëhet klasifikimi i katërkëndëshave, barabrinjës, barakrahës dhe brinjëndryshëm.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim, nxënësit vlerësohen për diskutimin në grup, punën individuale, për dhënien e ideve, për pjesëmarrjen aktive.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit punojnë ndonjë objekt që u pëlqen dhe krijojnë figura gjeometrike: katrori, drejtkëndëshi, rombi, paralelogrami, trapezi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Vizaton trekëndëshin, drejtkëndëshin, katrorin dhe rrethin (duke përdorur trekëndëshin, vizoren apo kompasin)	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1, 8); III (3, 4, 5); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vizatimi i figurave gjeometrike			
Fjalët kyçe: segment, gjatësi, brinjë, hark, rreth.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Krahason gjatësinë e segmenteve. - Vizaton trekëndëshin, drejtkëndëshin, katrorin dhe rrethin (duke përdorur trekëndëshin, vizoren apo kompasin). **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, kompas, fije peri, fletore pune, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: M**ësuesi/ja** paraprakisht merr një **pe pak më të trashë dhe e pret në pjesë më të vogla, për numër të nxënësve**. I presim në mënyrë të tillë që dy nga dy të kenë të madhësi t**ë njëjtë, më qëllim që t**'i ndajmë nxënësit në **çifte. Pastaj** iu tregojmë se do të formojnë një çift me nxënësin/en **që ka perin më gjatësi të njëjtë me të tyrin**. Pasi formohet çifti, ata duhet të diskutojnë për figurat gjeometrike. Pas diskutimit kthehen në vendet e tyre. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librin për të lexuar tekstin **më shokun/**shoqen e bankës për 4-5 minuta. Pasi kanë përvetësuar njohuritë rreth vizatimit të trekëndëshit barakrahës, katrorit dhe drejtkëndëshit me vizore dhe rrethin me kompas. Mësues/ja në tabelë vizaton trekëndëshin barakrahës, me anë të vizores vizatojmë segmentet dhe me kompas vizatojmë rrethin. Vendosim gjilpërën e kompasit në njërin skaj të segmentit dhe kompasin e hapim në atë mënyrë që maja e lapsit të jetë më gjatësi së paku sa gjysma e segmentit të vizatuar. Pastaj tërheqim një hark si në figurë. Duke vendosur gjilpërën e kompasit në skajin tjetër, e tërheqim një hark me të njëjtën gjatësi të hapjes së kompasit si më parë. Bashkojmë pikat e skajshme të			

segmentit me pikëprerjen e gjetur. Trekëndëshi i vizatuar është trekëndësh barakrahës. Nxënësit vizatojnë trekëndëshin, katrorin dhe drejtkëndëshin duke përdorur vizoren.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë rreth figurave gjeometrike trekëndëshit, katrorit dhe drejtkëndëshit, në mënyrë individuale vizatojnë rrethin me kompas.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit do të vlerësohen për përcaktimin e veçorive të figurës gjeometrike dhe për vizatimin e tyre, pra për përdorimin e vizores, e kompasit në ndërtimin e figurave gjeometrike.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni figura gjeometrike me plastelinë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 7, 8); III (1, 4, 5, 6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Figurat simetrike			
Fjalët kyçe: figurë simetrike, drejtëza simetrike.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Krijon figura simetrike. - Gjen drejtëzën simetrike. - Punon figura gjeometrike, ku kanë një, dy ose më shumë drejtëza simetrike. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fleta A4, ngjyra tempera, fletore pune, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Faza e parë: Mësuesi/ja shpërndan fleta të bardha dhe ngjyra tempera në të gjitha grupet. Pastaj, fletën e bardhë e palosin vertikalisht. Më pas e hapin dhe në anën e majtë të fletës, vendosin ngjyra sipas dëshirës dhe bëjnë palosjen sipas drejtëzës së simetrisë. Pasi kanë bërë palosjen e hapin fletën ku nxënësit do të shohin që kanë krijuar figura në të dy anët e fletës, që përputhet plotësisht më të parën. - Mësuesja pyet nxënësit, a po ju pëlqejnë figurat të cilat u krijuan në të dy fletat? - A ngjasojnë figurat mes tyre në të njëjtën fletë? Diskutohet me nxënësit. Ata tregojnë vijën e palosjes ose drejtëzën simetrike në figurat e krijuar. Nxënësit dalin në përfundimin që çdo figurë e vizatuar në të majtë është e njëjtë me figurën në të djathtë, ato përputhen me njëra-tjetrën; kur paloset fleta, kanë po të njëjtën formë, pra figurat janë simetrike. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librin për të lexuar tekstin më shokun/shoqen e bankës për 4-5 minuta. Pasi kanë përvetësuar njohuritë rreth figurave simetrike dhe drejtëzës simetrike; nxënësit fillojnë punën në grupe dhe tregojnë se cilat nga figurat në shembullin e dhënë janë figura simetrike, si dhe vendosin drejtëzën simetrike. Pasi të kenë përcaktuar drejtëzat simetrike dhe numrin e drejtëzave simetrike në bashkëpunim më grupin, kontrollojnë vetën mandej bëhet diskutim kolektiv. **Faza e tretë:** Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë e tyre, secili nxënës në mënyrë individuale do të punojë dy figura, ku njëra figurë të ketë një drejtëz simetrike, ndërsa figurën e dytë të ketë dy ose më shumë drejtëza simetrike.
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Në përfundim të punës, nxënësit do të vlerësohen për përcaktimin e drejtëzave simetrike me një, më dy ose më shumë drejtëza simetrike, për aktivizimin dhënien e mendimeve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Vizaton rrethin dhe gjen drejtëza simetrike, pasi që të rrethi kemi pafundësi drejtëza simetrike.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7, 8); III (3, 4, 5, 6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vizatimi i figurave simetrike			
Fjalët kyçe: figurë simetrike, drejtëza simetrike, gjatësia, lartësia.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Krijon figura simetrike. - Vizaton figura simetrike. - Përcakton drejtëzën simetrike. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fleta me punime, ngjyra, fletore pune, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet **ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: M**ësuesi/ja** ju shpërndan fletat, në të cilat **është** vizatuar gjysma e një fluture, dhe ku **është** e vendosur drejtëza simetrike me vija të ndërprera. Pastaj, nxënësit do të ngjyrosin gjysmën e fluturës dhe do ta bëjnë palosjen e fletës përgjatë vijave, për ta bërë një flutur simetrike. - A ndodhën të dy krahët e fluturës në një vijë të drejtë? - Tregoni ku gjendet drejtëza simetrike. - A duhet të jetë largësia me drejtëzën simetrike njësoj në të krahët? Pasi të përfundojnë punimet, nxënësit do t'i ekspozojnë në klasë dhe do të diskutojnë për drejtëzën e simetrisë në figurën e krijuar. **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librin për të lexuar tekstin më shokun/shoqen e bankës për 4-5 minuta. Pasi kanë përvetësuar njohuritë rreth figurave simetrike dhe drejtëzës simetrike, nxënësit fillojnë punën në grupe. Në ushtrimin vijues, ata vizatojnë pjesën tjetër **të figurës** për ta bërë figur**ën** simetrike. - Si duhet të veprojmë që figura të jetë simetrike? Largësia duhet të jetë e njëjtë nga të dyja anët e drejtëzës simetrike. Matjet i bëjmë me vizore ose me kompas.			

Në shembullin e radhës, vizatojmë shenjat **në** figurën e dhënë për të krijuar simetri.

- A ndodhën të dy shenjat në largësi të njëjtë me drejtëzën simetrike?
- Tregoni ku gjendet drejtëza simetrike.

Pasi të kenë përcaktuar drejtëzat simetrike në grup, kontrollojnë veten, pastaj bëhet diskutim kolektiv.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë e tyre, nxënësit të ndarë në dyshe krijojnë figurën simetrike duke shtuar katrorë dhe trekëndësha. Në përfundim të detyrës, nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit do të vlerësohen për krijimin, vizatimin e figurave simetrike, si dhe për vendosjen e drejtëzave simetrike, për aktivizimin dhënien e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Krijon dy figura simetrike me anë të plastelinës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Jep shembuj praktik lidhur me përdorimin e figurave gjeometrike në jetën e përditshme	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1, 4); III (1, 5, 6); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përdorimi i figurave gjeometrike në jetën e përditshme			
Fjalët kyçe: figurë gjeometrike, katror, trekëndësh, drejtkëndësh.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Gjen sa më shumë figura gjeometrike nga objektet e ndryshme. - Ndërton objekte të ndryshme, të cilat ngjasojnë me figurat gjeometrike. - Përdor figura gjeometrike në jetën e përditshme. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fleta me punime, ngjyra, fletore pune, libri, fleta të bardha.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet **ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore.
Lidhja me temat ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Faza e parë:
M**ësuesi/ja** i shpërndan nga një fletë të bardhë secilit nxënës, pastaj kërkohet nga nxënësit që të ulen në vendet e tyre dhe në letrat që kanë marr**ë** të vizatojnë figura gjeometrike.
Pasi të kenë përfunduar të gjithë, ndahen në grupe dhe mundohen të gjejnë figura gjeometrike në vizatimet e tyre. Mësuesi/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit nëpër grupe, si dhe diskutojnë për figurat gjeometrike të cilat mund t'i gjeni.

- Sa figura keni gjetur brenda grupit?
- Me cilën figurë ju ngjasojnë?
- A dini ndonjë objekt që ka figurë gjeometrike brenda klasës?

Nxënësit diskutojnë për figurat, të cilat i krijuan nga punimet e tyre, si dhe nga jeta e përditshme.
Faza e dytë:
Nxënësit hapin librin për të lexuar tekstin në mënyrë individuale për 10 minuta. Pasi kanë lexuar shembujt dhe kanë parë figurat e krijuara nga objektet e ndryshme, diskutohet rreth këtyre objekteve.

- A keni hasur ju ndonjë objekt që ka figurë gjeometrike në jetën e përditshme?
- Fillojmë identifikojmë objekte brenda klasës.
- Po në rrugë keni parë ndonjë objekt në forma gjeometrike?

Nxënësit përgjigjen dhe diskutojnë për objektet, që na rrethojnë e mund të identifikohen si figura gjeometrike.
Nxënësit hapin fletoret dhe vizatojnë objekte të ngjashme me figurat gjeometrike, të cilat gjendet në shtëpi, në pikturë dhe në tekstilin dekorativ. I komentojmë bashkërisht me të gjithë nxënësit.

- Sa figura gjeometrike keni gjetur?
- Tregoni ku gjendet ato figura gjeometrike?

N**ë** grup kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit.
Faza e tretë:
M**ësues**i/ja ka krijuar në flet**ë** një figurë gjeometrike, ku nxënësit
të ndarë në dyshe duhet të gjejnë sa trekëndësha ndodhën në këtë figurë.



Pra, nxënësit duhet të gjejnë se në këtë figurë ndodhen 12 trekëndësha. Në përfundim të detyrës, nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit do të vlerësohen për krijimin, vizatimin e figurave simetrike dhe për gjetjen e figurave tek trekëndëshi, për aktivizimin dhënien e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përdor figura gjeometrike nga jeta e përditshme dhe ndërto ato me plastelinë.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Figurat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Njehson perimetrin e figurave gjeometrike (trekëndëshit , katërkëndëshit, katrorit). • Zbulon formula të thjeshta për gjetjen më të lehtë të perimetrit të figurave.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4, 7); III (1, 5, 6); V (8); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: 13.14 Perimetri i figurave gjeometrike			
Fjalët kyçe: figurë gjeometrike, perimetër, njësim, ndërtim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Përshkruan çfarë di për perimetrin. - Njëson perimetrin e figurave gjeometrike. - Ndërton perimetrin e figurave të rregullta. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa, fletore pune, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:
Mësuesi/ja merr mendime nga nxënësit për perimetrin, për të cilin kanë njohuri paraprake. Mësuesi/ja shënon në tabelë fjalën perimetër, ku nxënësit thonë se çfarë dinë rreth këtij koncepti. Idetë e nxënësve i diskutojmë bashkërisht dhe i shënojmë në tabelë.



Mësues/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit në klasë, si dhe diskuton me ta për perimetrin.

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librin për të lexuar udhëzimet në tekst për 10 minuta. Pasi kanë lexuar tekstin, fillon nj**ë diskutim rreth perimetrit**.

- **Ç'është** perimetri i një trekëndëshi, katrori, pesëkëndëshi?

Jepen figurat, ku nxënësit në grupe përcaktojnë perimetrin e tri figurave të mësipërme.

- Si janë brinjët e trekëndëshit, katrorit, pesëkëndëshit?
- A mund të gjejmë perimetrin e ndonjë figure tjetër?

Shembulli:
T**ë gjemë perimetrin e figurave.**

- A janë të gjitha brinjët e barabarta?
- Si duhet të veprojmë për të gjetur perimetrin e figurave?
- Si mund të njësojmë perimetrin e figurave?

Nxënësit përgjigjen dhe diskutojnë për perimetrin dhe njësimin e brinjëve duke i mbledhur.
P=3+40+45+15+50+10+40+45+8+50
Nxënësit plotësojnë librin duke u konsultuar në grup. Kërkohet diskutim në klasë më përgjigjet e nxënësve dhe korrigjohen gabimet e bëra prej tyre.
Faza e tretë:
Ndahet klasa në tri grupe ku do të ndërtojnë:
Grupi 1. Ndërto një drejtkëndësh me brinjët 7 cm dhe 5 cm.
Grupi 2. Ndërto një trekëndësh me brinjë 5 cm, 7 cm dhe 9 cm.
Grupi 3. Ndërto një katror me brinjë 8 cm.
Jepen 7-10 minuta që nxënësit **të** përfundojnë punën e pavarur dhe pastaj bashkohen me shokun e bankës, duke bashkëpunuar dhe kontrolluar figurat e dhëna. Nxënësit shkëmbejnë mendimet për gjetjen e perimetrit të figurave gjeometrike dhe gjetjes së brinjëve.

Pra, nxënësit duhet të gjejnë në këto figura perimetrin. Në përfundim të detyrës nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit do të vlerësohen për gjetjen e perimetrit, për aktivizimin dhënien e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ndërton figura gjeometrike dhe gjen perimetrin. Figurat të krijohen nga letër më e trash apo kartoni.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Sipërfaqja		**Rezultati i të nxënit të temës:** • gjen syprinën e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4, 8); III (1, 2, 3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Syprina e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit			
Fjalët kyçe: figurë gjeometrike, perimetër, njësim, ndërtim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - gjen sipërfaqen e katrorit dhe drejtkëndëshit. - njehson njësitë përkatëse kur është dhënë masa e sipërfaqes dhe brinja tjetër.			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa, fletore pune, gërshërët, letra me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë

Mësuesi/ja paraprakisht ka përgatitur një katror dhe një drejtkëndësh, të cilët i paraqet para nxënësve, ku nxënësit do të gjejnë masën e sipërfaqes **së tyre.**
Ata do të punojë në grupe, ku mësuesja fillimisht iu shpërndan fleta me ngjyra, ku secili grup do të formoj**ë** katror**ë** me 2 centimetra, pasi të formojnë katrorët me 2 cm, do t'i presin. Secili grup do të formoj**ë** dhe do të pres**ë** nga 20 katror**ë**.
Mësues/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit në klasë, si dhe diskutojnë për prerjen e katrorëve.

Faza e dytë

Nxënësit hapin librin për të lexuar në grupe udhëzimet në tekst për 10 minuta. Pasi kanë lexuar tekstin, fillohet një diskutim rreth figurës së dhënë në libër, se sa katrorë i nevojiten Blertës për të mbuluar sipërfaqen e pikturës.

- Si quhet zona e pikturës së mbuluar me katrorë?

Nxënësit diskutojnë në grupe dhe mësuesi/ja vëzhgon punën e tyre vazhdimisht.
Kështu vazhdohet me ushtrimet e tjera, ku nxënësit po me ata katrorë që krijuan vazhdojnë dhe me figurat (shkronjat) e mëposhtme.

Nxënësit shënojnë sa katrorë ju nevojiten për të mbuluar sipërfaqen e figurave të mëposhtme. Ata përgjigjen dhe diskutojnë për sipërfaqen e figurave.
Nxënësit plotësojnë librin duke bashkëpunuar me grupin. Kërkohet diskutim në klasë më përgjigjet e nxënësve dhe korrigjohen gabimet e bëra prej tyre.

Faza e tretë

Nxënësit ashtu siç janë të ndarë në grupe, fillojnë e vizatojnë në drejtkëndësh me brinjët:

Drejtkëndëshi



Katrori



Nxënësit marrin letrat e krijuara **më** herët dhe me anë të tyre do të bëjnë matjen e sipërfaqes **së katrorit dhe** drejtkëndëshit. Nxënësit shkëmbejnë mendimet për gjetjen e sipërfaqes **së figurave.** Në përfundim të detyrës, nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit do të vlerësohen për gjetjen e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit, për aktivizimin dhënien e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësi/ja ndërton figura gjeometrike nga plastelina dhe gjen sipërfaqen me anë të katrorëve prej 2 cm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Sipërfaqja		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Gjen syprinën e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (4); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Matja e sipërfaqes me numrin **të katrorëve**			
Fjalët kyçe: masa e sipërfaqes, katrori, lartësia, baza.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Njëson syprinën e sipërfaqes me njësi matëse katrorin. - Arsyeton rezultatet e fituara gjatë matjes. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa, fletore pune, kubëza.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: **Mësuesi/ja** kërkon nga nxënësit **që të bëjnë matjen e një pjese të** sipërfaqes **së klasës me kubëza në formë katrori. Nxënësit ndahen në grupe për të gjetur objekte** brenda klasës. Gjatë matjes, nxënësit duhet të mbajnë shënime. Grupi, i cili bën matjen, prezanton **të dhënat** para klasës. Jepet objekti në formë katrori dhe nxënësit do të gjejnë sipërfaqen e tij. 3 cm 3 cm - A mundeni të zbuloni një formulë të përgjithshme për njësimin e masës së sipërfaqes? Mësuesi/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit në klasë, si dhe diskutojnë për matjen e sipërfaqes.			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librin për të lexuar udhëzimet në tekst **në grupe.** Në tekst janë dhënë disa shembuj të matjes së sipërfaqes.
Sipas shembujve në libër, nxënësit duhet të caktojnë sipërfaqen e figurës me njësi matëse katrorin.
Ku mundemi të njësojmë në dy mënyra:
Mënyra e parë: 3 + 3 = 6
Mënyra e dytë 2 · 3 = 6.
Kështu vazhdohet me shembujt e tjerë në tekstin mësimor.
Nxënësit plotësojnë librin duke bashkëpunuar me grupin. Diskutohen në klasë përgjigjet e nxënësve dhe korrigjohen gabimet e bëra prej tyre.
Faza e tretë:
Nxënësit ndahen në dyshe, udhëzohen të punojnë në libër, ku do të rrethojnë figurat të cilat kanë nga 7 katror**ë**.
Nxën**ësit** përfundojnë punën në dyshe, duke bashkëpunuar dhe kontrolluar gjetjen e sipërfaqes **së figurave të** dhëna. Nxënësit shkëmbejn**ë** mendimet për gjetjen e sipërfaqes **së figurave**.
Në përfundim të detyrës, nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunimin për gjetjen e sipërfaqes. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë aktivitetit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bën matjen e sipërfaqes së ndonjë objekti në dhomën tuaj me njësi matëse katrorin..

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Sipërfaqja		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Gjen syprinën e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (4); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Matja e syprinës së sipërfaqes duke shfrytëzuar katrorët dhe trekëndëshat			
Fjalët kyçe: masa e sipërfaqes, katrori, drejtkëndëshi, trekëndësh, lartësia, baza.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Njëson syprinën e sipërfaqes me njësi matëse katrorin. - Vizaton katrorin dhe drejtkëndëshin dhe gjen sipërfaqen e tyre. - Vlerëson rezultatet e fituara gjatë matjes. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa, fletore pune, kubëza.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:

Mësuesi/ja paraqet para klasës një katror dhe një drejtkëndësh. Nxënësit të ndarë në grupe do të gjejnë sipërfaqen e këtyre dy figurave gjeometrike.

Jepet objekti në formë katrori dhe në formë drejtkëndëshi; nxënësit do të gjejnë sipërfaqen e tyre.

- Si mund të gjejmë syprinën e sipërfaqes duke numëruar?

Nxënësit e dinë që një katror ka 1 njësi. Figura ka 8 katrorë dhe 4 trekëndësha, dhe ne duhet të dimë që dy trekëndësha kanë syprinë sa një katror.

Mësues/ja vëzhgon dhe ndihmon nxënësit në klasë, si dhe diskuton me ta për matjen e sipërfaqes.

Faza e dytë:

Nxënësit hapin librin dhe do të lexojnë udhëzimet në tekst në grupe, ku janë dhënë disa shembuj të matjes së sipërfaqes.

Sipas shembujve në libër, nxënësit duhet të caktojnë sipërfaqen e figurës me njësi matëse katrorin.

Nxënësit vazhdojnë të numërojnë katrorët për të gjetur syprinën e figurave të dhëna.

Nxënësit plotësojnë librin duke bashkëpunuar në grup. Diskutohet në klasë për përgjigjet e nxënësve dhe korrigjohen gabimet e bëra prej tyre.

Faza e tretë:

Nxënësit hapin fletoren dhe ju kërkohet të vizatojnë një katror me brinjë 4 cm, si dhe një drejtkëndësh me brinjë 5 cm e 2 cm. Më pas, ata gjejnë sipërfaqen e tyre.
Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, pastaj shkëmbejnë fletoret më njëri-tjetrin dhe kontrollojnë punën e bërë.



S = 16 cm

S = 10 cm

Pra, nxënësit duhet të gjejnë në këto figura syprinën e sipërfaqes. Në përfundim të detyrës, nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit vlerësohen për mendimet e sakta rreth përcaktimit të sipërfaqeve të objekteve, njësimin e syprinave të figurave, gjithashtu edhe për punën aktive dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni me plastelinë ndonjë figurë dhe gjej syprinën e sipërfaqes së figurës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Sipërfaqja		**Rezultati i të nxënit të temës:** • Gjen syprinën e sipërfaqes së katrorit dhe drejtkëndëshit	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (4); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Matja e syprinës dhe perimetrit			
Fjalët kyçe: syprina, perimetri, vija.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Ndërton figura gjeometrike. - Vizaton katrorin, drejtkëndëshin dhe gjen sipërfaqen e tyre. - Vlerëson rezultatet e fituara gjatë matjes. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** vizore, lapsa, fletore pune, kubëza.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqip, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë muzikore. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Çfarë është perimetri i një figure gjeometrike (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi)?
- Çfarë është syprina?

Mësuesi/ja paraqet në tabelë dy figura për të gjetur syprinën dhe perimetrin e figurave.

Si mund të gjejmë perimetrin e këtyre figurave?

- Si mund të gjejmë syprinën e këtyre figurave?

Nxënësit japin ide dhe mendimet e tyre për gjetjen e perimetrit dhe syprinës, ku vrojtojnë dhe diskutojnë e gjithë klasa.

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit do të lexojnë udhëzimet në tekst në dyshe, ku janë dhënë disa shembuj të matjes së sipërfaqes dhe matjen e perimetrit.
Nxënësit sipas shembujve në libër duhet të caktojnë sipërfaqen dhe perimetrin e figurës si njësi matëse katrorin.
Nxënësit ndahen në 6 grupe dhe secilit grup ju jepet nga një detyrë për të gjetur syprinën dhe perimetrin e figurave gjeometrike.
Perimetri i katrorit ABCD = 4 cm + 4 cm + 4 cm + 4 cm = 16 cm
Syprina e katrorit ABCD = 4 cm · 4 cm = 16 cm^2
Perimetri i drejtkëndëshit ABCD = 7 cm+ 2 cm+ 7 cm + 2 cm = 18 cm
Syprina e drejtkëndëshit ABCD = 7 cm · 2 cm = 14 cm^2
Nxënësit plotësojnë librin duke bashkëpunuar me grupin. Kërkohet diskutim në klasë më përgjigjet e nxënësve dhe korrigjohen gabimet e bëra prej tyre.
Faza e tretë:
Nxënësit hapin fletoren dhe vizatojnë një katror me brinjë 3 cm dhe një drejtkëndësh me brinjë 3 cm e 2 cm.
Nxënësit ndërtojnë figurat **në** fletore për të gjetur syprinën dhe perimetrin e tyre. Në përfundim të detyrës, nxënësit kontrollohen për punën e bërë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të punës, nxënësit vlerësohen për mendimet e sakta rreth përcaktimit të sipërfaqeve të objekteve, njësimin e syprinave të figurave, gjithashtu edhe për punën aktive dhe bashkëpunimin me njëri-tjetrin.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punoni me plastelinë ndonjë figurë dhe gjej syprinën e sipërfaqes së figurës.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (2, 7); III (2, 3); V (8); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Emërtimi i trupave gjeometrikë			
Fjalët kyçe: koni, kuboidi, sfera, cilindri, piramida.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Analizon ngjashmëritë dhe dallimet mes trupat gjeometrik. - Identifikon sendet përreth të ngjashëm me trupat gjeometrikë. - Plotëson fletën e punës sipas kërkesave. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës “Matematika 3”. **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** topi, pako e qumështit, libri, fletore, banka, dollapi i klasës.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqip, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve në grupe gjësende me forma të trupave gjeometrikë **që do të mësojnë, ku secili grup do** të analizojë gjësendin që ka përpara. (shembull, topi ka formën e sferës, pakoja e qumështit si kubi, etj.). Nxënësit vëzhgojnë dhe analizojnë trupat e sjellë nga mësuesja mbi bankat e tyre, pastaj mësuesja pyet: - Çfarë shikoni mbi banka? - Me çfarë ju ngjasojnë këtë gjësende? Nxënësit hapin librin dhe emërtojmë së bashku trupat e dhënë në detyrën 1. **Faza e dytë:** Mësuesi/ja parashtron pyetjen: - Cilat figura mund t’i gjejmë brenda klasës, në shtëpi apo në natyrë që janë të ngjashme me trupat gjeometrikë? - Mësuesja shkruan në tabelë, ku nxënësit emërtojnë trupat dhe i grupojnë në dy grupe.			

Objekti	Trupi gjeometrik
Topi i futbollit	Sfera
Pako e qumështit	Kuboidi

- Cili/a nga ju mund të gjejë më shumë figura? Nxënësit plotësojnë ushtrimin numër 2.

Faza e tretë: Nxënësit identifikojnë në mënyrë individuale trupat gjeometrikë në figurën e dhënë tek ushtrimi numër 3. Më pas kërkohet nga nxënësit të përcaktojnë ku është ngjashmëria e të dy llojeve të trupave (kuboidit dhe cilindrit).

- Ku është dallimi midis tyre?

Trupat	Numri i bazës	Numri i faqeve	Numri i brinjëve
Kuboidi	0	6	12
Cilindri	2	0	0

Më pas kërkohet nga nxënësit të vizatojnë me vizore kuboidin dhe cilindrin.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen në njohuritë që japin gjatë identifikimit dhe emërtimit të saktë të trupave gjeometrike, si dhe vlerësohen edhe për ilustrimin e trupave gjeometrikë në fletore në bazë të saktësisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Krijoni nga një figurë gjeometrike nga letra ose plastelina.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Përcakton faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë; ▪ Identifikon objekte natyrore të ngjashme me kubin; kuboidin, sferën, cilindrin , konin , piramidën; ▪ Bën dallimin ndërmjet figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1, 7); III (2, 6); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë			
Fjalët kyçe: gjatësi, lartësi, faqe, brinjë, kulm.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Dallon cilësitë e trupave gjeometrikë; - Identifikon përmasat e trupave gjeometrikë; - Argumenton figurat gjeometrike dhe trupat gjeometrikë; **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** figura gjeometrike, vizore, vija, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja merr disa figura gjeometrike, si dhe disa trupa gjeometrikë dhe i paraqet para nxënësve; nxënësit i shikojnë dhe i analizojnë. Mësuesja shënon në tabelë: dallimet dhe të përbashkëtat e trupave gjeometrikë, si dhe të figurave gjeometrike. Nxënësit dallojnë cilësitë e tyre duke i komentuar në grup.			



Mësuesja merr një libër para nxënësve dhe identifikon **së bashku me nxënësit** lartësinë e librit, gjatësinë dhe gjerësinë e librit. Ajo iu demonstron nxënësve kulmet, brinjët dhe faqet.
Nxënësit hapin librin, ku emërtojnë së bashku dhe krahasojnë figurat e dhëna në detyrë.
Si quhet vendi ku takohen brinjët?
Çfarë formohet kur takohen dy faqe?
Çfarë është brinja?
Nxënësit plotësojnë detyrën.

Faza e dytë:

Mësuesi/ja ka në duar dy trupa gjeometrikë duke bërë krahasimin e tyre me anë të pyetjeve:

- Sa faqe ka secili trup gjeometrikë?
- Kush nga ju mund të gjejë më shumë figura? Nxënësit plotësojnë ushtrimin numër 2.

Faza e tretë: Në mënyrë individuale, nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë cilësitë e trupave gjeometrikë. Më pas, kërkohet nga nxënësit të punojnë në fletoren e punës në njësinë përkatëse.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin gjatë aktiviteteve. Nxënësit vlerësohen për punën në grup dhe për punët individuale, si dhe për diskutimin gjatë orës; në njohuritë që japin gjatë identifikimit dhe emërtimit të saktë të figurave gjeometrike, si dhe vlerësohen edhe në ilustrimin e figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë dhe në fletore në bazë të saktësisë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Bëjnë matjen e ndonjë objekti në shtëpi, me njësinë standarde – centimetrin, duke përcaktuar gjatësinë, lartësinë, gjerësinë, faqet, kulmin dhe e paraqesin në fletoren e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Gjen vëllimin e trupave të rregullt (*kubi dhe kuboidi*) dhe të parregullt gjeometrikë duke përdorur formula të thjeshta apo enë të ndryshme;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II (1,2, 7, 8); III (1, 2, 3, 4, 6); V (8); VI (2).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.2; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 4.3; 6.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjetja e vëllimit të trupave gjeometrikë			
Fjalët kyçe: vëllim i kubit, vëllimi i kuboidit.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Identifikon objektet në natyrë që kanë vëllim. - Gjej vëllimin e trupave me anë të njësive. - Krahason vëllimin e trupave. **Kriteret e suksesit:**			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kube të vogla, shishe, gota.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e pare: Mësuesi/ja para klasës paraqet një gotë, një shishe, një kub dhe pasta pyes nxënësit: - Si të matim hapësirën e këtyre objekteve? Nga nxënësit marrim mendime të ndryshme. - Shishen e matim me gota, sa gota uji i nxë shishja. - Gotën e matim me kube të vogla, sa kube i nxë gota. Pra, siç e shikoni, **të gjitha këto objekte kanë brenda një** hapësirë **të zbrazët që mund ta** quajmë **vëllim. Vëllimi matet me njësi kubike.** **Faza e dytë:** Nxënësit hapin librin, lexojnë në dyshe tekstin dhe analizojnë detyrat 1, 2. Madje fillojmë me pyetjet: - Çfarë mësuat nga leximi i tekstit? - Më çfarë matet vëllimi i trupave gjeometrikë? - Më çfarë janë të mbushura trupat gjeometrikë?			

Për të gjetur vëllimin e trupave gjeometrikë, fillojmë e numërojmë kubet e vogla. Nxënësit në mënyrë individuale koncentrohen tek ushtrimet 3, 4 dhe gjejnë vëllimin e trupave gjeometrikë, theksojmë se kubet janë në përmasa standarde. Plotësojnë katrorët e zbrazët.

Vëllimi 3 rreshta me nga 3 kube = 9 kube

Vëllimi 3 shtresa me nga 3 kube = 27 kube

Faza e tretë: Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si e gjetët vëllimin e secilit trup gjeometrik?

Nxënësit analizojnë në dyshe detyrat e tyre dhe tregojnë që duke numëruar kutitë e vogla kanë gjetur vëllimin e trupave gjeometrikë.

Nxënësit do të gjejnë vëllimin e trupave duke shumëzuar gjatësinë e gjerësinë, lartësinë ose a·b·c.

I japim zgjidhje detyrës:

Vëllimi = 3 cm · 3 cm · 5 cm

Vëllimi = 45 cm^3

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për sjelljen e shembujve nga jeta e përditshme dhe për njehsimin e vëllimit të trupave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Punohet në fletoren e punës në njësinë përkatëse.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Gjen vëllimin e trupave të rregullt (*kubi dhe kuboidi*) dhe të parregullt gjeometrikë duke përdorur formula të thjeshta apo enë të ndryshme;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (1, 7); III (1, 4); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.2; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 4.3; 6.1.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vëllimi i kubit dhe kuboidit duke përdorur formula të thjeshta			
Fjalët kyçe: vëllim i kubit, vëllimi i kuboidit.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - Identifikon objektet në natyrë që kanë vëllim. - Gjen vëllimin e trupave me anë të njësive. - Krahason vëllimin e trupave. **Kriteret e suksesit**:			
Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kube të vogla, shishe, gota.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja paraqet para klasës një kuboid me përmasa të tilla: - Gjatësia e kuboidit është e barabartë me 4 njësi kub. - Gjerësia e kuboidit është e barabartë me 5 njësi kub. - Lartësia e kuboidit është e barabartë me 7 njësi kub. Mësuesi/ja pyet nxënësit se si e gjejmë vëllimin e kuboidit? - Si të matim hapësirën e këtij kuboidit? Nga nxënësit marrim mendime të ndryshme. - Me kube të vogla. - Matet me njësi standarde. Pra, siç e shikoni, të gjitha këto objekte kanë brenda një hapësirë të zbrazët, që mund ta quajmë vëllim. Vëllimi matet me njësi kubike. V = gjatësi · gjerësia lartësia = 4 · 5 · 7 = 140			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librin për të lexuar tekstin në dyshe dhe analizojnë shembujt. Pastaj, shtrohen pyetjet:

- Çfarë mësuat nga leximi i tekstit?
- Më çfarë matet vëllimi i trupave gjeometrikë?
- Më çfarë janë të mbushura trupat gjeometrikë?

Nxënësit koncentrohen në mënyrë individuale tek ushtrimet 3, 4 dhe gjejnë vëllimin e trupave gjeometrikë, theksohet se kubet janë në përmasa standarde. Plotësojnë katrorët e zbrazët.

Si e gjejmë vëllimin e kubit me lartësi 5 njësi?

$5 \cdot 5 \cdot 5 = 125$

Si e gjejmë vëllimin e kuboidit me 7 kube njësi, 2 kube njësi dhe 4 kube njësi?

$7 \cdot 2 \cdot 4 = 54$

Kështu veprohet edhe me shembujt e tjerë, ku nxënësit të ndarë në dyshe gjejnë vëllimin e trupave gjeometrikë.

Faza e tretë: Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Si e gjetët vëllimin e secilit trup gjeometrik?

Nxënësit të ndarë në dyshe analizojnë detyrat e tyre dhe tregojnë që vëllimi matet me njësi standarde cm^3.
Nxënësit do të gjejnë vëllimin e trupave duke shumëzuar gjatësinë e gjerësinë, lartësinë ose a·b·c.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për gjetjen e vëllimit. Diskutimin e situatave problemore nga jeta e përditshme, diskutimet në çifte, në grup.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ndërto kubin, kuboidin nga letra e trashë ose plastelina.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Trupat gjeometrikë		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ Bën dallimin ndërmjet figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I (3); II (7); III (1, 4); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4; 2.1; 2.2; 2.4; 3.4; 3.6; 4.2; 4.3; 6.1.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Figurat gjeometrike dhe trupat gjeometrikë

Fjalët kyçe: figura gjeometrike, trupa gjeometrik, shumëfaqësha.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- Dallon vetitë e figurave gjeometrike me trupat gjeometrikë.
- Identifikon emrat e figurave gjeometrike me ato të trupave gjeometrikë.
- Krahason të përbashkëtat dhe dallimet e figurave dhe trupave gjeometrikë.

Kriteret e suksesit:

Burimet: libri dhe fletorja e punës "Matematika 3".
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: kube të vogla, shishe, gota.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqip, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.
Lidhja me temat ndërkurrikulare: Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Faza e parë:
Mësuesi/ja paraqet **në** tabelë diagramin, ku nxënësit do të paraqesin **të përbashkëtat**, si dhe dallimet e figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrik**ë**. Punohet në grupe, ku nxënësit do të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë secili.



Mësues/ja pyet nxënësit cilat janë të përbashkëtat, dallimet e figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë? Nga nxënësit marrim mendime të ndryshëm dhe plotësojmë diagramin.
Pra, siç e shikoni të gjitha këto janë dallimet dhe të përbashkëtat e figurave dhe trupave gjeometrikë.

Faza e dytë:

Nxënësit hapin librin, lexojnë në dyshe tekstin dhe analizojnë shembujt. Pastaj, fillojmë me plotësimin e shembujve, shkruajnë nëse është figurë gjeometrike apo trup gjeometrik.

Faza e tretë:

Pasi nxënësit kanë përvetësuar njohuritë e tyre rreth figurave dhe trupave gjeometrikë ndahen në grupe dhe plotësojnë tabelën e përgatitur nga mësuesja.

Figurat dhe trupat gjeometrikë	Ka 4 brinjë	Ka 3 brinjë	Ka 6 faqe	Ka 12 brinjë	Nuk ka asnjë brinjë	Ka 3 kulme	Ka 8 kulme
Trekëndëshi		√				√	
Kubi			√	√			√
Kuboidi			√	√			√
Katrori	√						

Pas përfundimit, nxënësit analizojnë së bashku detyrat e tyre dhe tregojnë për vetitë e figurave dhe trupave gjeometrikë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për gjetjen e dallimeve dhe të përbashkëtat e figurave, si dhe trupave gjeometrikë. Diskutimin e situatave problemore nga jeta e përditshme, diskutimet në çifte, në grup.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ndërto drejtkëndëshin, konin dhe piramidën nga letra e trashë ose plastelina.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Ekuacionet lineare me një të panjohur		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ paraqet zgjidhjen e problemave përmes skemave të ndryshme; ▪ gjen zgjidhjen e barazimeve të dhëna.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4); III (6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: **2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjetja e së panjohurës në lidhje me shumëzimin			
Fjalë kyçe: gjetja e të panjohurës në lidhje me shumëzimin, e panjohura.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kontrollon me saktësi gjetjen e së panjohurës, duke pjesëtuar prodhimin me njërin nga faktorët. - Gjen të panjohurën për të zëvendësuar.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: gjuhë shqip, shkathtësi për jetë, edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:

Mësuesi/ja vendos **në tabelë** 100 · ___ = 300, ku kërkon të gjejnë numrin e panjohur.

Së bashku me nxënësit bëjmë një analizë rreth detyrës.



Si ta kontrollojmë saktësinë e zgjidhjes?

Marrim disa mendime nga nxënësit.

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë **për** gjetjen e së panjohurës lidhur me shumëzimin.

- Si duhet të veprohet?
- Kur nuk dihet njëri nga faktorët?

Kur nuk dihet njëri nga faktorët, gjendet duke pjesëtuar prodhimin me faktorin e njohur.
Gjejmë herësin 300:100 = 3, vlera e fituar (pra numri 3) është shumëzuesi i panjohur. E vendosim numrin 3 në pozitën e faktorit të panjohur dhe e njësojmë prodhimin. 100·3 = 300.
Nxënësit veprojnë njësoj edhe me rastet t**ë tjer**a tek ushtrimet e radhës 1, 2. Pastaj diskutojnë me tër**ë klasën për gjetjen e** s**ë panjohurës në lidhje me** shumëzimin.

Faza e tretë:
Nxënësit në dyshe gjejnë të panjohurën dhe kontrollojnë rezultatin.

___ · 225 = 900 4 · 225 = 900
____ = 900 : 225 900 = 900
_____ = 4

Nxënësit diskutojnë dhe tregojnë se si e kanë gjetur të panjohur**ën në lidhje me shumëzimin**. Nxënësit lihen të provojnë aftësitë logjike në zgjidhjen e problemeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të orës mësimore, vlerësohen nxënësit për qëndrimin aktiv dhe dhënien e mendimeve në zgjidhjen e ekuacioneve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Ekuacionet lineare me një të panjohur		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ paraqet zgjidhjen e problemave përmes skemave të ndryshme; ▪ gjen zgjidhjen e barazimeve të dhëna.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4); III (6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: **2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjetja e së panjohurës në lidhje me shumëzimin			
Fjalë kyçe: Gjetja e të panjohurës në lidhje me pjesëtimin, e panjohura.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kontrollon me saktësi gjetjen e të panjohurës, duke pjesëtuar prodhimin me njërin nga faktorët. - Gjen të panjohurën për të zëvendësuar.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: gjuhë shqip, shkathtësi për jetë, edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja vendos **në tabelë** 100 · ___ = 300, ku kërkon të gjejnë numrin e panjohur. Së bashku me nxënësit bëjm**ë** një analizë rreth detyrës.  Si ta kontrollojmë saktësin**ë** e zgjidhjes? Marrim disa mendime nga nxënësit.			

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë **për të** gjetjen e së panjohurës lidhur me pjesëtimin.

- Si duhet të veprohet?
- Kur nuk dihet, i pjesëtueshmi apo pjesëtuesi?

Kur nuk dihet pjesëtuesi, gjendet duke pjesëtuar.
Gjejmë herësin 800:80 = 10, vlera e fituar (pra numri 10) është pjesëtuesi i panjohur. E vendosim numrin 10 në pozitën e pjesëtuesit **të panjohur dhe e** pjesëtojmë 800:10 = 80.
Nxënësit veprojnë njësoj edhe me rastet **të tjer**a tek ushtrimet e radhës 1. Pastaj diskutojnë me tër**ë klasën për gjetjen e të panjohurës në lidhje me** shumëzimin.

Faza e tretë:
Pra, nxënësit në dyshe gjejnë të panjohurën dhe kontrollojnë rezultatin.

783 : ___ = 87	783 : 9 = 87
____ = 783 : 87	87 = 87
_____ = 9	

Nxënësit diskutojnë dhe tregojnë se si e kanë gjetur të panjohur**ën në lidhje me shumëzimin**. Nxënësit lihen të provojnë aftësitë logjike në zgjidhjen e problemeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të orës mësimore, vlerësohen nxënësit për qëndrimin aktiv dhe dhënien e mendimeve në zgjidhjen e ekuacioneve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Ekuacionet lineare me një të panjohur		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ paraqet zgjidhjen e problemave përmes skemave të ndryshme; ▪ gjen zgjidhjen e barazimeve të dhëna.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1, 4); III (6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: **2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.**			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Problema me fjalë në lidhje me shumëzimin dhe pjesëtimin			
Fjalë kyçe: gjetja e së panjohurës në lidhje me pjesëtimin, shumëzimin, e panjohura.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - Kontrollon me saktësi gjetjen e së panjohurës, duke pjesëtuar prodhimin me njërin nga faktorët. - Gjen zgjidhje të barazimeve të dhëna.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: gjuhë shqip, shkathtësi për jetë, edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja vendos **në tabelë** detyrën me problema ___ : 5 – 4 = 9, ku kërkon të gjejnë numrin e panjohur. Së bashku me nxënësit bëjmë një analizë rreth detyrës. Vesa e pyeti gjyshin sa vjeç është. Gjyshi iu përgjigj: nëse vitet e mia i pjesëton me 5 dhe nga ai numër zbret 4, fiton numrin e viteve të tua. Sa vjeç është gjyshi, nëse Vesa është 9 vjeçe?			



- Nga kjo kuptuam që gjyshi i Vesës është 65 vjeç.
- Marrim disa mendime nga nxënësit.

Faza e dytë:

Hapet libri dhe nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë **për të** gjetjen e së panjohurës lidhur me pjesëtuesin.

- Lexohet udhëzimi: Beni ka 24 bonbone. Ai i ndau ato në grupe të barabarta. Secili grup kishte nga 4 bonbone. Në sa grupe të barabarta i ndau Beni bonbonet?
- Si duhet të veprohet?
- Kur nuk dihet pjesëtuesi?

Kur nuk dihet pjesëtuesi, gjendet duke pjesëtuar.

Gjejmë herësin 24 : ___ = 4

___ = 24 : 4

___ = 6

24 : 6 = 4

Vlera e fituar (pra numri 6) është pjesëtuesi i panjohur. E vendosim numrin 6 **në pozitën e** pjesëtuesit **të panjohur dhe e** pjesëtojmë 24:6 = 4.

Nxënësit veprojnë njësoj edhe me rastet t**ë tjer**a tek ushtrimet e radhës 1. Pastaj diskutojnë me tër**ë klasën për gjetjen e** s**ë panjohurës në lidhje me** shumëzimin.

Faza e tretë:

Nxënësit në dyshe gjejnë të panjohur**ë**n dhe kontrollojnë rezultatin.

876 : ___ = 12 876 : 73 = 12

____ = 876 : 12 12 = 12

_____ = 73

Nxënësit diskutojnë dhe tregojnë se si e kanë gjetur të panjohur**ën në lidhje me shumëzimin** dhe pjesëtimin. Nxënësit lihen të provojnë aftësitë logjike në zgjidhjen e problemeve.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të orës mësimore, vlerësohen nxënësit për qëndrimin aktiv dhe dhënien e mendimeve në zgjidhjen e ekuacioneve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Plotëso: Tani është radha jote.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Të dhënat		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelat përkatëse; ▪ paraqet të dhënat me tabelë dhe me diagram; ▪ komenton të dhënat e paraqitura në tabelë apo diagram, si dhe i krahason ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Grumbullimi i të dhënave			
Fjalët kyçe: grumbullimi, të dhënat .			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: **Nxënësi/ja:** - grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse; - vendos në një tabelë të dhënat nga një situatë konkrete ose mjedis i caktuar; - identifikon në një tabelë numrin e të dhënave në një situatë konkrete.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Nxënësit luajnë loja më e pëlqyer. Mësuesi/ja pyet nxënësit: - Cili është ushqimi i juaj i preferuar? - Marrim mendime të nxënësve dhe i shënojmë **në tabelë.**  - Marrim disa mendime nga nxënësit.			

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit lexojnë **në grupe dhe diskutojmë për të gjitha rastet,** pastaj në grupe do të punojnë tabelën e ushqimeve të preferuara.

Ushqimet e preferuara	Sallata	Peshku	Sanduiçi	Hamburgeri	Perimet e fërguara
E pëlqejnë	3 nxënës	4 nxënës	1 nxënës	0 nxënës	2 nxënës

Kjo është një formë se si bëhet grumbullimi i të dhënave. Nxënësit duhet të plotësojnë tabelën dhe u jepet mundësia për të thënë mendimin e tyre.

Faza e tretë:
Pra, nxënësit në plotësojnë ushtrimin, duke diskutuar me njëri tjetrin për frutat e pëlqyera.
- Cila është fruta juaj e preferuar?
- Sa nxënës pëlqejnë secilën frutë?

Kështu vazhdohet dhe punohet tabela me frutat e pëlqyera.

Frutat e pëlqyera	Molla	Dredhëza	Qershia
E pëlqejnë			

Këto të dhëna të tabelës do t'i paraqitni para klasës. Diskutojmë me njëri-tjetrin duke i krahasuar të dhënat në tabelë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e saktë të të dhënave dhe për krahasimin dhe diskutimin rreth këtyre të dhënave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Të dhënat		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelat përkatëse; ▪ lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara; ▪ paraqet të dhënat me tabelë dhe me diagram.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Sistemimi i të dhënave			
Fjalët kyçe: grumbullimi, të dhënat, diagram, tabelë frekuence.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - grumbullon dhe sistemon të dhënat në tabelën përkatëse; - paraqet të dhënat në tabelën frekuencë dhe në diagrame; - krijon tabelën e frekuencave duke u bazuar në diagram.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri, tabela në hamer.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Faza e parë:

Mësuesi/ja ka punuar paraprakisht një hamer me ushqimet e preferuara të gjithë klasës. Mësuesi/ja pyet të gjithë nxënësit se nga ora e kaluar kemi marrë disa nga ushqimet tuaja të preferuara, tani do të bëjmë një tabelë frekuence, ku do të tregohet numri i nxënësve që pëlqejnë secilin nga ushqimet.

Cili ushqim ju pëlqen më shumë?	
Hamburgeri	3
Peshku	7
Sallata	5
Perimet e fërguara	8

- Cili është ushqimi i juaj i preferuar?
- Pyesim për secilin ushqim:
- Për kë është ushqim i preferuar hamburgeri?
- Ngrenë duart vetëm ata që pëlqejnë këtë ushqim. Kështu vazhdohet për të mbledhur të dhënat nga secili nxënës.
- Marrim mendime të nxënësve dhe i shënojmë **në tabelë** .

Faza e dytë:

Për ta pasur më lehtë leximin e **të dhëna**ve, ne përdorim një grafik me shtylla, **që ndryshe quhet diagram.**
Cili është ushqimi i preferuar?

8				
7				
6				
5				
4				
3				
2				
1				
0				
	Hamburgeri	Peshku	Sallata	Perimet e fërguara

Kjo është një formë se si **bëhet grumbullimi i të dhënave në shtylla që ndryshe quhet diagram.**

Faza e tretë:

Pra, nxënësit plotësojnë ushtrimin 1 duke u bazuar në diagramin e të dhënave , ku duhet të ndërtojnë tabelën e frekuencave. Nxënësit punojnë në grupe duke diskutuar me njëri-tjetrin për sportin e pëlqyer.

- Sa nxënës pëlqejnë futbollin?

Kështu vazhdohet dhe punohet tabela me sportin e pëlqyer.

Cili është sporti i juaj i preferuar	
Futbolli	12
Basketbolli	5
Volejbolli	2
Noti	2

Këto të dhëna të tabelës do t'i paraqitni para klasës. Diskutojmë me njëri-tjetrin duke krahasuar të dhënat në tabelë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e saktë të të dhënave dhe për krahasimin dhe diskutimin rreth këtyre të dhënave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës**: II	**Klasa:** III
Tema: Të dhënat		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara; ▪ përdor piktogramet .	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Piktogrami			
Fjalët kyçe: grumbullimi, të dhënat, piktogrami.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - përdor piktogramin për të grumbulluar dhe sistemuar të dhënat në tabelën përkatëse; - lexon dhe analizon të dhënat e paraqitura në piktogram; - krijon tabelën e piktogramit në bazë të kërkesave.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri, tabela në hamer.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja ka punuar paraprakisht një hamer me disa mollë, ku një mollë përfaqëson dy nxënës. Lexohen pohimet rreth piktogramit. Pastaj, nxënësit rrethojnë nëse pohimi është i saktë ose gabim. - Katër nxënës kanë zgjedhur mollën e kuqe. G - Dy nxënës kanë zgjedhur mollën e verdhë. G - Tre nxënës kanë zgjedhur mollën me ngjyrë okre. V - Katër nxënës kanë zgjedhur mollën e gjelbër. V Kështu vazhdohet për të mbledhur të dhënat nga nxënësit kur është e vërtetë dhe kur është e gabuar. - Marrim mendime të nxënësve dhe i shënojmë **në tabelë** V/G			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librin dhe në grupe punojnë ushtrimin 1. Të gjitha grupet do të plotësojnë piktogramin në bazë të preferencave të perimeve. Numri i nxënësve është = 1.

- Sa nxënës preferojnë spinaqin? 7
- 9 nxënës preferojnë brokolin.
- Dy nxënës më shumë preferojnë bizelen sesa karotën.
- Më i preferuar nga perimet është brokoli.
- Më pak e preferuara nga perimet është karota.
- Diferenca mes nxënësve që kanë preferuar bishtajat dhe spinaqin është 1.

Kjo është një formë se si **bë**het grumbullimi i të dhënave me anë të piktogramit.

Faza e tretë:
Pra, nxënësit në plotësojnë ushtrimin, 1 duke u bazuar në diagramin e të dhënave, ku duhet të ndërtojnë tabelën e piktogramit me perimet e preferuara.

Perimet e preferuara						
9						
8						
7						
6						
5						
4						
3						
2						
1						
0	Spinaq	Bizele	Bishtaja	Lakra	Brokoli	Karota

Nxënësit punojnë në grupe dhe duke diskutuar me njëri-tjetrin për krijimin e piktogramit me perimet e pëlqyera.
Këto të dhëna të tabelës do t'i paraqitni para klasës. Diskutojmë me njëri-tjetrin duke i krahasuar të dhënat në tabelë

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e saktë të të dhënave dhe për krahasimin dhe diskutimin rreth këtyre të dhënave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Të dhënat		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ lexon dhe analizon të dhënat e grumbulluara; ▪ paraqet të dhënat me tabelë dhe me diagram; ▪ komenton të dhënat e paraqitura në tabelë apo diagram, si dhe i krahason ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1); III (3); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Komentimi dhe krahasimi i të dhënave me lloje të ndryshme të diagrameve			
Fjalët kyçe: grumbullimi, të dhënat, piktogrami.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - paraqet piktogramin për të grumbulluar dhe sistemuar të dhënat në tabelën përkatëse; - lexon dhe analizon të dhënat e paraqitura në piktogram; - komenton të dhënat me lloje të ndryshme diagramesh.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja ka punuar paraprakisht një hamer me: programet e preferuara televizive. Nxënësit krijojnë një diagram me të dhënat e grumbulluara **për programet e preferuara televizive.** - Marrim numrin e votave për secilin program, ku krijojmë një piktogram që të krahasojmë shikueshmërinë e programeve. - Marrim mendime të nxënësve dhe i shënojmë **në tabelë**.			

Faza e dytë:
Nxënësit hapin librat dhe në grupe punojnë ushtrimin 1. Të gjitha grupet do të plotësojnë piktogramin në bazë të preferencave të shijeve të akulloreve.

- Cila shije e akullores është zgjedhur nga katër nxënës? Mentoli.
- Cila shije e akullores është më e preferuara? Banane.
- Cila shije e akullores është më pak e preferuar? Mjedër.
- Cila shije e akullores është zgjedhur nga 5 nxënës? **Çokollate**.

Nxënësit komentojnë të dhënat me lloje të ndryshme diagramesh.

Faza e tretë:
Pra, nxënësit në plotësojnë ushtrimin, me shijet e akulloreve duke u bazuar në diagramin e të dhënave, ku duhet të ndërtojnë tabelën e piktogramit me shijet e preferuara.

Shijet e akulloreve **t**ë preferuara						
8						
7						
6						
5						
4						
3						
2						
1						
0	**Çokollatë**	Mentol	Mjedër	Vanilja	Banane	

Nxënësit punojnë në grupe dhe diskutuar me njëri-tjetrin për krijimin e piktogramit me shijet e akulloreve **të pëlqyer**a.
Këto të dhëna të tabelës do t'i paraqitni para klasës. Diskutojmë me nj**ë**ri-tjetrin duke krahasuar të dhënat në tabelë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësohen nxënësit për paraqitjen e saktë të të dhënave dhe për krahasimin dhe diskutimin rreth këtyre të dhënave.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Probabiliteti		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ parashikon mundësinë (me dallime mesatare); ▪ bën provën: e mundur, e pamundur.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1); III (3, 6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ngjarjet e mundura dhe të pamundura			
Fjalët kyçe: ngjarje e pamundur, e mundur e sigurt.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - parashikon mundësinë e ngjarjeve që mund të ndodhë apo që nuk do të ndodhë; - bën provën: e mundur, e pamundur apo e sigurt.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri, zari, qese me topa (kuqe, gjelbër, kaltër).			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: Mësuesi/ja merr një qese me disa topa, me ngjyrë të kuqe, kaltër, gjelbër. Nëse dikush nga nxënësit fut dorën në qese dhe pa shikuar, nxjerr një top me ngjyrë: - **të kuqe është ngjarje e mundur;** - **të kaltër është ngjarje e mundur;** - **të gjelbër është ngjarje e mundur;** - **të verdhë është ngjarje e pamundur.** - Pyesim nxënësit pse është e mundur? - **Çfarë ngjyrash kanë topat brenda** qeses? - Po pse është e pamundur? Marrim disa mendime nga nxënësit.			

Faza e dytë:
Hapet libri dhe nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojmë për të gjitha rastet, kur është ngjarje e mundur, kur është ngjarje e pamundur dhe kur është ngjarje e sigurt.
Në grupe, nxënësit luajnë lojën me zarit, ku do të diskutojnë për ngjarjet që nuk do të ndodhin kurrë, për ngjarjet që mund të ndodhin dhe për ngjarjet që mund të ndodhin gjithmonë.

- Sa pika ka zari? (1, 2, 3, 4, 5, 6)
- A mund të ketë në atë zar 20 pika?
- A mund t**ë** bjer**ë** gjithmonë ndonjë pikë? (ose 1, 2, 3, 4, 5, 6).

Nxënësit duhet të plotësojnë me fjalë dhe u jepet mundësia për të thënë mendimin e tyre.

Faza e tretë:
Pra, në dyshe, nxënësit plotësojnë ushtrimin 2, duke diskutuar me njëri tjetrin.

- Çfarë është e mundur të nxjerr nga shporta e parë, e dytë dhe e tretë?
- Çfarë është e pamundur të nxjerr nga shporta e parë, e dytë dhe e tretë?
- Çfarë është e sigurt të nxjerr nga shporta e parë, e dytë dhe e tretë?

Për secilin rast, nxënësit do të diskutojnë dhe do të tregojnë se si ata kanë ardhur deri te ngjarja e mundur e pamundur dhe e sigurt.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të orës mësimore, nxënësit vlerësohen **për qëndrimin aktiv dhe dhën**ien e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Matematikë	**Lënda:** Matematikë	**Shkalla e kurrikulës:** II	**Klasa:** III
Tema: Probabiliteti		**Rezultati i të nxënit të temës:** ▪ parashikon mundësinë (me dallime mesatare); ▪ bën provën: e mundur, e pamundur.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II (1); III (3, 6); V (8).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 2.2, 3.4, 3.6, 4.2, 4.3.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Mesataret			
Fjalët kyçe: mesatarja aritmetike, mediana, moda.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Mësuesi/ja:** - përcakton mesataren aritmetike, modën dhe medianën e ngjarjeve; - kryen mbledhjen e mesatares aritmetike në jetën e përditshme.			
Burimet: Libri dhe fletorja e punës "Matematika 3". **Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** lapsa, fletore, libri.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Faza e parë: **Mësuesi/ja** ndan nxënësit në tri grupe, ku do të jep detyrat për **të lexuar** njësinë e re mësimore. Grupi 1 do të lexojë: Mesatarja aritmetike. Grupi 2 do të lexojë: Mediana Grupi 3 do të lexojë: Moda. Nxënësit lihen të lexojnë 6-7 minuta për pjesët e caktuara. - Çfarë mësuat nga leximi? - A ju kujtohet çfarë është mesatarja aritmetike? - A ju kujtohet çfarë është mediana? - A ju kujtohet çfarë është moda? Marrim disa mendime nga nxënësit. **Faza e dytë:** Nxënësit do të punojnë ashtu siç ishin në grupe. Grupi 1. Gjen mesataren e ushtrimit 1 dhe 2. - Mesataren aritmetike e gjejmë duke mbledhur shumën e të dhënave dhe e pjesëtojmë me numrin e të dhënave.			

Grupi 2. Gjen medianën e ushtrimi 3.

- Medianën ku nëse është numër çift dy vlerat e mesit duhen të mblidhen dhe pastaj të pjesëtohen me dy.

Grupi 3. Gjen modën, ushtrimi 4.

- Vlera që paraqitet më së shpeshti në grupin e të dhënave.

Nxënësit duhet të plotësojnë dhe u jepet mundësia për të thënë mendimin e tyre. Ata diskutojnë fillimisht në grupe, pastaj një përfaqësues nga klasa prezanton punën dhe tregon ecurinë se si ka shkuar deri te zgjidhja e situatës.

Faza e tretë:

Pra, në grupe, nxënësit do të punojnë llojet paraqitjes së të dhënave:

Mesatarja aritmetike

moda

Paraqitja e të dhënave

Mediana

paraqitja në tabele.

Për secilin rast, nxënësit do të diskutojnë dhe do të tregojnë se si ata kanë ardhur deri te paraqitja e të dhënave.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në përfundim të orës mësimore nxënësit vlerësohen **për qëndrimin aktiv dhe** dhënien e mendimeve.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Puno: Tani është radha jote!

Referenca:

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (e rishikuar).
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Udhëzues për zbatimin e kurrikulës, i rishikuar, prill, 2018.
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Plani dhe Programi lëndor për klasën e tretë në arsimin fillor në Republikën e Kosovës (i rishikuar).
Vlerësimi Formativ, BEP/MASHT, botimi i ri, 2013.
Vlerësimi sipas kurrikulës së bazuar në kompetenca, Udhëzues për mësimdhënës, MASHT/ USAID, botimi i parë, korrik, 2016.
Matematika dhe mësimdhënia e matematikës, Udhëzues për klasat 1-5, GIZ- KEC (2012).

https://www.scribd.com/document/382821308/BEP-Udhezues-Vleresimi-Sipas-Kurrikules
http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/06/21-st-Century-Classroom_shq1.pdf
http://www.cdbe.info/wp-content/uploads/2015/08/Matematika-dhe-mesimdhenia-e-matematikes-per-klasen-5.pdf

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:51(072)(075.2)

Puka, Edi
Matematika 3 : libër për mësuesin/en : për klasën e tretë të arsimit 9-vjeçar / Edi Puka, Zyla Osmani. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 204 f. : ilustr. ; 20.7x28 cm.

1. Osmani, Zyla

ISBN 978-9951-843-45-4